

RRITJA EKONOMIKE E VENDEVE NË TRANZICION TË EUROPËS LINDORE: ROLI I INSTITUCIONEVE DHE MBËSHTETJA PËR REFORMAT INSTITUCIONALE

Besart Kadia, Doktorant

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, me profil Ekonomi dhe Zhvillim i
Qëndrueshëm, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Arjan Kadare, PhD

Numri i fjalëve: 50.200

Tiranë, Shtator 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me përgjegjësi të plotë dhe jam në dijeni të pasojave ligjore që ka një deklaram i rremë. Ky punim akademik është vepër e imja dhe nuk është plagjiaturë ose kopje e ndonjë autori tjetër.

ABSTRAKTI

Ky studim analizon rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion të Europës Lindore. Rëndësi e veçantë i është kushtuar marrëdhënies mes reformave institucionale dhe rritjes ekonomike. Studimi bazohet në teoritë e rritjes ekonomike të vendeve në zhvillim. Kontributi i parë i studimit është përdorimi i metodave ekonometrike panel për interpretimin e të dhënave 22 vjeçare të vendeve të Europës Lindore. Kjo metodë merr parasysh faktorët individualë të shteteve që kontribuojnë në rritje ekonomike si dhe faktorët që ndikojnë në nivelet e rritjes afatgjatë. Nga ana tjetër ky studim jep një kontribut në të kuptuarit e reformave ekonomike në Shqipëri dhe në Europën Lindore pas rënies së komunizmit. Së dyti punimi merr në shqyrtim dhe analizon me anë të regresioneve të serive kohore rolin e kursit të këmbimit në një shtet të euroizuar si Shqipëria. Së treti, ky studim duke pasur parasysh rëndësinë e mbështetjes afatgjatë për reforma nga ana e qytetarëve analizon mbi 48,000 pyetësorë të mbledhur nga BERZH në vitet 2006 dhe 2010 nëpërmjet regresioneve logjistike. Ndryshe nga studimi i BERZH analiza bëhet në detaje për rastin e Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit dhe mund t'i shërbejë politikbërësve në përvijimin e masat që ata ndërmarrin për të reformuar ekonominë. Të tre analizat e mësipërme testohen veçmas duke arritur në konkluzionin se pavarësisht krizës ekonomike vendet në tranzicion duhet të vazhdojnë reformat institucionale për të garantuar rritje ekonomike.

ABSTRACT

This study analyses the determinants of cross-country differences in GDP growth of transition economies of Eastern Europe. The main focus of the research is the relationship between progress in reforms, as measured by the EBRD transition indicators, and economic growth. This study builds on the available literature, economic growth theory and panel data regression analysis. The novelty of this study is the use of the Pooled Mean Group (PMG) estimator, an approach that is distinctive from other studies covering this topic. The second contribution to the literature is the separate estimation of the effects of market, financial and enterprise reform. This paper finds that market liberalization has had most effect on growth, and it is followed by financial reform and then enterprise reforms. At the same time given the importance of popular support for the success of economic reforms this paper provides microeconomic evidence on the voters behavior using ordered logit regression. Based on more than 48.000 survey answers gathered by EBRD in year 2006 and 2010 this study finds that social mobility remains an important factor in peoples value judgment on government intervention in the economy. This paper extends the debate and analyses the role of government intervention in the financial sector in the Albanian economy and its potential risks and benefits.

KAPITULLI I: HYRJE.....	14
1.1. Hyrje	14
1.2. Çështje për kërkim, pyetja kërkimore dhe hipoteza.....	16
1.2.1. Pyetje Kërkimore I.....	17
1.2.2. Hipoteza 1	18
1.2.3. Pyetja Kërkimore II.....	18
1.2.4. Hipoteza II	20
1.2.5. Pyetja Kërkimore III	20
1.2.6. Hipoteza III	21
1.3. Rëndësia e Kërkimit.....	21
1.4. Metodologjia	23
Së treti, ky studim do të përdorë dhe regresione të serive kohore të monedhës vendase për të matur luhatshmërinë e saj kundrejt dy monedhave të tjera si Euro dhe Dollari. Këto rezultate do të krahasohen me të dhënat zyrtare të FMN-së për ekonominë Shqiptare. Nga ana tjetër janë kryer teste kontrolli me pesë shtete të Europës Lindore që kanë politika të ndryshme zyrtare mbi regjimin e kursit të këmbimit dhe rezultatet e tyre janë krahasuar me rezultatet e përfuara nga rasti i Shqipërisë.....	24
1.5. Përkufizime	25
1.6. Kufizime të kërkimit.....	26
1.7 Struktura e Kapitujve	28
KAPITULLI 2: RITJA EKONOMIKE DHE ROLI I INSTITUCIONEVE	30
2.1. Hyrje	30
2.2. Teoria e Rritjes Ekonomike	30

2.2.1. Konvergjenca e kushtëzuar	33
2.2.2 Modelet Endogjene	35
2.2.3. Roli i Institucioneve.....	39
2.2.3.1. Përse kanë rëndësi institucionet ekonomike sipas Acemoglou?44	
2.2.2.2. Eksperiment natyror.....	47
2.3. Si u ndërmorrën reformat institucionale në Europën Lindore?	49
2.3.1. Institucionet dhe Konsensusi i Uashingtonit.....	51
2.4. Beteja e ideve dhe reformat institucionale në Europën lindore	55
2.4.1. Përdorimi i gabuar dhe mungesa e përkufizimit neoliberal	58
2.4.2. Paragjykimi neoliberal	59
2.4.3. Liberalët dhe Neoliberalët: shtytësit e reformave ekonomike botërore	63
2.4.4. Nga Liberal në Neoliberal.....	66
2.4.5. Mënyra e shpërndarjes në Europën Lindore	69
2.4.6. Kritikët e Majtë	77
2.5. Ndërmjetësuesit Financiar	81
2.6. Krizat dhe Neoliberalizmi.....	82
KAPITULLI 3: PËRDORIMI I TË DHËNAVE DHE METODOLOGJIA..90	
3.1. Hyrje	90
3.2. Të Dhënat.....	91
3.3. Metodologjia	103
3.3.1 Modeli 1: Rritja Ekonomike dhe Reformat Neoliberales.....	103
3.3.2 Cross Section dhe Seritë Kohore	104

3.3.3. Panel Data	105
3.3.4 Metoda e Korrektimit të Gabimeve	107
3.3.5. Matësi i Mesatares në Grup	108
3.3.6 Pasiguritë e modelit.....	110
3.4. Modeli II: Ashensori Social	111
KAPITULLI 4: REZULTATE	122
4.1. Hyrje	122
4.2. MODELI 1	122
Hipoteza 1	122
4.2.1. Ekonomia në Europën Lindje	123
4.2.3 Rezultate Pooled Mean Group	129
4.2.4 Përzgjedhja e Modelit	135
4.2.5.Shpejtësia e Konvergjencës	139
4.2.6. Literatura e Rritjes Ekonomike në Europën Lindore	140
4.2.7. Kushtet Fillestare	141
4.2.8. Stabiliteti Makroekonomik	143
4.2.9. Niveli i Reformave.....	143
4.3. Shpejtësia e Reformave.....	145
4.4. MODELI II	150
Mbështetja për Ekonominë e Tregut dhe Fazat e Reformave.....	150
Hipoteza II	150
4.5.1. Rezultate Modeli II	155

4.5.2. Debat i Shteti apo tregu në uljen e varfërisë dhe rritja ekonomike..	161
4.5.3. Mbështetja për Ekonominë e Tregut dhe Fazat e Reformave.....	168
4.5.4. Ndërhyrja e Shtetit	177
KAPITULLI 5 KURSI KËMBIMIT DHE SISTEMI FINANCAIR NË SHQIPËRI	185
Pyetja Kërkimore III	186
Hipoteza III	186
5.2. Liberalizimi Financiar.....	187
5.2.1. A ndikon negativisht kontrolli i qeverisë në kreditim?.....	187
5.2.2. Europa Lindore	191
5.3. A ndikon kreditimi në rritje ekonomike (rasti Shqipërisë)	193
5.3.1. Akses i Financiar në Shqipëri	195
5.3.2. Asimetria Informacionit dhe rëndësia e Institucioneve Publike	201
5.4. Rëndësia e Financimit.....	203
5.4.1. Reformat Bankare dhe Zhvillimi i Sektorit Bankar në Europën Lindore.....	205
5.5. Luhatjet e Kursit të Këmbimit	218
5.5.1. Krizë Financiare në një vend të euroizuar	224
5.6. Roli i shtetit në praktikën neolibérale	227
5.6.1. Tërheqja e depozitave	228
5.6.2. Modeli Diamond-Dybvig.....	231
5.6.3. Rreziku Moral	233
KAPITULLI 6	238

KONLUZIONE DHE REKOMANDIME	238
6.1 Hyrje	238
6.2. Konkluzione mbi hipotezën dhe pyetjen kërkimore	240
6.3. Implikime për teorinë dhe kufizime.....	243
.....	253
.....	254
.....	254

LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1: Të Ardhurat për Frymë në Shqipëri 1870-2010.....	126
Grafik 2: Produktiviteti për Punëtor, Shqipëri, Greqi, Rumani dhe Bullgari. Burimi i të dhënave: Banka Botërore, statistika.	128
Grafik 3: Të Ardhura për Frymë. Diferenca mes Europës Lindore dhe Europës Perëndimore 1940:2010. Burimi: Maddison (2008).....	32
Grafik 4: Të Ardhura për Frymë Shqipëri, Angolë, Taivan, Haiti dhe Liberi 1950-2010. Këto shtete kanë të njëjtin nivel të ardhurash në 1960 por ndjekin rrugëtime të ndryshme në 50 vitet e ardhëshme.....	37
Grafik 5: Eksperiment Natyror: Rritja Ekonomike mes Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut.....	48
Grafik 6: Artikuj që Përkufizojnë Termin Neoliberal.....	60
Grafik 7: Rritja Mesatare PPB për frymë në vendet OECD. Burimi: Kotz.....	79
Grafik 8: Indeksi i PBB-së për Ukrainën, Moldavinë dhe Gjerogjinë në 2007 krahasuar me 1991.....	85
Grafik 9: Indeksi i Lirisë dhe PBB për Frymë.....	88
Grafik 10: Rritja Ekonomike Mesatare mes shteteve 1991-2011	89
Grafik 11: Indeksi i reformave institucionale. Burimi: <i>BERZH</i>	96
Grafik 12: Mesatare e të Ardhurave për Frymë	101
Grafik13: Preferenca për Ekonominë e Tregut. Krahasim mes Shqipërisë dhe Europës Lindore 2006 dhe 2010	152
Grafik15: Rritja Ekonomike 2009. Burimi: Banka Botërore	164
Grafik 16: Jetgjatesia dhe Rritja Ekonomike në Rusi.....	179
Grafik 18: Kredimi në raport me PBB-në. Krahasim mes OECD dhe vendeve në Zhvillim.....	190

Grafik19: Krahasim mes Kreditimit ndër vite mes Shqipërisë dhe Letonisë	192
Grafik20: Rritja e Kreditimit si % e PBB-se	209
Garfik 21: Zhvlerësimi i Lekut dhe Kreditë e këqija.....	211
Grafik 22: Ndryshimi i kursit të këmbimit lek euro/usd	219
Grafik23 Kursi i Këmbimit monedha Shqiptare, Serbe, Kroate dhe Maqedonase	252
Grafik24: Depozitat me afat në mln EUR sistemi bankar Shqiptar	228
Grafik 25: Sistemi Bankar Shqiptar: Mjaftueshmeria e Kapitalit %	233

LISTA E TABELAVE

Tabela 3: Indeksi Lirisë dhe të Ardhurat	87
Tabla 10: Efekti I Pjesshem I Reformave ne Tregje.....	138
Tabela 11: Efekti I Pjesshem I Reformave ne Tregje Financiare	138
Tabela 12: Efekti I Pjesshem I Reformave ne Siper marrje.....	138
Tabela 33 Augmented Dickey-Fuller test për Euro	221
Tabela 34 Augmented Dickey-Fuller test për Dollarin Amerikan.....	221
Tabela 35 Rezultate: Test Stacionariteti Dickey Fuller për monedhat	223
Tabela 25 Ndryshorja e pavarur rritja ekonomike	194
Tabela 26 Lehtësia për akses në financave mes vendeve të Europës Lindore.....	196
Tabela 27 A mendoni se taksat janë penguese për zhvillimin e biznesit tuaj.....	197
Tabela 14: Regresioni Ordered Logistic	158
Ndërhyrja E Shtetit Për Barazi Në Ekonomi	158
Tabela 15: Mbështetja për ndërhyrje shtetërore në vendet Ballkanike.....	159
Tabela 16: Cilët faktorë ndihmojnë të ecësh në jetë	160
Tabela 17: Vlerësimi marxhinal pra outcome=1 (jo ndërhyrje e shtetit).....	160
Tabela 18: Vlerësimi marxhinal pra outcome=3 (ndërhyrje e shtetit).....	161
TABELA 19: Sa dakort jeni me pohimin e mëposhtëm:	164
Tabela 20: Cfarë duhet bërë me kompanitë e privatizuara	174
Tabela 21 Ne mendimin tuaj ne cilat fusha duhet te investoje shteti si prioritare?	176
Tabela 22 Ne mendimin tuaj ne cilat fusha duhet te investoje shteti si prioritet te dyte?	176

Tabela 23 Jeni gati të paguani më shumë taksa për shërbimet e mëposhtëme	177
Tabela 28 Sa problem është aksesimi financiar për zhvillimin e firmës suaj	202
Tabela 29 Sa problem është destabiliteti politik në zhvillimin e biznesit tuaj.....	248
Tabela 30 A mendoni se konkurrenca informale pengon firmën tuaj?.....	248

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Hyrje

Kriza globale e vitit 2008 risjell në vëmendje efektin që kanë patur reformat ekonomike dhe institucionale në ekonomitë e vendeve lindore. Will Bartlett (2012) shprehet se vendet të cilat kishin patur më tepër progres në krijimin e një sistemi institucional dhe që ishin në favor të sipërmarrjes së lirë dhe të konkurrueshmërisë së tregjeve vuajtën më shumë pas krizës globale. Megjithëse debatet mbi arsyet se përse kriza ishte aq e “egër” mbi disa vende të Europës Lindore janë të ndryshme, përfundimi i Bartlett, se reformat institucionale mund të kenë qenë një faktor i rëndësishëm risjell edhe njëherë në vëmendje rëndësinë e rritjes ekonomike dhe idetë neoliberale në Europën Lindore. Ndërkohë, një krahasim i vendeve të tjera postkomuniste tregon se ecuria e ekonomisë nuk ka një trajektore të qartë dhe të lehtë për t’u interpretuar.

Vështirësia e procesit të tranzicionit kapet mjaft mirë nga revista *The Economist* ku shkruhet se: “...qindra libra janë shkruar në procesin e tranzicionit nga kapitalizmi në komunizëm, por asnjë në procesin e anasjelltë. Nuk ka një recetë të thjeshtë për të zhbërë një omëlete.” (The Economist, 1990: 22). Metafora e përdorur nga Conquest (2000) ishte mjaft e gjetur kur shprehej se: “*proçesi i tranzicionit nuk lejon një shtet, që të ankorohet në port të thatë dhe të pajiset me institucione të reja në mënyrë të kujdesëshme. Në fakt i gjithë proçesi është si të*

kishim një anije në mes të oqeanit dhe të mundohemi ta riparojmë në kohë me stuhi”.

Në librin *“Përse Shtetet Dështojnë”* ekonomisti i IMT-së Daron Acemoglu si dhe kërkuesi në shkencat politike i Harvard-it James A. Robinson, argumentojnë se diferenca kryesore në të ardhurat për frymë mes shteteve janë institucionet (Acemoglu, 2012). Nën influencën e një lloji të ri të studimeve ekonomike të shekullit XXI ky libër arrin në përfundimin se megjithëse institucionet ekonomike janë kritike për të arritur në përfundimin nëse shtetet janë të varfra apo të pasura, politika dhe institucionet politike përcaktojnë cilat institucione ekonomike do të ketë një shtet. Sipas tyre për të kuptuar pabarazinë botërore ne duhet të kuptojmë përse disa shoqëri janë të organizuara në mënyrë shumë joefikase dhe nga ana sociale jo të dëshirueshme. Kombet nganjëherë adoptojnë institucione efikase dhe arrijnë zhvillim, por fatkeqësisht, këto janë raste të izoluara. Shumë ekonomistë janë të fokusuar për të arritur çfarë është e duhur, por ajo që duhet në të vërtetë është të shpjegojmë se çfarë bëjnë gabim vendet e varfra.

Ndaj pyetja që shtrohet me të drejtë 24 vite pas rënies së komunizmit është: A ka mbaruar tranzicioni? Nëse jo, kur do të mbarojë dhe çfarë kriteresh mund të përdoren për të kuptuar që ka mbaruar? Gjithashtu, a duhet të mendojmë se me privatizim do të mund të arrihej një rritje ekonomike më e lartë dhe a janë

reformat neoliberales më të suksesshme kur ka demokraci funksionale dhe si institucionet ekonomike ndërveprojnë me ato politike?

1.2. Çështje për kërkim, pyetja kërkimore dhe hipoteza

Pamvarësisht implementimit të gjerë të politikave liberale në Europën Lindore, divergjenca në rritjen ekonomike të vendeve post-komuniste ka qenë më e lartë se mund të parashikohej gjatë asaj periudhe. Ajo që mund të paparashikohej ishte “reçesioni postkomunist” një rënie e aktivitetit ekonomik e cila çoi në depresion të përgjithshëm dhe në një periudhë de-industrializimi shkallëgjërë. Vendet e prekura përjetuan një *“rënie dramatike të institucioneve shtetërore por edhe të kapitalit njerëzor”* (Vorobyov, 2000).

Që në faqet e para të studimit të Bankës Botërore të vitit 2004 për vendet në tranzicion theksohet se *“transformimi ishte tejte i madh dhe i papreçedentë”*. Kësisoj këto vende vuajtën nga rënia e PBB-së dhe gjithashtu ato nuk ishin të pajisura me institucionet e tregut të lirë (World Bank, 2004). Në Rusi sikundër dhe në shumë vende të tjera të Europës Lindore varfëria u rrit nga 2% në fund të 1989 në 50% në mesin e viteve 90’-të (Milanovic, 1998). Gjithashtu nga vitit 1989 deri në vitin 1999 të ardhurat për frymë në Rusi ranë me 38%, ndërkohë që jetëgjatësia për meshkujt u zvogëlua me 5 vjet (Banka Botërore, 2004), duke e renditur atë në vendin e 122-të në botë pranë Koresë së Veriut. Ndaj pyetja më e

shpeshtë dhe që në çdo rast mbetet thelbësore në fushën e ekonomiks të rritjes dhe të zhvillimit është: Përse disa shtete janë më të varfra se disa shtete të tjera?

1.2.1. Pyetje Kërkimore I

A është niveli i reformave institucionale neoliberales të ndërmarra në ekonominë e Europës Lindore përgjatë dy dekadave të fundit arsyeja që shpjegon divergjencën e vënë re në rritjen ekonomike të këtyre shteteve?

Tradita e modeleve neoklasike të rritjes, Solow (1956) dhe Cass (1965), i shpjegon këto diferenca në të ardhurat për frymë në bazë të akumulimit të faktorëve të rritjes ekonomike. Sipas këtyre modeleve diferencat e shumta në PBB-së për frymë vijnë si pasojë e niveleve të ndryshme të nivelit të kursimit, preferencave ose parametrave të tjerë ekzogjenë si *Faktori Total i Prodhimit (TFP)*. Në këto modele institucionet merren si të mirëqëna, që garantojnë të drejtën e pronësisë, të shkëmbimit të produkteve dhe shërbimeve. Një valë e dytë e rëndësishme ishte *Romer (1986) dhe Lucas (1988)* që theksuan rëndësinë e eksternaliteteve nga akumulimi i kapitalit njerëzor dhe fizik që mund të çonte në rritje ekonomike të qëndrueshme. Këto studime mbeten gjithsesi brenda logjikës së rritjes ekonomike neoklasike.

Romer (1990) parashtron në modelin e tij se një shtet mund të jetë më i begatë sesa një tjetër nëse ai shpërndan më shumë burimet e inovacionit. Idetë teorike të sipërpërmendura janë dukshëm tradicionale dhe ende përdoren gjerësisht duke ofruar një informacion mekanik të rritjes ekonomike. Ato gjithësesi nuk janë të afta të japin një shpjegim thelbësor të rritjes ekonomike. Siç edhe thotë *North (1973, f.2)* faktorët si inovacion, ekonomitë e shkallës, arsimimi, akumulimi i kapitalit etj, nuk mund të jenë shkaktarët e rritjes ekonomike, ato janë vetë rritja (*growth*). Sipas tij arsyeja kryesore e ndryshimit në rritje ekonomike mes shteteve vjen nga diferenca në cilësinë e institucioneve që ata kanë.

1.2.2. Hipoteza 1

Ato shtete të cilat kanë ndërmarrë më shumë reforma institucionale neoliberales kanë patur rritje ekonomike më të lartë.

1.2.3. Pyetja Kërkimore II

Duke qenë se teoria makroekonomike gjithnjë e më shumë përfshin reformat institucionale si një faktor të rëndësishëm në shpjegimin e performancës së rritjes ekonomike duket me rëndësi ngritja e një pyetje tjetër kërkimore mbi mbështetjen popullore për reformat institucionale.

Kjo pyetje kërkimore shqyrton arsyet pse disa shtete i kryejnë më shpejt reformat institucionale e disa të tjera e kanë më të vështirë. Kjo pyetje kërkimore ka nevojë të shqyrtojë politikat ekonomike dhe sjelljen e qytetarëve, në mbështetje ose jo të reformave në ekonomi dhe të një roli më të madh të shtetit me justifikimin e uljes së pabarazisë në vend.

Sipas ekonomistit *Williamson (2004)* që një ekonomi të ketë sukses me reformat e saj institucionale duhet të ketë parasysh tre faktorë: një lidhshmëri vizionar, politika ekonomike koherente si dhe mbështetje popullore për reformat. Rëndësinë e kësaj të fundit e mbështet *Rodrik (1996)* dhe *Drazen (2000)*. Këto dy punime në fakt japin vetëm vlerësim teorik se papunësia dhe niveli i të ardhurave janë domethënës pa ndonjë të dhënë empirike mbi këto vlerësime.

Ndaj në studim do mundohemi të kuptojmë të ardhmen e politikave neoliberales në ekonominë e Europës Lindore. Reformat neoliberales synojnë avancimin e tregut në ekonomi nëpërmjet privatizimeve, deregullimit dhe tërheqjes së shtetit në tërësi nga ndërhyrjet për të garantuar rritje ekonomike të lartë. Ndërkohë në rast se vërtetohet një ndryshim i perceptimit të publikut për rolin e shtetit kjo do të justifikonte dhe një kthim pas të politikave neoliberales dhe ngadalësim të reformave institucionale. Disa teori thonë se *ashensori social*¹, pra mundësia për

¹ Angl: *Social Mobility* (këtu përshatatur si ashensor social)

të ngjitur shkallët sociale në një shoqëri, do të inkurajonte pozitivisht individët që jetojnë në Europën Lindore të mbështesnin qeverinë për të ndërmarrë reforma të nevojshme për të garantuar liri dhe rritje ekonomike.

1.2.4. Hipoteza II

Ashensori social është faktor i rëndësishëm në mbështetje të reformave neoliberales në vendet e Europës Lindore.

1.2.5. Pyetja Kërkimore III

Neoliberalizmi shihet si një ideologji e cila ndër të tjera synon të zhvendosë kontrollin e faktorëve të prodhimit nga duart e shtetit drejt mekanizmave të tregut. Në këtë proces sugjerohet që shtetet duhet të ulin deficitet buxhetore, të limitojnë subvencionet ndaj firmave prodhuese, të liberalizojnë tregun dhe gjithashtu të kenë një sistem financiar të zhvilluar e një kurs këmbimi fiks. Sistemi financiar në Shqipëri shihet shpesh si një faktor i rëndësishëm i konsolidimit të ideologjisë neoliberales dhe ky studim mundohet që të interpretojë sjelljen e institucioneve publike përsa i përket kontrollit të kursit të këmbimit dhe rolit që ka sistemi financiar në promovimin e aktivitetit privat në Shqipëri.

1.2.6. Hipoteza III

Shqipërisë, si një vend i euroizuar dhe me shumë lidhje ekonomike me Eurozonën nuk “i shkon përshtat” një kurs këmbimi fleksibël kundrejt euros.

1.3. Rëndësia e Kërkimit

Debati i efekteteve të privatizimeve në Europën Lindore dhe reformat neoliberales është shumë i rëndësishëm. *Orenstein (2009)* në studimin e tij “*Çfarë ndodhi me Politikën Ekonomike në Europën Lindore?*” shpjegon se “*ky debat ka vlerë jo vetëm nëse projekti neoliberal do të funksionojë në Europën Lindore por edhe nëse politikat e tregut të lirë do të vazhdojnë të adaptohen në pjesë të tjera të botës dhe të vazhdojnë të jenë të pajtueshme me demokracinë*”. Vendet e Europës Lindore kanë një vend unik në këtë debat pasi ato ishin si në një laborator testimi për idetë neoliberales përballë alternativave të tjera të organizimit ekonomik. Suksesi apo dështimi i tyre ka rëndësi për të ardhmen e kapitalizmit dhe demokracisë në vetvete.

Shumë studiues kanë rënë dakord se afrimi i rregullave të lojës me Europën Perëndimore ishte jetësor për të garantuar rritje ekonomike dhe ulje të varfërisë për vendet e Lindjes. Tashmë ka dhe shumë studime të tjera që hedhin dritë ndryshe mbi rëndësinë apo efektin e reformave institucionale mbi këto shtete. Pikërisht një ndër këto është dhe studimi i tre ekonomistëve *David Stuckler*,

Laurence King dhe Martin McKee, mbi privatizimet në Europën Lindore dhe nivelet e larta të vdekshmërisë në këto vende post-komuniste. Sipas *Stuckler, King, & McKee (2009)* privatizimet e shpejta nëpërmjet bonove të privatizimit janë të lidhura ngushtësisht me rritjen e vdekshmërisë në vendet post-komuniste në vitet 1989-2002. Këto privatizime masive si dhe stresi shoqëror sollën më pas një rritje të vdekshmërisë tek meshkujt me 12.8%. Gjithashtu analiza e tyre arrin në përfundimin se vendet që patën një privatizim më të shpejtë, sipas “terapisë së shokut”, patën një rritje të nivelit të papunësisë me 61% më të lartë sesa vendet që u angazhuan në reforma më graduale. Në analizën e tij Dani Rodrik nga Universiteti i Harvardit (*Rodrik, 2006*) shprehet se debati nuk mund të jetë nëse “Konsensusi i Uashingtonit²” egziston apo jo, por se çfarë do ta zëvendësojë atë debat. Sipas tij pati asnjëherë më parë në historinë njerëzore nuk pati më shumë privatizim, de-rregullim të tregut dhe liri të tregtisë me jashtë se gjatë kësaj periudhe dhe e vetmja gjë mbi të cilën mund të bihet dakord është se pas këtyre reformave gjërat nuk shkuan ashtu siç pritej; sidomos në rastin e Amerikës Latine. Kritikët thonë se reformat standarde të imponuara mbi këto shtete ishin të gabuara dhe askush nuk beson më në Konsensin e Uashingtonit.

² Termi i përdorur për të përshkruar dhjetë reformat bazë të vendeve në tranzicion drejt ekonomisë së tregut

Në këtë kuptim transformimi i një ekonomie të centralizuar në një ekonomi tregu ishte e paprecedentë në histori. Për vendet e industrializuara kalimi në ekonomi tregu erdhi pas shekujsh pëpjekje gjatë një procesi gradual dhe pa një objektiv final. Nga ana tjetër tranzicioni mundohet të arrijë këtë transformim të ekonomisë në një proces të kontrolluar në një periudhë më të shpjëtë dhe me objektiva të qarta për të krijuar tregje të reja, që i bënë ekonomistët të interesuar për këtë fushë. Ekonomiksi i tranzicionit duhet menduar kështu si një laborator i madh i zhvillimit ekonomik i cili vendos përballë njëra tjetrës burimet e rritjes ekonomike me institucionet.

1.4. Metodologjia

Me anë të metodave ekonometrike të panelit do të maten efektet e faktorëve të tillë si kursime, kushtet fillestare, stabiliteti makroekonomik apo reformat institucionale në përcaktimin e rritjes ekonomike në vendet e Europës Lindore. Për të matur efektin e reformave institucionale në rritjen ekonomike do të përdoren të dhëna nga Banka Botërore për 27 vende lindore përsa i përket rritjes ekonomike për frymë, për stabilitetin makroekonomik dhe nivelin kursimit në ekonomi. Nga ana tjetër progresi në reformave institucionale do të maten nga të dhënat vjetore të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (*BERZH*).

Gjithashtu ky studim do të përdorë 27.000 mijë pyetësorë të ndërmarrë në vitet 2006 dhe 2010 nga *BERZH* në vendet e Europës Lindore. Kjo databazë është burim i rëndësishëm informacioni mbi perceptimet e publikut për reformat institucionale dhe mbështetjen popullore për ndërhyrje të shtetit në ekonomi si dhe për rishikim të politikave neoliberales të privatizimeve. Raportet e *BERZH* “*Jeta në Tranzicion*” (Life In Transition) mundësojnë interpretime specifike për secilin shtet pasi të dhënat përftohen pas përpunimit të 1000 pyetësorëve për secilin shtet të marrë në studim. Për të matur mbështetjen popullore për reforma institucionale do të përdoret metoda e regresionit logjistik. Ky model është zgjedhur në këtë studim në mënyrë që të analizohet sjellja në nivel individual të të pyeturve përsa i përket ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Gjithashtu është analizuar sjellja e individëve për probabilitetin ose jo të reformave ekonomike që ofrojnë ndërtimin e institucioneve që konsiderohen të rëndësishme për rritjen ekonomike. Për këtë analizë do të përdorim *modelin logjistik rendor* (ordered logistic), që njihet dhe si probabiliteti proporcional. Ai është modeli më i preferuar për të studiuar në analizën e pyetësorëve të këtij lloji.

Së treti, ky studim do të përdorë dhe regresione të serive kohore të monedhës vendase për të matur luhatshmërinë e saj kundrejt dy monedhave të tjera si Euro dhe Dollari. Këto rezultate do të krahasohen me të dhënat zyrtare të *FMN*-së për ekonominë Shqiptare. Nga ana tjetër janë kryer teste kontrolli me pesë shtete të

Europës Lindore që kanë politika të ndryshme zyrtare mbi regjimin e kursit të këmbimit dhe rezultatet e tyre janë krahasuar me rezultatet e përftuara nga rasti i Shqipërisë.

1.5. Përkufizime

Neoliberalizëm: përdorimi më i shpeshtë i termit neoliberal i referohet politikave reformatore në ekonomi që liberalizojnë ekonominë, eliminojnë kontrollin e çmimeve, de-rregullojnë tregjet e financiare dhe ulin barrierat tregtare; duke ulur rolin e shtetit në ekonomi, sidomos nëpërmjet privatizimit të aseteve shtetërore, duke ofruar shkurtim të shpenzimeve publike dhe stabilizim makroekonomik, duke përfshirë kontrollin të fortë të ofertës monetare, eliminimin e deficitit buxhetor dhe uljen e subvencioneve shtetërore (Boas & Gans-Morse, 2009).

Ekonomisti North i përkufizon institucionet si: *“çdo strukturë apo mekanizëm i rendit shoqëror që rregullon sjelljen e një grupi individësh brenda një komuniteti të caktuar që forçojnë zbatimin e rregullave dhe që rregullojnë sjelljen bashkëpunuese të njeriut”*. Termi institucion përdoret për zakone dhe lloje sjelljesh në një shoqëri si dhe organizim formal i qeverisë dhe shërbimeve publike. Ose *“kufizime të krijuara nga njerëzit për ti ndihmuar në marrëdhëniet mes tyre”* (North D. , 1993).

1.6. Kufizime të kërkimit

Nuk duhet harruar se teoritë ekonomike, nga vetë përkufizimi janë thjeshtësim i realitetit të botës reale. Ndaj problemi kryesor i teorisë dhe modeleve ekonomike është se si të kuptojmë kompleksitetin e sjelljes së miliona njerëzve në ekonomi. Modelimet na japin mundësinë për të ndërtuar një formë “*kërkimi laboratorik*” të cilat mungojnë në shkencat sociale. Ndaj në modelime makroekonomike ne mundohemi që të përqendrojmë analizën në disa faktor kyç që çojnë në rritje ekonomike dhe më pas të përzgjedhim ato indikatorë që duhen përmisuar për të arritur objektivat e vendosura nga shoqëria apo politikbërësit.

Ky studim përdor tre metodologji të ndryshme ekonometrike si: regresione në panel dhe metoda e mesatarizimit në grup, regresion i logjistik rendor për të analizuar të dhënat e pyetësorëve si dhe regresion i serive kohore për të matur lëvizjet e kursit të këmbimit në Shqipëri dhe në vende të tjera lindore. Studimi përdor të dhëna nga burime të ndryshme si *Banka Botërore*, *FMN*, *Banka e Shqipërisë*, *INSTAT* dhe *BERZH*. Këto të dhëna variojnë nga të dhëna parësore të këtyre institucioneve deri në interpretim të pyetësorëve të bëra ndër vite nga *BERZH* dhe *Banka Botërore*.

Metodat ekonometrike në vërtetimin e hipotezës së parë janë risi në literaturë dhe rezultatet e këtij regresioni ekonometrik përmbledhin teorinë e ndikimit të reformave institucionale në rritjen ekonomike të Europës Lindore. Studimi

përfshin të tërë ekonomitë e Europës Lindore në tranzicion dhe përdor disa lloje testimesh statistikore si kriteri Baysian i përzgjedhjes, për të gjetur modelin më të mirë që jep informacion të qartë dhe domethënës të ndryshoreve të pavarura. Por duke qënë se vendet e Europës Lindore janë në faza të ndryshme të zhvillimit një studim tjetër në të ardhmen mund të adresojë efektin e disa lloj reformash institucionale në disa grupe shtetesh. Nga ana tjetër megjithëse në studim diskutohet për mënyrën sesi ideologjia neoliberale u përhap në Europën Lindore mundet që studime në të ardhmen të thellohen akoma më shumë me pyetësorë të drejtpërdrejtë me aktorët e reformave në Shqipëri dhe në analizimin e llojeve të institucioneve ekonomike që u përkrahën gjatë tranzicionit.

Ky studim nga ana tjetër kërkon të japë një interpretim të arsyeve që do të çonin popujt e Europës Lindore në mbështetje ose jo të një roli më të madh të shtetit në Ekonomi. Por studimi përqëndrohet në dhënat e BERZH në vitet 2006 dhe 2010. Këto të dhëna janë përdorur për herë të parë për rastin Shqiptar dhe mungon literatura krahasuese për rezultatet e marra në të. Gjithashtu mungesa e pyetësorëve të tjerë nga institucione të ngjashme bëjnë që *BERZH* të mbetet i vetmi burim i besueshëm dhe me metodologji të njëjtë në të gjitha shtetet e Europës Lindore. Studimi i këtyre të dhënave, më shumë se 50 mijë pyetësor në total për të dyja vitet e lartëpërmendura kërkon një analizë më të detajuar sesa hipoteza e ndërtuar nga ky studim.

Në analizën e fundit që përqëndrohet në rolin e sektorit financiar në ekonomi ky studim analizon një hipotezë të rolit të Bankës Qëndrore në menaxhimin e kursit të këmbimit. Kjo hipotezë mbështetet në faktin që Shqipëria është një vend i euroizuar dhe i ekspozuar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Studimi përdor të dhënat e marra nga Banka e Shqipërisë për kursin e këmbimit si dhe nga FMN për shtete të tjera si Rumania, Maqedonia, Polonia etj. Ky është një test krahasimor me politikën zyrtare të kursit të këmbimit të këtyre shteteve dhe nuk analizon në detaje nëse ka apo jo ndërhyrje direkte të Bankës në kontroll të kursit të këmbimit.

Pamvarsisht këtyre kufizimeve ky studim është një përpjekje e parë në literaturë për të interpretuar njëkohësisht ideologjinë e reformave institucionale e kombinuar me testime ekonometrike dhe analizim të të dhënave të më shumë se 27 shteteve në 20 vite dhe të më shumë se 50 mijë pyetësor.

1.7 Struktura e Kapitujve

Kjo doktoraturë bën një interpretim të njëkohshëm të ideologjisë së reformave institucionale si dhe të efekteve të saj në rritje ekonomike. Në kapitullin e dytë paraqitet dhe njëherë teoria e rritjes ekonomike në literaturë duke u përqëndruar te modeli Solou dhe te modeli neoklasik i rritjes ekonomike. Më pas interpretimi bëhet për modelet endogjene duke vazhduar analizën me rolin e institucioneve në inkurajim të krijimit të inovacionit dhe të përkufizimit të dhënë nga ekonomistimi

North për institucionet. Nga ana tjetër reformat e Europës Lindore nuk mundet të kuptohen pa analizuar ideologjinë neoliberale e reflektuar në atë që njihet si *“Konsensusi i Uashingtonit”*. Ky kapitull diskuton dhe për rolin që ka stabiliteti i kursit të këmbimit në ekonomi. Kapitulli tre bën një interpretim të të dhënave të përdorura duke dhënë dhe një informacion më të plotë të korrelacionit që kanë ndryshoret me njëra tjetrën dhe shpjegon në detaje ndryshoret e pavarura. Nga ana tjetër ky kapitull shpjegon dhe tre metodologjitë e përdorura për t’iu përgjigjur hipotezave të ngritura në fillim të këtij studimi. Kapitulli 4 analizon rezultatet për hipotezën e parë dhe për hipotezën e dytë. Në këtë kapitull vazhdohet me interpretimin e literaturës përse i përket efektit të reformave institucionale në rritje ekonomike dhe më pas në diskutim për rolin e ashensorit social në mbështetje ose jo të politikave ndërhyrëse të shtetit në ekonomi. Kapitulli pesë shton diskutimin e rolit të reformave neoliberale në promovimin e institucioneve kredithënëse dhe në rolin që ka një kurs këmbimi stabil për një ekonomi të euroizuar si Shqipëria. Kapitulli i fundit ofron një përmbledhje të gjetjeve kryesore të këtij studimi dhe shqyrton diskutimet për studime më të zgjeruara në të ardhmen për tre pyetjet kërkimore të ndërmarra në këtë punim.

KAPITULLI 2: RITJIA EKONOMIKE DHE ROLI I INSTITUCIONEVE

2.1. Hyrje

Ekonomistët kanë pranuar me kohë se prodhimi për frymë në një shoqëri është ngushtësisht i lidhur me sasinë e kapitalit njerëzor, kapitalit fizik dhe atij teknologjik mbi të cilët punëtorët dhe firmat kanë akses. Në këtë kapitull argumentohet se si institucionet në dy dekadat e fundit janë parë si shkak themelor i diferencave të rritjes ekonomike midis shteteve të ndryshme. Reformat institucionale janë reflektim i një ideologjie të caktuar të implementuar në Europën Lindore të cilës këtu i referohet si neoliberalizëm. Ky kapitull synon të shpjegojë teorinë e rritjes ekonomike, rolin e institucioneve si teori e rëndësishme e kësaj fushe dhe më pas rëndësinë e ideve neoliberales në Europën Lindore. Me rëndësi mbetet shpjegimi sesi u shpërndanë reformat institucionale në Europën Lindore dhe se përse kriza ekonomike e vitit 2008 e risjell dhe njëherë rëndësinë e kësaj ideologjie për të kuptuar reformat ekonomike institucionale.

2.2. Teoria e Rritjes Ekonomike


Për të dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet analizuar teoria e rritjes ekonomike. Modeli i parë ekonomik që shpjegon se përse kemi rritje ekonomike është modeli neoklasik i cili thekson rëndësinë e akumulimit të kapitalit. Ky model është

shpjeguar për herë të parë nga *Solow (1956)* dhe *Swan (1956)* të cilët tregojnë se si politikat ekonomike mundet të promovojnë rritje ekonomike duke inkurajuar ngrëzit të kursejnë më shumë. Por modeli gjithashtu shpjegon se rritja ekonomike nuk mundet të vazhdojë përgjithnjë pasi në periudhën afatgjatë rritja ekonomike e një shteti do të varet nga ritmi i progresit teknologjik, të cilën modeli neoklasik e merr si të pavarur nga forcat e tjera të ekonomisë ose ato egzogjene. Ky këndvështrim pesimist i rritjes ekonomike vjen si pasojë e principit të produktivitetit marxhinal rënës, i cili vendos një limit të sipërm të sasisë që një person mund të prodhojë me nivele të ndryshme të kapitalit por me të njëjtin nivel teknologjik.

$$K = sF(K) - \delta K$$

Ky është ekuacioni thelbësor i gjithë teorisë neoklasike të rritjes ekonomike, që shpjegon sesi ritmi i rritjes së stokut të kapitalit në çdo periudhë të dhënë është i varur nga niveli i kapitalit në atë periudhë. Së bashku me nivelin e kapitalit të dhënë historik ekuacioni i mësipërm tregon itinerarin që do të ketë kapitali në të ardhmen. Sipas këtij interpretimi në periudhën kur niveli i kapitalit është i vogël në ekonomi atëherë ai është dhe shumë produktiv dhe në këtë mënyrë të ardhurat e ekonomisë do të jenë të larta në krahasim me stokun e kapitalit në ekonomi, dhe për këtë arsye qytetarët do të kursejnë më tepër sesa niveli që duhet për të tejkaluar amortizimin që vjen nga përdorimi në kohë i kapitalit. Për këtë arsye

stoku i kapitalit do të rritet dhe për rrjedhojë të ardhurat në ekonomi do të rriten. Kjo është nën supozimin se të ardhurat në ekonomi janë funksion i stokut të kapitalit.



Grafik 3: Të Ardhura për Frymë. Diferenca mes Europës Lindore dhe Europës Perëndimore 1940:2010. Burimi: (Maddison, 2008)

Por duke qenë se produktit marxhinal kapitalit është rënës atëherë të ardhurat në ekonomi nuk do të rriten aq shpejtë sa stoku i kapitalit, dhe kursimet po ashtu nuk do të rriten aq shpejtë sa amortizimi. Përfundimisht amortizimi do të jetë i barabartë me kursimet; në këtë pikë stoku i kapitalit nuk do të rritet më dhe rritja e të ardhurave kombëtare do të kenë një fund. Sipas kësaj teorie politikat që

nxisinin rritjen e kursimit do të çojnë në rritje të përkohshme të ritmit të rritjes së akumulimit të kapitalit për një periudhë të caktuar kohe por që në periudhën afatgjatë nuk do të ketë impakt. Në fakt rritja e nivelit të kursimit sjell një rritje të nivelit të prodhimit dhe të stokut të kapitalit. Për këtë arsye ky model arrin në përfundimin se e vetmja arsye përse kemi patur rritje ekonomike afatgjatë në vendet e zhvilluara që nga revolucioni industrial ka të bëjë me ndryshimin teknologjik i cili mundet të ketë efekt neutralizues të të ardhurave marxhinale rënëse.

2.2.1. Konvergjenca e kushtëzuar

Një ndër pyetjet që bëhet nga makroekonomistët është nëse vendet e varfëra do të bëhen po aq të pasura sa vendet e zhvilluara në të ardhmen. Në rast se kjo është e vërtetë thuhet se do të kemi një konvergencë mes shteteve (cross-country convergence). Sipas këtij modeli diferenca mes vendeve të pasura dhe të varfëra do të shuhet në rast se ato do të kenë të njëjtën teknologji dhe të njëjtat përcaktues të akumulimit të kapitalit si ritmi i kursimit, niveli i amortizimit, dhe rritjes së popullsisë. Pra këto kushte i japin një përgjigje kualifikuese pozitive pyetjes se vendet e varfëra do të jenë po aq të pasura në të ardhmen.

Sipas këtij modeli ajo që bën të ndryshëm nivelin e rritjes ekonomike mes shteteve është akumulimi i kapitalit dhe jo teknologjia, pasi kjo e fundit është

lehtësisht e aksesueshme si burim globale. Studimet empirike mbi këtë fushë mbështeten në hipotezën se nëse shtete të varfëra dhe të pasura kanë të njëjtat faktorë (përcaktues) të akumulimit atëherë vendet e varfëra do të rriten më shpejtë sesa vendet e pasura pasi dhe niveli i akumulimit të kapitalit do të jetë më i lartë.

Mbështetësit e teorisë neoklasike të rritjes pa adoptimet e konvergjencës së kushtëzuar arrijnë në përfundimin se vendet do të kenë të njëjtat nivele të rritjes ekonomike. Kjo vjen pasi ato do të ndajnë të njëjtën teknologji mes tyre dhe niveli i rritjes ekonomike do të varet vetëm nga progresi teknologjik. Ky këndvështrim çon në përfundimin se shtetet do të kenë një konvergjencë absolute në nivelin e rritjes ekonomike.

Shqetësimi kryesor që shfaqet në literaturë përse i përket modelit neoklasik të rritjes ekonomike është mungesa e argumentimit të arsyeve të progresit teknologjik të cilën modeli e merr si të mirëqënë. Zbulimet shkencore dhe shpërndarja e teknologjisë në ekonomi janë thelbësore në rritjen ekonomike të këtij modeli, por pikërisht ky faktor kaq i rëndësishëm siç është progresi teknologjik nuk shpjegohet nga modeli neoklasik. Pra teksa ky model jep një argumentim të rëndësishëm të itinerarit të rritjes ekonomike në kohë ai nuk shpjegon ndryshimin e ritmeve të rritjes ekonomike midis shteteve në botë. Modelet endogjene të rritjes ekonomike në fakt shpjegojnë se progresi teknologjik varet nga disa forca ekonomike të brendshme.

2.2.2 Modelet Endogjene


Ndryshimi teknologjik varet nga vendimet ekonomike të firmave të cilat duan të maksimizojnë fitimin e tyre dhe janë të varura nga investimet dhe shpenzimet në shkencë e inovacion, akumulimi i kapitalit njerëzor dhe aktivitete të tjera ekonomike të ngjashme. Si pasojë e kësaj, teoritë e rritjes ekonomike duhet të marrin parasysh këtë fakt duke qenë se edhe ndryshimi teknologjik sjell rritje ekonomike afatgjatë. Thënë ndryshe qytetarëve duhet t'u jepet një incentivë për të përmisuar teknologjinë në prodhim.

Por teoria e endogjinitetit nuk mundet të bazohet në kushtet e ekuilibrit konkurrues të ekonomisë që kërkon që gjithë faktorët të paguhen produktin e tyre marxhinal. Arrow (1962) e zgjidh këtë shqetësim duke thënë se progresi teknologjik është rezultat i paqëllimshëm, një fenomen i cilësuar “të mësosh duke bërë”. Po sipas kësaj teorie progresi teknologjik varet nga prodhimi agregat në ekonomi i kapitalit dhe firmat janë shumë të vogla dhe e marrin ndryshimin teknologjik si të dhëne e të pavarur nga prodhimi i tyre.

Kështu çdo firmë maksimizon fitimin duke paguar K dhe L produktin e tyre marxhinal pa paguar për kontributet e tyre në progresin teknologjik. Ky është dhe thelbi i modelit të parë endogjen të rritjes ekonomike që njihet si modeli AK. Sipas këtij modeli, pra kur njerëzit janë duke akumuluar kapital, “të mësosh duke prodhuar” gjeneron progres teknologjik që tenton të rrisë produktin marxhinal të

kapitalit, duke kompensuar për efektet rënëse të produktit marxhinal të kapitalit kur teknologjia nuk ndryshon.

Modeli rezulton në një funksion të prodhimit të formës $Y = AK$, ku prodhimi marxhinal i kapitalit është i barabartë me një konstante A . Modeli AK në fakt mundet të shpjegojë arsyet përse kemi rritje qëndrueshme të ekonomisë në disa vende të botës ndryshe nga modeli neoklasik. Por nga ana tjetër Modeli AK nuk mundet të shpjegojë arsyet e konvergjencës mes shteteve ose mes rajoneve me njëra tjetrën. Dy lloje konvergjencash vihen re në rritjen ekonomike: konvergjencë absolute dhe konvergjencë e kushtëzuar. Konvergjenca absolute ndodh në ato raste kur vendet e varfëra rriten më shpejtë sesa vendet e pasura pavarësisht karakteristikave të ekonomive respektive. Nga ana tjetër konvergjenca e kushtëzuar e cila ndodh kur një shtet apo një rajon rritet më shpejt në varësi të largësisë nga ekuilibri i rritjes (*steady-state*) të rritjes. E thënë ndryshe nëse dy rajone apo dy shtete kanë të njëjtat karakteristika si niveli i kursimit, niveli i amortizimit të teknologjisë dhe prodhimi agregat i teknologjisë, atëherë ai shtet që fillon me nivele më të ulta të kapitalit për frymë do të ketë rritje më të madhe të ekonomisë sesa një shtet tjetër me nivel të kapitalit për frymë më të lartë.



Grafik 4: Të Ardhura për Frymë Shqipëri, Angolë, Taivan, Haiti dhe Liberi 1950-2010. Këto shtete kanë të njëjtin nivel të ardhurash në 1960 por ndjekin rrugëtime të ndryshme në 50 vitet e ardhëshme.

Marrim si shembull dy rajone brenda të njëjtit shtet ose dy shtete që kanë të njëjtat karakteristika fillestare të ekonomisë. Sipas modelit AK të ardhurat e funksionit të prodhimit agregat janë konstante dhe për këtë arsye shtetet me nivel më të ulët të stokut të kapitalit nuk do të konvergojnë asnjëherë në nivelin e të ardhurave për frymë të atyre shteteve që fillojnë me nivel më të lartë të stokut të kapitalit. Këto dy shtete do të rriten me të njëjtin nivel pavarësisht nivelit të akumulimit të kapitalit. Nga ana tjetër me prodhuktin rënës të kapitalit të ardhurat

për frymë duhet të konvergojnë drejt vlerave të ekulibrit rritës (*steady state*) duke bërë që dhe shpejtësia e rritjes së konvergjencës të ndryshojë.

Duke parë të dhënat mbi ekonomitë e Azisë (sidomos Kinës, Singaporit, Hong Kongut, Tajvanit dhe Koresë së Jugut) të ardhurat për frymë të PBB-së konvergojnë drejt të ardhurave për frymë të vendeve të industrializuara. Për këtë arsye mundet të thuhet se modeli Solow-Swan me analizën e tyre të ardhurave rënëse të kapitalit dhe dinamikat e tranzicionit të rritjes ekonomike janë më afër të vërtetës sesa modeli AK. Sidoqoftë ky model nuk mundet të shpjegojë se përse disa vende po kovergojnë drejt vendeve të pasura dhe disa shtete sidomos ato në Afrikë po largohen nga niveli i vendeve të industrializuara.

Modelet që shpjegojnë arsyet e inovacionit janë më të sakta në shpjegimin e shumë të dhënave makroekonomike drejt konvergjencës dhe rritjes ekonomike afatgjatë. Romer (1986) ndërtoi një model parashikues të rritjes ekonomike i cili mundet të jetë rritëse në periudhën afatgjatë falë shumëllojshmërisë së inputeve në prodhim. Romer plotëson përshkrimin e këtij modeli duke përfshirë sektorin e kërkimit dhe inovacionit si rezultat i sjelljes vullnetare të firmave që kërkojnë maksimizimin e fitimit duke përmblendësuar arsyet e zhvillimit teknologjik. Produktiviteti rritet si pasjoë e specializimit të punës pasi kemi rritje të inputeve në dispozicion për prodhim si dhe përhapjen e njohurisë në shoqëri; ku një firmë inovatore ndërton mbi stokun e shpikjeve të mëparshme. Idetë nuk janë rivale, në

kuptimin që përdorimi i tyre nga një person nuk minimizon mundësinë e përdorimit të tyre nga dikush tjetër. Por nga ana tjetër ato janë përjashtuese pasi lejojnë që një inovacion i sukseshëm të sjell përfitime monopoli për kompanitë në periudhën e parë të shpikjes. Fitimi është arsyeja që çon kompani të ndryshme zbulojnë mënyra të reja të prodhimit.

Për sa mësipër shihet që teoritë e rritjes ekonomike dallojnë nga njëra tjetra. Kështu teoria neoklasike dhe modeli AK përqendrohen në akumulimin e kapitalit ndërsa teoria e Romerit dhe varietetit të prodhimit dhe inputit fokusohen më tepër në inovacion si përcaktues i rritjes së produktivitetit. Growth Accounting është një metodë e dizajnuar nga Solow për të analizuar arsyet e rritjes ekonomike dhe për të kuptuar nëse akumulimi i kapitalit apo inovacioni teknologjik është më i rëndësishëm në rritjen ekonomike. Ekonomistët që kanë analizuar të dhënat sipas kësaj metodologjie shpjegojnë se rritja ekonomike e *Tigrave Aziatike* vjen si pasojë e akumulimit të faktorëve të prodhimit dhe jo të përmirësimit të teknologjisë.

2.2.3. Roli i Institucioneve

Duke u bazuar në rolin që kanë idetë për inovacion në prodhim në rritjen ekonomike historian të ekonomisë si Laureati i Çmimit “[Nobel]” Douglas North (1993) shkruajnë se zhvillimi ekonomik në Europën Perëndimore filloi vetëm atëherë kur filluan të respektoheshin dhe implementoheshin të drejtat e pronësisë.

Ai sugjeron se rritja ekonomike afatgjatë varet nga sjellja e qeverisë në respektimin e pronësisë intelektuale, respektimi i sundimit të ligjit dhe tregjeve financiare. Sipas North akumulimi i faktorëve të rritjes ekonomike si kursimi dhe inovacioni janë pasojë e rritjes ekonomike dhe diferenca në rritje ekonomike shpjegohet vetëm si pasojë e ndryshimeve institucionale. Parente dhe Prescott (1999) argumentojnë se hendeku në të ardhura do të zvogëlohet nëse do të ketë rritje të përdorimit të burimeve njerëzore dhe të kapitaleve nga ato shtete që janë më të varfëra. Efikasiteti rritet vetëm në ato raste kur kemi përmirësim të politikave dhe institucioneve. Ky është një këndvështrim që mbështet dhe nga Acemoglu (2005). Ai shton se “institucionet janë faktori thelbësor që garanton rritje ekonomike dhe diferencës në zhvillim mes shteteve të ndryshme.

North (1991) i përkufizon institucionet si “çdo strukturë apo mekanizëm i rendit shoqëror që rregullon sjelljen e një grupi individësh brenda një komuniteti të caktuar që forçojnë zbatimin e rregullave dhe që rregullojnë sjelljen bashkëpunuese të njeriut. Termi institucion përdoret për zakone dhe lloje sjelljesh në një shoqëri si dhe organizim formal i qeverisë dhe shërbimeve publike. Po aty ai thotë “kufizime të krijuara nga njerëzit për ti ndihmuar në marrëdhëniet mes tyre”.

Ky përkufizim i North përdoret tashmë gjerësisht në literaturën e rritjes ekonomike dhe interpretohet pozitivisht nga Acemoglu (2005, f. 155). Sipas tij

duhet theksuar se institucionet janë të krijuara nga njerëzit, në ndryshim nga vendodhja gjeografike që është e dhënë dhe jo në kontrollin njerëzor. Së dyti, duhet theksuar se institucionet ofrojnë kufizime të sjelljes njerëzore. Padyshim ato lloj ligjesh që shpërblejnë një lloj sjellje dhe ndëshkojnë një tjetër do të kenë efekt mbi sjelljen e shoqërisë ku ato veprojnë. Kufizimet e vendosura mbi sjelljen e qytetarëve nga institucionet do të ndryshojë ndërveprimin e tyre me njëri tjetrin dhe incentivat në ekonomi.

Ekonomiksi i institucioneve është një rrymë e re në ekonomi që mundohet të shpjegojë aktivitetin ekonomik nga këndvështrimi i normave sociale dhe ligjore. Rrënjët e kësaj rryme gjenden në artikullin e Roland Coase, “Natyra e Firmës” 1937. Teoria Coase shpjegon efikasitetin ekonomik që mund të arrihet në rast se egziston problemi i eksternaliteteve. Kjo teori thotë se në rast se kemi kushtet e kryerjes së tregtisë kur kemi eksternalitet dhe këtu nuk ka kosto transaksioni atëherë bashkëpunimi mes palëve do të çonte në një marrëveshje efikase mes tyre.

Sektori publik është parë nga literatura e mëparëshme si shtrembërues të efikasitetit ekonomik duke e orientuar atë drejt shpërndarjes së pasurisë. Kjo është e vërtetë pasi shteti udhëhiqet nga parime dhe objektiva të ndryshme nga ekonomia e tregut. Shteti në tërsi është i interesuar për shpërndarjen e pasurisë mes interesave të ndryshme në shoqëri. Për shembull megjithëse mund të jetë më

efikase që të prodhohet gjithçka nga dy tre kompani në ekonomi kjo nuk do të jetë praktike dhe me konsensus social.

Sipas Bankës Botërore (2002) ka një numër të madh evidence që tregon se ka gjithnjë e më shumë lidhje mes ndërtimit të institucioneve mirë funksionuese dhe rritjes ekonomike për shtete të ndryshme si dhe në kohë të ndryshme. Në këtë këndvështrim është roli i institucioneve të mira që të kanalizojnë informacion të mirë mbi kushtet e tregut dhe që të ofrojnë incentivën e duhur për aktivitetin ekonomik si lehtësues dhe inkurajues në akumulimin e faktorëve prodhues dhe në alokimin efikas të burimeve në ekonomi. Po ashtu siç argumenton dhe Rodrik (2000) ekonomistët i marrin si të mirëqena institucione të tilla si sundimi i ligjit, të drejtat e pronësisë apo mirëqeverisjes, por rëndësia e tyre bëhet më e thekshme në “mungesës e tyre në vendet e varfëra”. Mungesa e institucioneve efikase dhe në ndihmë të tregut sjellin më pas dhe rezultate të gabuara të politikave ekonomike.

Në mënyrë më ilustrative në vitin 1988 prodhimi për punëtor në SHBA ishte 35 herë më e lartë se e një punëtori në Nigeri. Pra një punëtor amerikan prodhonte në dhjetë ditë sa një punëtor Nigerian në një vit. Sipas Robert E. Hall (1999) arsyeja kryesore e kësaj difference mes produktivitetit të këtyre dy punëtorëve ka të bëjë me infrastrukturën sociale. Më këtë të fundit Hall nënkupton se institucionet dhe politikat qeverisëse përcaktojnë kushtet ekonomike në të cilat individët

akumulojnë aftësi pune dhe firmat akumulojnë kapital duke gjeneruar produkte e shërbime.

Niveli i prodhimtarisë, sic pamë më sipër mes dy shteteve si Nigeri dhe SHBA, varet përvec nivelit të kapitalit dhe nga siguria ligjore për të ushtruar veprimtari prodhuese në një ekonomi. Për shembull, në rast se një fermë nuk mundet të mbrohet nga vjedhjet si në rastin e shtetit Nigerisë atëherë fermerët në vend që të angazhohen më shumë orë pune për të mbjellë dhe menaxhuar të korrat e tyre kalojnë më shumë orë në mbrojtjen e fermës nga këta agjentë dhe më pak në prodhim për orë pune. Kështu institucionet sociale që mbrojnë njësitë prodhuese të individit nga përvetësimi i jashtëligjshëm nga anëtarë të tjerë të shoqërisë ekstraekonomik janë esenciale për të zhvilluar infrastrukturë sociale që favorizon nivele të larta të prodhimit për punëtor. Në mënyrë paradoksale ndërkohë që shteti është dhe ofruesi më efikas i infrastrukturës sociale që mbron ndaj diversionit, ai shndërrohet në shumë raste në vendet në zhvillim në një agjent deforumues të aktivitetit ekonomik Përvetësimi, konfiskimi, taksimi abuzues, korrupsioni janë vetëm disa shembuj të diversionit publik të kryera nga shtete që kanë ndërtuar institucione të dobta .

Argumentohet shpesh se mungesa e institucioneve që ndihmojnë zhvillimin e ekonomisë së tregut është arsyeja kryesore se përse ekziston një tranzicion i tejzgjatur si dhe nje rënie e theksuar e prodhimit në këto vende. Për këtë arsye

argumentohet se reformat e ndërmarra në liberalizimin e ekonomisë nuk u shoqëruan me masat e nevojshme për të mbrojtur mekanizmat e tregut nga fuqia e ryshfetit. Rezultati i së këtyre reformave të cunguara rezultoi në paaftësinë e shtetit për të mbledhur taksat dhe në krijimin e kushteve të cilat kontribuan në zgjatjen e periudhës së tranzicionit. (Polterovich, 2007) shkruan se është pikërisht rënia e institucioneve shtetërore që filloi me Bashkimin Sovjetik dhe vazhdoi në gjithë Europën Lindore ajo që shpjegon reçesionin e gjatë pas rënies së sistemit komunist në këto vende.

2.2.3.1. Përse kanë rëndësi institucionet ekonomike sipas Acemoglou?

1- Institucionet ekonomike kanë rëndësi për rritjen ekonomike pasi ato i japin incentivë njerëzve në aktivitetin e tyre për të akumuluar kapital, për të zhvilluar sa më shumë burimet njerëzore, për të përmisuar dhe shpikur teknologji etj. Ato sipas Acemoglut ndikon dhe në shpërndarjen e pasurisë në ekonomi, jo vetëm në akumulimin e pasurisë.

Pra institucione ekonomike  rritje ekonomike t

Shpërndarje të pasurisë t+1

2- Institucionet ekonomike janë të brendshme, si përzgjedhje e përbashkët e shoqërisë. Këtu nuk ka garanci se të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit do të pëlqejnë krijimin e të njëjtave institucione, pasi institucione të ndryshme sjellin

dhe shpërndarje të ndryshme të pasurisë duke rezultuar në shumë raste në konflikte interesi. Në këtë kuptim se kush format instituional do të adoptohet varet nga fuqia politike e grupimeve që i ndërtojnë ato. Kësisoj interesat e shoqërisë nuk përfaqësohen në tërësi nga ndërtimi i këtyre institucioneve.

Fuqia politike  institucione ekonomike t

3- Përse ndodh që përdorimi i fuqisë politike sjell inefikasitet të politikave ekonomike dhe gjeneron varfëri për qytetarët? Po sipas Acemoglut kjo vjen nga konflikti i interesit midis atij grupimi personash që zotërojnë fuqinë politike duke e përdorur atë gjerësisht për të sjellë përfitime për vete. Në periudhën e tranzicionit kemi njëkohësisht transformim të sistemit politik dhe ekonomik të shteteve të Europës Lindore. Ato shtete që krijuan demokraci mirëfunksionuese dhe u shkëputën nga sistemi i vjetër autoritar mundën në këtë mënyrë të krijojnë dhe institucione ekonomike që promovojnë ekonominë e tregut dhe zgjidhin konfliktin e interesit midis pushtetit ekonomik dhe politik. Do të shohim më poshtë sesi shtetet që janë demokratike tentojnë të kenë rritje të lartë ekonomike pasi kanë garantuar liri ekonomike.

4- Transformimi i sistemeve politike krijojnë përpjekjet për përfaqësim politik të grupeve të ndryshme shoqërore duke u legjitimuar në sytë e shoqërisë në përzgjedhjen dhe ndërtimin e institucioneve ekonomike. Megjithëse duket e thjeshtë, ndërtimi i institucioneve ekonomike efikase duhet të jetë një proces i

thjeshtë dhe në të mirë të të gjithë shoqërisë, por në fakt ato varen direkt nga institucionet politike që ndërtohen. Pikërisht kjo ndërvarje mes institucioneve politike dhe atyre ekonomike Acemoglu i njeh si *hierarki institucionale* ku institucionet politike influençojnë në ekuilibrin e institucioneve ekonomike dhe për këtë arsye dhe performancën ekonomike.


Shëmbulli i përdorur nga (Acemoglu D. S., 2005) të bën të mendosh që Revolucioni Industrial në Angli i ka fillesat e saj pas Revolucionit Civil 1492 dhe Revolucionit të Lavdishëm në 1688. Sipas tij, gjatë mesjetës mbretërit zotëronin tërë pushtetin politik dhe për këtë arsye nuk kishin asnjë interes për të mbrojtur pasurinë e tregtarëve apo feudalëve të kohës. Përkundrazi ata përdornin tërë pushtetin e tyre për ti marrë taksa sa më të larta dhe arbitrare ose duke shpërndarë burimet ekonomike për grupet pranë oborrit mbretëror. Por ndryshimet në ligjin e tokës në Angli dhe tregtia me Amerikën solli një pushtet të ri të feudalëve dhe të tregtarëve, të cilët kishin interes që të forconin dhe mbronin sa më shumë të drejtën mbi pronën e tyre duke u bërë rivalë të mbretit duke sjellë rënien e Stjuartëve. Kjo sipas Acemoglut solli dhe institucione të reja politike dhe për rrjedhojë dhe institucione ekonomike duke sjellë forcimin e të drejtave të pronësisë dhe tokës duke nxitur dhe ekspansionin tregtar dhe revolucionin industrial me pasojë të një shpërndarje krejtësisht të re të burimeve ekonomike. Për këtë arsye transformimi ekonomik i Europës Lindore nuk mundet të kuptohet

plotësisht pa marrë parasysh institucionet politike dhe funksionimin e tyre gjatë kësaj periudhe. Ky kapitull do të shqyrtojë arsyet se përse këto vende ndërmorrën reforma ekonomike të ngjashme me vende të Amerikës latine ku do të theksohet roli i ideologjisë neoliberale dhe institucioneve të tjera si Banka Botërore dhe FMN.

2.2.2.2. Eksperiment natyror

Për të parë efektin e institucioneve politike dhe më pas efektin që ka në rritje ekonomike shpeshherë literatura e ekonomisë së zhvillimit ofron shembullin e Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut. Gjatë Luftës së Dytë Botërore Korea ishte nën sundimin Japonez. Me kapitullimin e Japonisë më 15 Gusht 1945 forcat Sovjetike hynë në Mancuri dhe morën Korenë e Veriut. Ndërkohë Syngman Rhee i cili mbështetej nga Amerikanët u zgjodh president dhe ishte pro ndarjes së Koresë në dy shtete. Deri para vitit 1948 të dy Koretë kishin të njëjtën kulturë, institucione dhe gjuhë tejet homogjene. Më pas paraleli 38, ndau dy Koretë ku veriu zgjodhi mënyrën sovjetike të organizimit të ekonomisë dhe politikës. Jugu nga ana tjetër zgjodhi ekonominë e tregut dhe demokracinë dhe të drejtën e pronës private. Ky është një eksperiment natyror mbi rëndësinë e institucioneve. Veriu kishte të njëjtin qëllim si dhe Jugu që ta bënte shtetin sa më të fuqishëm dhe të pasur. Por mënyra sesi e organizoi prodhimin dhe incentivat në ekonomi bëri që të mbetej mbrapa dhe të çonte deri në uri për popullatën në vitet 1990 ku me miliona njerëz vdiqën. Nga ana tjetër Jugu prodhon teknologji të lartë duke

përfshirë kompani globale si LG dhe Samsung. Në vitin 2000 Korea e Jugut kishte të ardhura për frymë afërsisht 16,000 Dollar ndërkohë që Korea e Veriut kishte të ardhura 1000 dollar për frymë duke u renditur në grupimin e atyre shteteve të varfëra të kontinentit Afrikan. Në grafikun më poshtë kemi përpunuar të dhënat e marra nga viti 1950 deri në vitin 2010 për PBB për frymë ku vihet re diferenca e theksuar e prodhimit për frymë.



Grafik 5: Eksperiment Natyror: Rritja Ekonomike mes Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut

2.3. Si u ndërmorrën reformat institucionale në Europën Lindore?

Çdo shtet ka ekuilibrin e tij të institucioneve ekonomike të cilat sipas *Acemoglut* (2006, f. 34) mund të jenë krejtësisht efikase bazuar në teorinë Coase të Politikës. Sipas saj, politikbërësit do të zgjedhin ato institucione që janë efikase dhe që garantojnë rritje ekonomike pasi për zgjedhja e institucioneve nuk varet nga përfitimet e atyre grupeve të interesit që mund të kontrollojnë pushtetin politik. Në fakt nga ky këndvështrim sistemi politik demokratik lejon negociatën e përhershme mes grupeve të interesit e cila çon në reforma ekonomike pa kosto, pa konflikte sociale, e cila njihet si teoria Coase e Politikës.

Por grupet e interesit nuk arrijnë gjithnjë në mirëkuptim dhe ato ndajnë këndvështrime të ndryshme për llojet e institucioneve që duhen ndërtuar në një shoqëri për shkak të ideologjisë që kanë mbi atë se çfarë është e duhur apo e gabuar në një ekonomi. Duke qenë se ideologjia ndikon më pas në vendimarrje politike atëherë shoqëri të ndryshme nuk mundet të kenë institucione të ngjashme me njëra tjetrën dhe për rrjedhojë dhe kanë rritje ekonomike të ndryshme. Ndaj është e rëndësishme të kuptojmë ideologjinë e përdorur nga elita politike në Europën Lindore pas rënies së Murit të Berlinit. Për këtë arsye shpesh herë thuhet se reformat institucionale të Europës Lindore ishin reflektim i ideologjisë *neoliberale* të shpjeguara nga *Konsensusi i Uashingtonit*.

Rritja e ideologjisë neoliberale shihet si një ideologji e gjithëpushtetshme e cila e ka shndërruar në “*common sense*” mënyrën sesi mendojmë për reformat ekonomike.

Neoliberalizmi është parë nga *Larner (2000, f.17)* si:

- a. Një paradigëm politike
- b. Një ideologji hegjemonike
- c. Si formë qeverisëse.

Neoliberalizmi shihet si një ideologji e cila është ndërtuar në disa qendra, dhe që më pas shpërndahet në rrethina si projekt politik i cili mundohet të riorganizojë gjeografinë territoriale të akumulimit të kapitalit. Por teoritë neoliberale shoqërohen dhe nga kritika të cilat thonë se ajo ul demokracinë, krijon varfëri dhe pabarazi dhe është një sistem i imponuar nga jashtë. Literatura e ekonomive në tranzicion sheh implementimin e ideve neoliberale nëpërmjet asaj që u njoh si Konsensus i Uashingtonit. Në pjesën që vijon në këtë kapitull ne do të shpjegojmë ideologjinë neoliberale, si u shpërnda ajo në Europën Lindore, çfarë institucionesh ekonomike kërkonte të ndërtonte dhe sa të sukseshme kanë qënë ato?

2.3.1. Institucionet dhe Konsensusi i Uashingtonit

Neoliberalizmi ose Konsensusi i Uashingtonit thuhet shpesh se ajo mbështet nga SHBA dhe organizmat e Breton Woods të cilat i imponohen vendeve në zhvillim. Në formën e saj më abstrakte dhe universale, neoliberalizmi është një program i mbështetur mbi stabilizimin ortodoks të ekonomisë, me bilanc fiskal duke ulur shpenzimet publike dhe pa rritje taksash, liberalizim i çdo lloj pengese për t'u integruar në tregun ndërkombëtar, privatizim të ndërmarrjeve shtetërore dhe gjithashtu adoptim të ligjeve perëndimore mbi pronën private, dhe ndërtimin e politikave sociale kompensuese të cilat ndihmojnë në uljen e efekteve të pabarazisë që mund të vinë si pasojë e platformës ekonomike të aplikuar.

Megjithëse fjala neoliberal është përdorur për një kohë të gjatë ajo ka marrë vlerën e saj teorike vetëm në fund të viteve 1990. Sipas Hay (2004) neoliberalizmi shfaqet si një reflektim empirik dhe konceptual mbi një proces politik që më parë ishte pagëzuar me globalizëm. Neoliberalizmi sipas Barneet i referohet atyre ideve që merren me ripërtëritjen e ideve ekonomike të mes shekullit XX. Duke përfshirë shkollën Austriake të Ekonomisë me themelues Ludëig von Mises, Friedrich von Hayek dhe Joseph Schumpeter të karakterizuar nga një përkushtim ndaj metodologjisë së individualizmit, një antipati të plotë për shtet të përqendruar dhe që planifikon në ekonomi, por të përkushtuar ndaj principeve të pronës private dhe kundër epistemologjisë antiracionale.

Konsensusi i Uashingtonit

Shumë prej reformave të ndërmarra ishin pjesë e Konsensusit të Uashingtonit, një term që i atribuohet ekonomistit Xhon Uilliamson. Ky term do të ishte dhe në qendër të debateve ideologjike ndërkombëtare ku sipas autorit ai nuk e dinte fare se c'përmasa do të merrte ideja e tij. Termi i përdorur prej tij u prezantua në një konferencë në vitin 1989, pak kohë para se sistemi komunist i organizimit të ekonomisë të dështonte.

Sipas tij ishin dhjetë pika të cilat ishin kryesore të një pakete reformuese për çdo vend në zhvillim. Në fillim të viteve 1990 Shqipëria dhe vende të tjera të Europës Lindore ishin pikërisht në një situatë ku i duhej të shkundnin 45 vjet ose më shumë suprimim të iniciativës së lirë. Këto vende kërkonin të arrinin sistem ekonomik e politik të ngjashëm me atë të Europës Perëndimore, por pa patur asnjë trashëgimi domethënëse gjatë historisë së tyre për ta përdorur si fanar për reformat e të ardhmes. Ndaj çfarë propozohej nga Konsensusi i Uashingtonit u shndërrua në “bibël” të politikave ekonomike në vend.

Objektivat kryesore pra në atë periudhë ishin:

1. Disiplinë Fiskale- shumë vende të Amerikës Latine kishin pasur problem me borxhin publik duke çuar në falimentim dhe inflacion të lartë gjatë viteve 1970-1980.

2. Riorinetim të shpenzimeve publike- orientim të shpenzimeve për rritje ekonomike dhe që do të ishin në të mirë të të varfërve si në arsim, infrastrukturë dhe shëndetësi.
3. Reforma të sistemit të taksave
4. Liberalizim të normave të interesit- e cila përfshinte liberalizim financiar
5. Një kurs këmbimi të monedhës vendase konkurruese pra floating.
6. Liberalizim të tregut
7. Liberalizim të hyrjes së investimeve të huaja direkte
8. Privatizim në masë; kjo ishte dhe një ndër idetë kryesore neo-liberale dhe që u mbështet gjerësisht nga ekonomistët e kohës.
9. De-rregullim- heqja e barrierave për hyrjen ose daljen e firmave në treg ose që të kontrolloheshin çmimet në treg.
10. Të drejtat e autorit, shërbenin për ti dhënë sektorit informal mundësinë për të marrë të drejtat e autorit me kosto të ulët³.

Këto politika ekonomike duhej të adaptoheshin në masë nga vendet në Amerikën Latine, Afrikë dhe Europën Lindore. Ky këndvështrim i masave që duhet të ndërmerrete shteti për të siguruar rritje ekonomike dhe ulje të varfërisë përbëjnë dhe idetë që shoqëruan ideologjinë neoliberale të viteve 1990-2000. Kjo ideologji e re, ose politikë ekonomike e re ndërkombëtare ishte një përgjigje e problemeve

³ (John Williamson, 2004)

makroekonomik që shoqëruan Amerikën Latine gjate viteve 1970-1980. Si përgjigje e problemeve të tyre këto dhjetë pika dukeshin si të përshtatshme duke u shndërruar në konsensus, gati global, ku të tërë ishin të gatshëm të vilnin të mirat e ekonomisë së tregut. Eksperienca e Europës Lindore si dhe e vendeve të tjera në zhvillim tregoi se ndërhyrja e gjerë e shtetit në ekonomi çonte në shtrembërim të efikasitetit duke ulur nxitjen e qytetarëve për tu angazhuar në aktivitete ekonomike inovatore. Ky model i ri u aplikua dhe u pranua gjerësisht duke hapur ekonominë globale e ndihmuar dhe me avancimin teknologjik të paprecedentë në historinë njerëzore. Duhet theksuar se Uilliamson nuk ishte detyrimisht pro uljes së rolit të shtetit në ekonomi. Në pikën 8 ku kërkohet privatizim ai nuk e kërkon këtë si qëllim në vetvete uljen e rolit të shtetit por si objektiv për të rritur efikasitetin e ekonomisë.

Gjithsesi disa prej kritikave që po i adresohen këto vite kësaj politike ekonomike kanë të bëjnë me mos adresimin e rëndësisë së institucioneve dhe këndvështrimit se një politikë është e vlefshme njësoj për të tërë shtetet. Kritikët thonë se reformat standard të imponuara mbi këto shtete ishin të gabuara dhe askush nuk beson më në Konsensusin e Uashingtonit. Në mungesën e një plani konkret për integrim në BE dhe në injorim të një plani Marshall për të zëvendësuar vakumin e lënë nga rënia e sistemit të centralizuar Evropa Lindore ra në recension akoma dhe më të madh. Ku vende si Gjeorgjia humbën rreth 75% të vlerës së PBB

krahasuar të vitit 1989. Në analizën e tij Dani Rodrik nga Universiteti i Harvardit shprehet se debati nuk duhet të jetë nëse Konsensusi i Uashingtonit ekziston apo jo, por se çfarë do ta zëvendësojë atë. Sipas tij pati më shumë privatizim, derregullim të tregut dhe liri të tregtisë me jashtë se asnjëherë më parë në historinë njerëzore. Po sipas tij e vetmja gjë mbi të cilën mundet të biem dakort pas këtyre reformave është se gjërat nuk shkuan ashtu siç pritej, sidomos në Amerikën Latine.

Në shumë vende të Europës Lindore dominuan reformatorët radikal të cilët u vendosën njëherazi në krye të reformave. Në Poloni në krye u vendos Leszek Balcerowicz në Çeki Vaclav Klaus dhe në Rusi Yegor Gaidar. Ata vendosën për programe ekonomike të cilat nga njëra anë shkurtuan shpenzimet qeveritare dhe liberalizuar investimet dhe tregtinë por nga ana tjetër çuan në falimentimin e mijëra firmave të cilat ishin të specializuara në tregti me vende të tjera të lindjes. Dihet që eksperiencia dhe teknologjia e avancuar e firmave perëndimore nuk mundën të konkurroreshin nga ato lindore, dhe të dhënat tregojnë në se në dy vjet rreth 90% e gjithë tregtisë tashmë bëhej me vendet e perëndimit Orestein (2009).

2.4. Beteja e ideve dhe reformat institucionale në Europën lindore

Fjala neoliberalizëm përdoret shumë pak në gjuhën shqipe dhe shumë pak ekonomistë vendas janë në gjëndje të përkufizojnë këtë rrymë të mendimit

ekonomik e politik dhe aq më pak publiku i gjerë. Por nuk duhet harruar se reformat e ndërmarra në këto 20 vite në ekonominë shqiptare nuk ishin asgjë më shumë apo më pak se reforma neolibérale. Ndaj në këtë kapitull do të kuptojmë se çfarë do të thotë neoliberalizëm dhe përse këto politika shiheshin si politikat më të mira për Europën Lindore dhe nëse reformat neolibérale ishin të imponuara nga jashtë, sidomos nga SHBA, apo ishin idetë më “të mira në treg”. Kjo pasi po të shtronim pyetjen se çfarë politikash do të ndërmerrnin vendet e Europës Lindore në rast se komunizmi do të kishte rënë në fund të viteve 1960-të me Pranverën Ceke dhe jo në fund të viteve 1980 më rënien e Murit të Berlinit me siguri do të arrinin në një tjetër përfundim.

Në këtë këndvështrim neoliberalizmi megjithëse një alternativë e politikave ekonomike të Kejnsianzimit që në fillim të viteve 1950-të sërish nuk kishte patur asnjë aplikim në vendet e zhvilluara deri në vitet 1980-të dhe mbetet ende dhe sot një rrymë ideologjike që përdoret më tepër e ngarkuar negativisht në diskursin e politikave ekonomike dhe pa një përkufizim të qartë dhe gjithëpërfshirës.

Në fakt hera e parë që idetë Neolibérale do të viheshin në jetë dhe do të “shënonin” një ekonomi që vuante nga inflacioni i lartë dhe borxh publik i lartë ka qënë Kili në vitin 1973. Dhe siç dihet, beteja e ideve mes neoliberalëve dhe kejsianiste vazhdoi për më shumë se tre dekada deri në fillim të viteve 1980-të ku Hayek e Friedman do të dilnin fitues dhe do të ndryshonin politikat ekonomike

të dy prej vendeve më të zhvilluara në OECD si SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar. Artikulimi dhe besimi i ideve liberale në kalimin e krizës ekonomike e kombinuar me inflacion të lartë dhe rënie të PBB-së bëri që SHBA dhe MB të ofronin një alternativë ndaj shtetit social të vendosur në Europën Perëndimore apo dhe sistemit të centralizuar të Europës Lindore. Në këtë periudhë, pikërisht gjatë viteve 1980, shumë vende të Amerikës Latine vuajtën nga kriza të borxhit të lartë publik duke kërkuar ndihmën e FMN-së për të kaluar këto vështirësi. Recetat e vendosura mbi ekonominë e Amerikës Latine shërbyen si faktorët kryesorë në krijimin e Konsensusit të Uashingtonit me dhjetë pika që ishin të shkruara nga Ekonomisti Uilliamson si një konsensus i arritur mes akademikëve për mënyrat më të mira për të kaluar krizën financiare të Amerikës Latine.

Në këtë këndvështrim është e vështirë të kuptohen reformat e ndërmarra në Europën Lindore pa u rikthyer në kohë për të kuptuar fitoren e ideve liberale të Von Hayek, von Mises dhe Friedman. Gjithashtu është e vështirë të kuptosh imponimin dhe kushtëzimin e FMN-së, Bankë Botërore apo dhe *BERZH* për reforma liberale në këmbim të kreditimit gjatë viteve 1990. Idetë neoliberale u adaptuan si kundërpërgjigje ndaj krizës së viteve 1970-të dhe sot ajo është vendosur në pikëpyetje si pasojë e krizës financiare të vitit 2008. Pra duket sikur neoliberalizmi lindi nga kriza dhe mundet të shuhet po nga kriza. Ndaj ky kapitull

shërben si një analizë e historisë së mendimit ekonomik dhe evoluimin e tyre si politika më e përshtatshme për vendet post-komuniste.

2.4.1. Përdorimi i gabuar dhe mungesa e përkufizimit neoliberal

Neoliberalizmi, shkruan Roy (2007, f.43-45) ‘mund të kuptohet si referencë e eksperimenteve që aplikojnë idetë e tregut në kontekste politike, sociale dhe ekonomike’. Sido që të jetë neoliberalizmi në Europën Lindore duhet trajtuar në fushën e politikave ekonomike më tepër sesa ekonomiksi i shekullit XX-të. Neoliberalizmi përfaqëson një ritheksim të pretendimeve bazë të ideve liberale të politikave ekonomike që dominuan ideologjinë politike gjatë shekullit të 19-të në Britani dhe SHBA. Boas (2009) ka zhvilluar një studim të detajuar të përdorimit të fjalës neoliberal në artikujt shkencor në gjuhën angleze. Sipas tij nga disa përdorime të pakta në vitet 1980, fjala neoliberal ka shpërthyer në dy dekadat e fundit duke u përdorur mesatarisht në 1000 artikuj akademik në vit nga viti 2002-05. Neoliberalizmi është një koncept mbizotërues në artikujt shkencor në ekonomiks zhvillimi dhe në politika ekonomike duke eklipsuar terma të ngjashëm si monetarizmi, neokonservatizmi, Konsensus i Uashingtonit apo dhe reformë tregu.

2.4.2. Paragjykimi neoliberal

Akademikët jo vetëm që i japin një kuptim negativ termit neoliberal, por shpesh herë ata dështojnë në kërkimin e tyre empirik ta përkufizojnë atë. Sipas studimit të *Boas (2009)* më shumë se 69% e gjithë artikujve akademikë nuk ofronin asnjë përkufizim të termit neoliberal. Nga viti 1990 deri në 1997 pothuajse 63% e artikujve nuk jepnin një përkufizim, nga viti 1998 deri në 2001 69% nuk bënë një gjë të tillë dhe nga 2002-2004 76% e artikujve.

Tabela 1: Valenca Normative e neoliberalizmit				
	Pozitiv	Negativ	Neutral	Miks
Artikuj Shkencor	3%	45%	45%	7%


Burimi: Boas(2009, fq.6)

Kjo tendencë për të përdorur termin neoliberal në shumë hulumtime të shkencave sociale pa e përkufizuar atë, ose dhe duke e përdorur negativisht këtë term, nuk reflektohet në terma të tjerë të shkencave sociale si është termi demokraci *Levitsky (1996:4)*.

Si përfundim Boas shkruan se për të përdorur termin neoliberal si një formë analitike dhe jo si vlerë retorike për shkencat sociale i duhet atribuuar kuptim domethënës se çfarë e bën neoliberalizmin ndryshe nga liberalizmi. Ata propozojnë tre mënyra sesi ky term mundet të përdoret në mënyrë më efektive në

punime akademike në të ardhmen: të shpjegojë se si kapitalizmi modern është thelbësisht i ndryshëm nga modele të mëparshme të politikave ekonomike, të karakterizojë se çfarë është ndryshe mes liberalizmit në vendet në zhvillim dhe në vendet e industrializuara; ose të rafinojë tipologjitë e tregjeve kombëtare.

Ky proces sipas tyre mundet të arrihet vetëm me nisjen e një debati për neoliberalizmin dhe për ta shndërruar atë në një instrument të nevojshëm analitik. Për këtë arsye në vijim do të bëhet një dallim mes liberalizmit dhe neoliberalizmit. Më pas një përkufizim të termit neoliberal dhe më e rëndësishmja është si duhet të kuptohen shumë prej reformave institucionale të Europës Lindore dhe Ballkanit pas rënies së Murit të Berlinit.



Grafik 6: Artikuj që Përkufizojnë Termin Neoliberal

Ato që përdorin termin neoliberal e aplikojnë atë në disa fenomene të gjerë ekonomik, social dhe politik. Gjithsesi përdorimi më i shpeshtë i termit neoliberal i referohet politikave reformatore në ekonomi që liberalizojnë ekonominë, eliminojnë kontrollin e çmimeve, de-rregullojnë tregjet e financiare dhe ulin barrierat tregtare; duke ulur rolin e shtetit në ekonomi, sidomos nëpërmjet privatizimit të aseteve shtetërore, duke ofruar shkurtim të shpenzimeve publike dhe stabilizim makroekonomik, duke përfshirë kontrollin e fortë të ofertës monetare, eliminimin e deficitit buxhetor dhe uljen e subvencioneve shtetërore (Boas, 2009, f.23).

Së dyti neoliberalizim i referohet modelit të zhvillimit. Kështu në vend të ofrimit të një liste me zgjidhje teknokrate të problemeve të ekonomisë, ky model neoliberal ofron një set teorisë ekonomike të veçuara në një të vetme si mundësi e rritjes ekonomike dhe zhvillimit, duke ofruar rolin që duhet të kenë në ekonomi sindikatat, sipërmarrja e lirë, shteti dhe një projekt të qartë politik për ti arrirë ato dhe për tu siguruar se “lojtarët” luajnë sipas rregullave. Në këtë këndvështrim roli neoliberal si ekonomiks zhvillimi dallon krejtësisht nga roli i mëparshëm i shtetit si lider i zhvillimit, duke ofruar role të tjera politike të sindikatave, punës kapitalit dhe shtetit. Ndaj implementimi i një modeli neoliberal nënkupton ristrukturim të marrëdhënieve shtet-shoqëri (Kurtz, 1999).

Një mënyrë e tretë e përdorimit të saj është një demarkim ideologjik. Në këtë këndvështrim akademikët i referohen ideve normative të rolit të individit kundrejt asaj kolektive dhe parja e lirisë individuale si një virtyt shoqëror. David *Carruthers (2011)* për shembull argumenton se “ideologjia neoliberale kërkon që të reduktojë shtetin në minimum dhe të maksimizojë liritë individuale”. Liderët politik nuk duhet të japin një utopi të vetme por përkundrazi individët duhet të kërkojnë veten dhe interesin e tyre në një treg të lirë dhe efikas. Ndaj neoliberalizmi është një përshkrim ose përkufizim i përgjithshëm sesi duhet të organizohet shoqëria dhe një plan konkret për të.

Një përdorim final i termit neoliberal, karakterizon një model (paradigmë) akademik i cili bën supozime pozitive si funksionon tregu, dhe në këtë pikëpamje është shumë afër teorisë neoklasike të ekonomisë. *John Brohman (1995)*, për shembull thotë se individët dhe firmat janë maksimizuese të utilitetit dhe fitimit të tyre të cilët përgjigjen në mënyrë racionale sinjaleve të tregut. *Laurence King (2002)* e përdor neoliberalizmin për t’ju referuar jo vetëm një paketë politikash, por gjithashtu për të studiuar dhe analizuar ato shtete që janë në tranzicion nga socializmi në kapitalizëm.

2.4.3. Liberalët dhe Neoliberalët: shtytësit e reformave ekonomike botërore

Neoliberalizmi është një fjalë e përdorur gjerësisht në rangjet akademike në botë pas vitit 1990 por sërish ajo mbetet e vështirë për t'u përkufizuar qartë se çfarë nënkupton. Gjithashtu është e vështirë të përdoret fjala në kuptimin pozitiv apo si një formë e vetë-identifikimit ideologjik. *Thorsen (2009)* beson se neoliberalizmi është një koncept i nevojshëm për të kuptuar kërkesat e fundit për de-rregullim të tregjeve, reforma në sektorin publik që do t'i bënte agjencitë publike më të ngjashme me ato private megjithëse nuk është e qartë se si ky trend është njëkohësisht i ri (neo) dhe liberal.

Nga vetë fjala neoliberal mund të mendohet që bëhet fjalë për një ringjallje të liberalizimit klasik. Ky interpretim intuitiv do të nënkuptonte se idetë liberale kanë munguar për një kohë të gjatë nga debatet politike dhe politikbërjes dhe tani ajo po rikthehet nga një sukses në fillimet e saj, e pasuar me rënie dhe së fundmi me ringritje. Nga ana tjetër fjala neoliberal mundet të nënkuptojë një ideologji të vecantë nga liberalizmi fillestar me rrënjë të përbashkëta, por jo të njëjta. Për të kuptuar neoliberalizmin është e rëndësishme të rikthehemi dhe njëherë në kuptimin e fjalës liberal, ku sipas *Ryan (1993)* është e rëndësishme të bëhet dallimi mes liberalizmit klasik dhe atij modern. Liberalizmi klasik sipas Ryan i

atribuohet Xhon Lok dhe Adam Smith si dhe Alexis de Tocqueville dhe Friedrich von Hayek si përfaqësues të rinj të ideve klasike të liberalizmit.

Në këtë këndvështrim liberalizmi klasik thotë se shteti duhet të jetë *minimal* në ekonomi, ku gjithçka duhet të prodhohet dhe menaxhohet nga qytetarët pa ndërhyrje dhe nga biznese që vendosin vetë të marrin pjesë në treg. Shteti në këtë rast duhet të jetë prezent vetëm me forcat e armatosura, implementimin e ligjit në shoqëri si dhe ofrimin e shërbimit vetëm për ato të mira që nuk janë përjashtuese. Shpesh herë këtë e quajnë dhe shteti si *roje nate* për të garantuar aspekte më minimale të shtetit. Kështu liberalizmi klasik favorizon politikatat ekonomike të *laissez-faire*- sipërmarrje të lirë- që shpesh i vishet dhe përkrahësve të neoliberalizmit duke e bërë të djathtë në mbështetje.

Liberalizmi modern karakterizohet nga një dëshirë më e madhe e shtetit për të marrë pjesë në ekonomi duke sugjeruar një rol më të madh për të rregulluar tregun dhe që shteti të prodhojë të mira dhe shërbime bazike për të tërë në shoqëri. Kështu që liberalizmi modern është një rishikim i thellë i liberalizmit klasik, sidomos kur bëhet fjalë për ekonominë.

Liberalët modern mendojnë se nëse ne kërkojmë që disa të mira dhe shërbime bazike të jenë realitet për qytetarët atëherë duhet të kemi më tepër rol të shtetit në ekonomi. Teoricienë të shekullit 19-të si Benjamin Constant dhe John Stuart Mill apo më aktual si John Deëy, Uilliam Beveridge, dhe John Rawls kanë artikuluar

ide të ngjashme duke dashur të kontribuojnë në ideologjinë liberale. Por rekomandimet e këtyre politikave janë më të ngjashme dhe mbivendosen me shumë praktika të shteteve social demokrate. Pasi ata kërkojnë që shteti të ndërhyjë dhe të rishpërndaje pasurinë dhe pushtetin në ekonomi dhe shoqëri në emër të një shoqërie më të denjë dhe më të drejtë. Ndaj në këtë interpretim, idetë liberale modern qëndrojnë më shumë në *të majtë* të liberalizmit klasik.

Pavarësisht këtyre diferencave në dukje Gray shkruan qartë në librin e tij “*Liberalizmi*” se:

Të tëra variantet e traditës liberale kanë një konceptim të qartë, modern në karakter të njeriut dhe shoqërisë. Elementet e këtij konceptimi janë:

1. Individualist, duke qenë se i jep rëndësi primare moralit të personit kundrejt kolektivizmit shoqëror; 2. Egalitarian, i jep çdo njeriu të njëjtin status moral dhe mohon interpretimet e ndryshme ligjore apo politike me pasoja morale që të jenë relevante për njerëzit, 3 Universalist; duke vlerësuar unitetin moral të qënieve njerëzore duke i dhënë rëndësi të dorës së dytë formave kulturore apo asocimeve historike. 4. Përmirësuese, të gjitha institucionet sociale dhe rregullave politike janë të korrigjueshme dhe të përmisueshme. Është ky konceptim i njeriut dhe shoqërisë që i jep liberalizmit një identitet të qartë që kapërcen kompleksitetin dhe varietetin e madh të brendshëm (Gray, f.4 1995).

Pavarësisht dallimeve mes liberalizimit klasik apo modern, Ryan shkruan se liberalizmi është një grup teorish politike që theksojnë pikë së pari, se të gjithë individët duhet të jenë në gjendje të zgjedhin mes opsioneve të ndryshme të cilat janë vendime që përcaktojnë jetën tonë, së dyti liberalizmi përfshin idenë se

sundimi i ligji dhe qeverisje demokratike duhet të drejtojnë shoqërinë; dhe së fundmi ai beson se fuqia e shtetit duhet përdorur me kujdes dhe me kufizime kushtetuese, si ndarja e pushteteve sic dhe sugjerohet nga liberalët Locke dhe Montesquieu. Liberalizmi është më pak një ideologji “*partizane*” e anëshme dhe më tepër një trashëgimi që e ndajnë ata persona të cilët kanë ideale të tilla si demokracia dhe liria (Thorsen, 2009). Në këtë kuptim i gjithë procesi i reformave ekonomike e institucionale të ndodhura në dy dekadat e fundit duhen parë si zgjedhje e brendshme e shteteve në interes më të mirë të tyre dhe jo si një imponim nga jashtë i një rendi të ri ekonomik.

2.4.4. Nga Liberal në Neoliberal.

Kur u shfaq për herë të parë termi neoliberal dukej si një term që mundej të përkufizohej lehtësisht dhe pa shumë keqkuptime. Në arenën ekonomike dallimi mundej të bëhej me Kejnsianzimin, si ideologjia ndërhyrëse në treg, dhe duke theksuar rolin e tregjeve që mirë funksionojnë. Neoliberalizimi shihej si një ideologji e cila shihte shtetin si të korruptuar dhe jo efikas në vend të pikëpamjes së shtetit si dashamirës dhe progresist. Nga ana ideologjike zhvillimi i interesave vetjake të qytetarëve si një mënyrë për të garantuar liri u ofrua si një alternativë ndaj kolektivizmit. Nga fillimet e implementimit të saj nga Thaçer dhe Reagan më shumë se tridhjet vjet më parë sot rihapet dhe njëherë debati nëse neoliberalizmi u përkufizua ndonjëherë qartë me gjithë përdorimin e tij të gjerë në artikuj

akademik dhe në leksikun popullor. Ndaj shtrohet shpesh pyetja se sa larg është ky term nga globalizimi si përshkrues i kapitalizmit modern? Ose si qëndron apo ndryshon neoliberalizmi nga Rruga e Tretë apo tregjet sociale? Shumë politikanë, teoricienë dhe ideolog krenohen që janë larguar nga neoliberalizmi por në fakt në politikat që zgjedhin janë “të kapur” prej saj (Yalman, 2010, faqe 14).

Sipas fjalorit të Oxfordit fjala neoliberal është: *“një formë e modifikuar ose e rilindur e liberalizmit tradicional e cila përkrah kapitalizmin e tregje të lira dhe të drejtat e individit”* (Dictionary, 2012). Një degë e hershme e këtij mendimi ishin mendimtarët gjermanë të viteve 1920-50 që njiheshin si *Ordoliberal*. Ata ishin të përkushtuar për të rikthyer pushtetin e institucioneve kapitaliste në një kontinent ku regjimet komuniste dhe fashiste po thyenin rolin e tregut. Ata kërkonin ndërtimin e institucioneve politike si shteti i së drejtës, federalizmi dhe demokracinë të cilat do të ishin ndihmëse të mekanizmave të tregut.

Mirowski (2009) thotë se ajo çfarë e bën të dallueshëm neoliberalizmin nga forma klasike e saj është marrëdhënia e anasjelltë mes politikës dhe ekonomisë. Argumentet në favor të lirive ishin më të shumta ekonomike sesa politike, duke identifikuar paanshmërinë e forcës së tregut si mënyra më e mirë për të siguruar mirëqenie për popullatën dhe liritë personale. Argumenti i Hayek ishte se nëse në një shoqëri shumica e vendimeve janë të centralizuara nga shteti atëherë kjo do të çonte në mirëqenien dhe liritë e qytetarëve të saj. Në kohën kur shkruante Hayek

shtete demokratike kudo në botë filluan të merrnin më shumë përgjegjësi për mirëqënien e qytetarëve të saj. Një grup i vogël ekskluziv në mbështetje të ideve liberale si ekonomistë, filozofë, dhe historianë u takuan në Zvicër dhe krijuan shoqatën e Mont Pelerin (i pagëzuar sipas resorit ku u takuan në vendin helvatas, në vitin 1947). Karl Popper, Milton Fridman, Ludwig von Mises. Ky grupim njerëzish e mbanin vetën për liberal, në kuptimin që i besonin lirive individuale por gjithashtu ishin neoliberal në kuptimin që mbështesnin idetë e tregjeve të lira sipas ideve të ekonomistëve neoklasikë. Kështu që idetë neoliberale ishin kundër teorive të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi si ato që mbështeteshin nga Kejnsianistët që u rritën shumë influencën e tyre pas krizës së vitit 1929 (*Mirowski, 2009*).

Rutland (2012) shton se neoliberalizmi ka një marrëdhënie komplekse me demokracinë. Në vetëvete neoliberalët janë mbështetës të fortë të demokratizimit por nga ana tjetër kritikët shtojnë se është e vështirë për shtete që sapo kanë filluar rrugëtimin drejt demokratizimit të ndërmarrin gjithashtu reformat të menjëhershme, të forta dhe të rëndësishme që kërkohen nga reformimi i tregut.

Reformat neoliberale sjellin kosto të larta të menjëhershme në periudhën afatshkurtër por me përfitim afatgjatë. Pavarësisht premtimeve se reformat neoliberale do të sjellin përfitim për shumicën e qytetarëve si tendencë reformat neoliberale sjellin pabarazi sociale. Për këtë arsye rezistenca politike ndaj

reformave neolibeale është dhe më e fortë. Shpesh herë jepet si shembull se aplikimi i parë i ideve neoliberales ndodhi në Kili në vitin 1973 në një periudhë kur në pushtet ishte Augusto Pinochet. *“Neoliberal si Friedman janë të trajnuar me një kuptim pervers të demokracisë pasi nuk kishin asnjë problem të ndihmonin një pushtet ushtarak si të Pinochetit”*. Por pavarësisht kësaj Kili sot shihet si një vend model për Amerikën latine pasi ka një ndër nivelet më të larta të Zhvillimit Njerëzor sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara duke u cilësuar shpesh herë si mrekullia Kiliane. Por kjo marrëdhënie e ideve neoliberales në ekonomi me një shtet diktatorial nuk janë përsëritur më dhe reformat neoliberales janë ndërmarrë më pas vetëm në shtete demokratike ose në proces demokratizimi si në Europën Lindore. (McChesney, 1999)

2.4.5. Mënyra e shpërndarjes në Europën Lindore

John Williamson (1993: f. 13-34) formuloi atë që ai e përshkroi si *“ një program të konvergencës universale ”* që përbëhej nga një besim i përbashkët i të gjithë ekonomistëve seriozë duke ofruar një listë me dhjetë pika ku përfshihej disiplina fiskale, heqja e subvencioneve në ekonomi dhe orientimi i shpenzimeve në shëndetësi, edukim dhe infrastrukturë, ulje të taksave, liberalizim financiar, kurs këmbimi të lirë, liberalizim të tregtisë me jashtë, hapje ndaj investimeve të huaja

direkt, privatizim, de-rregullim dhe sigurimi i pronës private. Këto reforma quheshin Konsensusi i Uashingtonit pasi Kongresi Amerikan, teknokratët në Uashington, institucione ndërkombëtare financiare, agjenci të shtetit Ameriakn, Rezerva Federale, *think tank-e* të ndryshëm ishin në dakortësi se politika të kujdesshme makroekonomike dhe kapitalizëm i tregut të lirë duhej të implementohej mbi pjesën tjetër të botës. Kjo ide universale e politikave shihet dhe në përkufizimin që bën Gray pak më sipër se *“liberalët vlerësojnë unitetin moral të qenieve njerëzore duke i dhënë rëndësi të dorës së dytë formave kulturore apo asocimeve historike”*.

Me rënien e Murit të Berlinit programet e stabilizimit u aplikuan për herë të parë nga ekonomisti i Harvardit Jeffrey Sachs, pas efekteve në Bolivi në 1985, dhe u rishikua dhe u shpërnda nga ekipi i tij në Poloni dhe Rusi. Kjo “terapi e shokut” kërkonte transformimin e një shoqërie të centralizuar drejt një ekonomie tregu. Idetë pro tregut nuk ishin në qarkullim vetëm në botwn akademi dhe në median e shkruar, por ato u bënë instrumente politikash për shumë institucione financiare ndërkombëtare. Gjatë viteve 1990 FMN, Banka Botërore dhe *BERZH* vendosën që kredia mundej të merrej në rast se shtetet që do tw merrnin kredi do të apliknin paketën e reformave neoliberales në ekonomi. Këto politika vinin si pasojë e besimit të madh që kishin këto institucione mbi fuqinë dhe efikasitetin e

tregut dhe kërkonin të zvogëlonin deri në minimum rolin e shtetit” (*Stiglitz, 2008, f.41*).

Në Europën Lindore rënia e sistemit komunist la një vakum ideologjik që bëri tërheqës superioritetin e tregjeve dhe demokracive liberale që vinin nga Perëndimi. Në këtë kohë shumë lider sindikatash dhe parti politike socialiste dërguan delegacione për të bindur liderët e rinj që reformat që do të ndërmernin të kishin në plan demokracitë sociale. Por elita e re ishte më e bindur mbi tregjet e lira. Sipas Blyth (2002) aplikimi i ideve të Kejnstit dhe më pas ato neoliberales nuk vijnë si pasojë e një interpretimi më “të vërtetë” të realitetit, por më tepër një akses më i madh në media dhe në elitën politike të këtyre ideve. Shumë prej mbështetësve të neoliberalizmit në fillim të viteve 1990 ishin konvertuar së fundmi dhe me shumë pak trajnim në ekonomiksin e tregjeve të lira (Mark Blyth, 2002). Për shembull Yegor Gaidar dhe Vaclav Klaus, të dy të trajnuar si ekonomistë në një sistem socialist por që ndërmorën reformat ekonomike në Rusi dhe Çeki u bënë mbështetës të hapur të ideve neoliberales vetëm në fund të viteve 1990. Në Letoni idetë neoliberales u promovuan nga një grup ekonomistësh të rinj të rikthyer të njohur si “banda Georgetown” etj.

Sipas Ruthland pavarësisht kësaj shumë prej reformatoreve të Europës Lindore po ndërmernin reformat pa një hartë të qartë. Ata duhet të huazonin ide dhe eksperiencë të shteteve të tjera që mund t’i vinte në ndihmë atyre. Shumë prej

kritikëve në fakt lidhin reformat e tregut me idetë ekonomike libertariane të Friedrich Hayek të njohur si shkolla Austriake e Ekonomisë. Por në të vërtetë një interpretim Hayek-nian i mënyrës së implementimit të reformave në Europën Lindore nëpërmjet Konsensusit të Uashingtonit nuk është aspak një qëndrim që do mbështetej prej tij. Hayek besonte se rendi shoqëror duhet të vij spontanisht nga individë që kërkojnë të arrijnë interesat e tyre dhe jo si rezultat i ndonjë arkitekturë të rendit global. Ndaj kjo çon në diskutimin nëse kjo gjë vinte si imponim apo përvetësim i ideve neolibearale në Europën Lindore.

Politologë të shumtë, ekonomistë apo dhe sociolog janë munduar të analizojnë arsyet e shpërndarjes së liberalizmit ekonomik dhe politik në shumë shtete të botës gjatë dekadave të fundit. Shumë ekonomistë besojnë se përfitimet nga liberalizmi i politikave ekonomike për vendet në zhvillim renditen në miliarda dollarë. Por gjithashtu nënvizojnë destabilitetin dhe pasigurinë njerëzore si pasojë e liberalizmit. Pyetja që shtrohet është se cilat janë arsyet që shumica e botës ka përqafuar tregun dhe demokracinë? Supozimi kryesor është se politikat kombëtare në ekonomi nuk mundet të zgjidhen të veçuara nga disa shtete dhe shpesh ato janë kundërpërgjigje e asaj se çfarë bëjnë vendet e tjera. Sipas Simmons et al mekanizmat e shpërndarjes së këtyre ideve janë katër: detyrimi (coercion), konkurrenca, mësimi dhe imitimi, ide të cilat elaborohen qartazi në *The International Diffusion of Liberalism* (Simmons, Dobbin, & Garrett., 2006)

i. Detyrimi:

Ky është një interpretim antilberal i dhënë shpesh për arsyen përse idetë liberale janë shpërndarë kaq shumë në botë. Shtete të pasura dhe të fuqishme mundet të influençojnë vendet e varfëra dhe të vogla në mënyre direkt dhe indirekte. Ky lloj mekanizmi pra shfrytëzon fuqinë asimetrike që vendet e pasura imponojnë mbi ato të vogla dhe në zhvillim. Sipas kësaj ideje vendet e pasura kanë arsye dhe qëllim të qartë se përse duan të ndryshojnë politikat në vendet e pasura dhe në rast se këto shtete nuk do të kishin fuqinë e tyre imponuese atëherë ato do të zgjidhnin të rezistonin. Sipas kësaj teorie shtetet e fuqishme mund të përdorin fuqinë që lind në marrëdhënie bilaterale ose nga entitete kolektive që funksionojnë si agjentë apo si aletatë. Gjithashtu sipas këtij interpretimi aktorë privat mundet gjithashtu të luajnë rol të rëndësishëm. Si për shembull banka private apo dhe kushtet e vendosura nga FMN.

Një arsye tjetër që paraqitet nga studiuesit është dhe kushtëzimi i “lehtë”. Politikat e shteteve të fuqishme shpesh herë konsistojnë në koordinim politikash me ekuilibre të ndryshme. Shtetet dominuese adoptojnë politika, si për shembull Nënshkrimi i Bazelit për të kontrolluar tregjet e kapitalit dhe rregullat e saj, që vendosin një ekuilibër ku dhe shtete e varfëra janë të detyruara që të marrin pjesë.

Kërkesa me forcë për të implementuar politika të tilla ka pak gjasa të jenë të suksesshme, ndërsa politika “*do it alone*” bëji vetë, nga ana e shteteve të mëdha

çojnë në një ekuilibër të tillë sa shtetet e vogla nuk kanë mundësi të tjera veçse ti bashkohen këtyre politikave.

Për të analizuar se nëse forca përdoret për të implementuar politika liberale duhen analizuar aktorët të cilët i implementojnë këto politika në rendin global. Në rast se FMN është burimi i fuqishëm i ideve neoliberales si një agjent de facto që ofron dhe financim për shtetet në zhvillim, atëherë mundet të vihet re edhe empirikisht se ato shtete që kanë qenë të varura nga financimi i FMN-së kanë përfunduar me politika neoliberales.

ii. Konkurrenca

Konkurrenca është një mekanizëm më i decentralizuar për të shpërndarë politikat se sa detyrimi. Teoricienë të shpërndarjes së ideve liberale nëpërmjet konkurrencës theksojnë faktin se shtetet nuk janë njësoj tërheqëse për investitorët dhe tregjet ndërkombëtare. Sipas kësaj teorie drejtuesit e këtyre shteteve janë në konkurrencë konstante me shtete të tjera për të tërhequr sa më shumë investitorë dhe për të rritur sa më shumë eksportet e tyre. Duke lehtësuar politikat rregulluese, duke përmisuar klimën për investime ndërkombëtare dhe duke ulur barrën fiskale shihen si politika të suksesshme që mund të ta bëjnë ekonominë më tërheqëse eksportet më konkurruese dhe ekonominë më vitale. Por kjo teori propozohet si nga ata teoricienë që thonë se kjo i bën shtetet me politika më efikase dhe konkurruese në nivel ndërkombëtar ashtu dhe nga ata që e shohin këtë

si një *“garë drejt fundit”* pasi shtetet ulin taksat, ulin shpenzimet sociale, heqin rregullat mjedisore dhe rregullat e tregut të punës për të tërhequr këta investitorë.

Në këtë interpretim në rast se teoria e detyrimit thoshte se imponimi i politikave liberale vinte si efekt i marrëdhënies vertikale, kjo teori shpjegon se konkurrenca mes shteteve të ngjashme sjell dhe shpërndarjes e këtyre ideve në mënyrë horizontale.

iii. Të mësuarit

Kjo teori i referohet ndryshimit të besimit ose të konfidencës për njohuritë aktuale pasi ekspozohesh në të dhëna të reja apo dhe teori të reja. Në fushën e zgjedhjes së politikave publike aktorë të ndryshëm duhet të bëjnë zgjedhjet në nivelin e thjeshtë taktik se si të arrish më mirë një objektiv të caktuar sikundër dhe në një nivel më të thellë se cilat objektiva duhen ndjekur. Sipas kësaj teorie zgjedhjet e bëra nga shtetet e tjera nuk ndikojnë në mirëqenien tende direkte, siç pretendonin dy teoritë e lartpërmendura, përkundrazi kjo teori thotë se vendimet e shteteve të tjera ofrojnë për shtetin tënd ide të reja dhe të dhëna të reja.

Kërkime të fundit për mënyrën sesi shtetet në zhvillim formulojnë dhe implementojnë politika si reforma në pensione apo regjimi i kursit të këmbimit deri të programet e privatizimit tregojnë rëndësinë e të mësuarit nga shtetet fqinje. Është e dokumentuar në literaturën ndërkombëtare se procesi i negociatave dhe

mbajtja e marrëdhënieve institucionale janë një mënyrë për të krijuar mundësi për të mësuar dhe bindur.

iv. Imitim (Garë)

Sociologët kanë studiuar shpërndarjen e politikave nëpërmjet lenteve të “konstruktivizmit social”. Konstruktivizimi social u bë një paradigmë e teorisë ndërkombëtare në fund të viteve 1990. Mbështetësit e kësaj teorie thonë se për të kuptuar sesi shpërndahen idetë është e rëndësishme të kuptojmë sesi ato bëhen të pranueshme nga ana e shoqërisë. Një mënyrë është marrja e vendeve të mëdha si një shembull për të nisur reformat por kjo e bën të vështirë të kuptohet sa është imitim dhe sa është imponim. Një mënyrë tjetër është artikulimi në publik i ideve apo reformave nga grupe të ndryshme interesi të cilat mendohen nga shoqëria si grupe të pavarura dhe objektive. Siç mundet të jenë idetë e artikuluar nga organizatat jo qeveritare apo ekspertë të huaj dhe që më pas përqafohen nga shteti. Gjithashtu shembuj jepen në literaturë përsa i përket trajnimit në ide liberale që morën ekonomistë të ndryshëm të Amerikës Latine në Universitetet Amerikane. Të tjerë do të shtonin se reformat ndërmerren vetëm kur ato mundet të jenë të implementueshme nga vendet e varfra, por implementimi i disa prej politikave ndërkombëtare ndërmerren për arsye simbolike, sidomos në politika sociale apo të ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës).

2.4.6. Kritikët e Majtë

Shumë autorë perëndimorë shkruajnë se neoliberalizimi është ideologjia e cila po udhëheq botën sot. Por shpesh herë neoliberalizimi përdoret me përçmim dhe në keqardhje e shohin si avancimi i kapitalizmit dhe konsumerizimit në dëm të shtetit social Chomsky (1999) dhe Harvey (2005). Sipas akademikut të majtë David Hurley (2005, f.6-7) neoliberalizmi është mbi të gjitha:

“një teori e praktikave të politikave ekonomike e cila propozon se mirëqenia e njerëzve mund të arrihet vetëm nëse ne lejojmë liritë dhe aftësitë sipërmarrësve të individëve brenda një kornize institucionale e karakterizuar nga ligje të forta të pronës së lirë, tregjeve të lira dhe tregtisë së lirë. Roli i shtetit është të lejojë dhe të ruajë këto korniza institucionale të nevojshme për të arritur qëllimet e lartpërmendura. Në ato raste kur tregu nuk ekziston në sektorë të tillë si tokë, ujë, edukim, shëndetësi, sigurime shoqërore) atëherë ato duhen krijuar dhe me ndërhyrjen e shtetit nëse është e nevojshme. Përtej këtyre objektivave shteti nuk duhet të kalojë. Ndërhyrja e shtetit në ekonomi duhet të jetë në minimum dhe për arsyen se shteti nuk mundet të ketë informacionin e plotë për të marrë një vendim të drejtë dhe së dyti sepse grupe të forta interesi do të ndikonin në vendimmarrjen shtetërore në benefit të tyre, sidomos në demokraci”.

Sipas Hurley neoliberalistët tashmë kanë pozicione të mira në institucionet globale si FMN, Bankë Botërore, OBT, Think Tanks, universitete, Ministri Financash dhe për këtë arsye ai mendon se neoliberalizmi është tashmë një diskurs i gjithëpushtetshëm duke patur efekte të thella duke u bërë gati *common-sense* në mënyrën se si ne mendojmë, jetojmë apo kuptojmë botën në të cilën


jetojmë. Përkufizimi që vjen prej Harvey është një përkufizim i shtjellimit të mëtejshëm që ai i bën idesë neoliberale që sipas tij ka filluar të ketë efekt në politikat ekonomike që në vitet 1970-të. Sipas tij neoliberalizimi nuk është një rikthim në idetë liberale, por një teori e re dalluese e pavarur nga idetë liberale. Sipas tij Neoliberalizmi është “*teori e praktikave të politikave ekonomike*” dhe jo një ideologji politike e plotë. Sipas analizës së tij nuk ka një lidhje të drejtpërdrejt mes praktikave ekonomike neoliberale dhe një dedikimi në liberalizëm.

Sipas tij është e vështirë që të përkufizosh ose të tregosh karakteristikat e përbashkëta të shteteve neoliberale pasi divergjencat sistematike të teorive neoliberale janë lehtësisht të dukshme dhe së dyti dinamika e evoluimit të neoliberalizmit do të thotë që ajo ka marrë trajta të ndryshme në varësi të vendit por dhe të kohës kur ajo është implelementuar (*Harvey, 2005, f. 71*).

Shtetet neoliberale duhet të riformohen nga brenda në mënyrë konstante dhe të ndërtojnë institucione të reja për të përmisuar konkurrueshmërinë e tyre. Harvey (2005, f. 64) thotë se neoliberalët janë ithtarw të privatizimeve. Mungesa e të drejtave të pronësisë për shumicën e qytetarëve në vendet në zhvillim e bën të rëndësishme që për të luftuar tragjedinw e të përbashkëtës (*tragedy of the commons*), ku qytetarët e mbi shfrytëzojnë të mirën publike si uji dhe toka. Duke ia lënë këtë përgjegjësi konkurrencës mes qytetarëve, firmave dhe entiteteve rajonale si komuna apo bashki arrihet që të eliminohet i gjithë procesi burokratik

duke rritur efikasitetin dhe performancën me çmime më të ulta për qytetarët dhe me më pak shpenzime nga ana e qeverisë për administrimin e tyre.

David Kotz (2001) gjithashtu kritikon se për më shumë se 30 vjet kapitalizmi neoliberal ka prishur kushte e jetesës për shumicën në SHBA dhe rreth e qark botës. Tani kriza e fortë ekonomike dhe financiare po tregon pikat më të dobëta të kapitalizmit pasi motivimi i fitimit nuk mundet t'i shërbejë njerëzve për standarde jetese të mira si në shërbimet publike dhe private, siguri ekonomie dhe një ekonomi që të jetë i padëmshëm për mjedisin. Argumentet për një alternativë socialiste janë më të forta për miliona njerëz që kanë humbur kursimet e jetës, me papunësi të lartë etj. Një lëvizje socialiste do të rilind në të ardhmen duke hapur mundësinë për ti dhënë fund erës së kapitalizmit.



Grafik 7: Rritja Mesatare PPB për frymë në vendet OECD. Burimi: Kotz

Sipas autorit Kotz të dhënat e tabelës flasin qartë se një kapitalizëm i rregulluar siç ishte në vitet 1950-73 dhe me ndërhyrje nga shteti nën idetë Kejnsianiste tregojnë qartë se PBB për frymë ka patur një rritje më të lartë sesa një treg i cili i nënshtrohet ideve neoliberale. Këta të fundit thonë se implementimi i këtyre ideve në SHBA dhe MB mundësuan rritje ekonomike mesatare të përafërt me periudhën 1950-73. Por sic dhe do të shohim më pas në punim arsyet e rritjes ekonomike më të shpejtë të këtyre vendeve pas luftës së dytë botërore kanë të bëjnë kryesisht me procesin e kthimit të lart të kapitalit në kushtet e shkatërrimit të saj pas luftës së dytë botërore.

Neoliberalizmi është problematik si një teori dominuese e kapitalizmit bashkëhor. Stabiliteti dhe mbijetesa e sistemit kapitalist varet nga aftësia e tij për të akumuluar sasi të mëdha kapitali, si një ekspansion ekonomik ashtu dhe një progres teknologjik. Shqetësimet nga modeli i rritjes së kapitalit sjell problemin e pamjaftueshmërisë së kërkesës agregate në periudhën afatgjatë pasi regjimi neoliberal kërkon gjithnjë e më shumë ulje të pagës reale të punëtorëve dhe ulje të shpenzimeve publike.

Gjithashtu modeli neoliberal sjell mungesë të stabilitetit makroekonomik pasi hiqet dorë nga politikat kundërciklike të qeverisë duke ulur programet sociale dhe pakësimin e rregullatorëve publik të sektorit financiar duke e bërë sistemin më vulnerabël ndaj krizave të mëdha financiare. Së treti sistemi neoliberal

intensifikon konfliktet klasore që potencialisht mundet të dëmtojnë investimet kapitale. Kotz vazhdon të argumentojë se globalizimi është një faktor kryesor që ka transformuar bizneset e mëdha nga mbështetës të një shteti ndërhyrës në të kundërtën, pasi ky proces ka rritur konkurrueshmërinë në nivel botëror duke i bërë ato të kërkojnë vende me taksa të ulëta, të bëjnë presion për të ulur barrierat hyrëse në shtete të ndryshme.

2.5. Ndërmjetësuesit Financiar

Siç pamë dhe më sipër reformat financiare ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike në Europën Lindore dhe kjo është domethënëse në të tre modelet e regresionit të përdorur. Ndërkohë që këto reforma në vetvete shërbejnë për të promovuar shkëmbimin më të shpejtë të kapitalit dhe të vendimmarrjes së bizneseve. Përveç kësaj neoliberalizmi shpesh herë nga kritikët e saj është parë si sinonim i sektorit financiar ndaj është me rëndësi për të parë sesi këto “institucione neoliberale” janë përkthyer në ekonominë Shqiptare. Në këtë kapitull do të interpretojmë literaturën përse i përket rëndësisë së liberalizimit financiar dhe më pas do të shohim nëse rritja e kreditimit në Shqipëri është e ngjashme me shtetet e tjera të Europës Lindore. Nga ana tjetër me interes është të shihet sesi Shqipëria u prek nga kriza financiare globale dhe masat që ndërmori shteti Shqiptar gjatë kësaj periudhe. Ky kapitull gjithashtu teston rolin e kursit të këmbimit në stabilitetin makroekonomik të vendit dhe sheh nëse autoritetet

vendase kanë një agjendë të fshehur me kursin e këmbimit ndryshe nga kursi zyrtar i këmbimit.

2.6. Krizat dhe Neoliberalizmi

Efekti shkatërrues i krizës së fundit shkruan profesori Birch në librin e tij, *Ngritja dhe Rënia e Neoliberalizmit. Rënia e një Regjimi Ekonomik*, ekspozoi dhe pikat e saj të dobëta duke hapur për herë të parë në dekada një debat mbi vizionin dhe alternativat e një rendi ekonomik që nuk qeverisen nga etika e tregut të lirë. Ky debat nënkupton se kontradiktat në zemër të neoliberalizmit se shteti është esencial në garantimin e tregut na ofron një mundësi të re për të diskutuar se si duam që të ndërtojmë dhe organizojmë shoqërinë dhe ekonominë tonë (Birch, 2010).

Sipas tij duke qenë se efektet e krizës së fundit nuk kanë qenë të njëjta në mbarë botën do të thotë se neoliberalizmi nuk ka qenë ndonjëherë ndonjë sistem *hegjemik*. Kjo sfidë sipas tij ofron dhe një mundësi për të diskutuar se çfarë është neoliberalizmi dhe sesi ky rend u vendos në shumë ekonomi të botës dhe sidomos në Europën lindore. Sipas David Harley (2006) neoliberalizmi ka dështuar ti afrohet, dhe jo më të arrijë, nivelet e rritjes ekonomike të periudhës së artë Kejnsianiste në vitet 1960, duke vendosur në pikëpyetje pikërisht ekzistencën, *raison d'être*, të saj – për te garantuar pasuri për të tërë nëpërmjet

efikasitetit të tregut. Në këtë libër profesori Birch vazhdon të shkruajë se për të kuptuar arsyet e krizës ekonomike të tashme ne duhet të kuptojmë themelet mbi të cilat neoliberalizmi u ndërtua, sidomos në shpërndarjen e financave dhe kapitalizmit.

Kryeministri Britanik Gordon Broun u shpreh në Konferencën Vjetore të Partisë Laburiste në 2009 se “Ajo që çoi botën drejt falimentimit ishin jo vetëm institucione të falimentuara por ideologji të falimentuara. Ajo që dështoi është ideja se tregjet vetregullohen por asnjëherë se ato mundet të vetshkatërrohen⁴. Ky fjalim i kryeministrit Broun në kulmin e krizës financiare u pasua me shumë libra e studime që vendosnin në pikëpyetje efikasitetin e ideve neoliberale. Ndër to ishte libri “Kriza e Neoliberalizmit” i shkruar nga dy ekonomistë Francez Gerard Dumenil dhe Dominique Levy ku thuhet se “neoliberalizmi nuk është gjë tjetër vecëse një fazë e re e kapitalizmit që rezultoi si pasojë e krizës ekonomike të viteve 1970-të. Sipas tyre, neoliberalizmi shpjegon strategjinë e klasës kapitaliste në aleancë me menaxherë korporatash, sidomos në tregun financiar, për të rritur fuqinë e tyre dhe për t’u fuqizuar globalisht. Dhe ata ishin të suksesshëm në objektivat e saj për të rritur të ardhurat për një klasë të privilegjuar dhe për të dominuar shtete të vogla” (Levy, 2011, faqe.9). Kriza e vitit 2008 është pasojë e kontradiktave në vetë strategjinë neoliberale. Gjithsesi duke qenë se dhe kriza e

⁴ (Brown, 2009)

vitit 2008 ishte një krizë financiare i gjithë libri në fakt bazohet në arsyet përse kriza financiare është një krizë e kapitalizmit dhe neoliberalizmit dhe rendi i ri global nuk do të lejojë më që pushteti i padiskutueshëm i dollarit në financat botërore të vazhdojë. Kjo do të kërkojë negociata të reja dhe të gjata.


Shembujt për dështimet e ideve neoliberale vijnë kryesisht nga kriza financiare e vitit 2008 ku vendet e Baltikut u tronditën fort në monedhat vendase dhe në sistemin bankar.

Tabela 2: Rritja Ekonomike në Europën Lindore

Shteti	Rritja e PBB reale 2009	Deficiti shtetëror si përqindje e PBB-së	Papunësia
Mesatare BE-27	-4.2	-3.9	8.9
Ekonomi Post-Komuniste			
Bullgaria	-5	-3.9	9.7
Republika Çeke	-4.1	-5.9	7.4
Estonia	-14.1	-1.7	19
Letonia	-18	-9	20
Lituania	-14.8	-8.9	17.3
Hungaria	-6.3	-4	10.4
Sllovakia	-4.7	-6.8	15
Sllovenia	-7.8	-5.5	7
Polonia	1.7	-7.1	9.6
Rumania	-7.1	-8.3	7.4

Sipas shumë komentuesëve burimi i rënies kaq të madhe të ekonomive të këtyre shteteve lidhet ngushtësisht me dështimin që pati implementimi pa kushte i ideve neoliberale, sidomos përsa i përket ekspozimit në financa ndërkombëtare. Në

librin e tyre *Kriza e Neoliberalizmit* Iván Széleányi shkruan se kriza e vitit 2008 hedh pikëpyetje të forta me përfitimet që i vijnë ekonomive nga adoptimi i ideve neoliberale dhe megjithëse kriza filloi në SHBA pasojat po ndjehen dyfish në vendet ish komuniste. Sipas të dhënave përfitimet e para krizës ishin të shtyra kryesisht nga financimi i lirë nga bankat ndërkombëtare. Për shembull në vitet 2005-2007 shtete Baltike patën rritjen më të lartë nga vendet e BE-së. Letonia u rrit me 10.7% në vit e Estonia e Lituania me 8.8%. Megjithëse Banka Botërore i përcaktonte këto shtete si vendet më tërheqëse për investim, në fakt ato përfituan nga spekulatorët ndërkombëtarë në pasuri të patundshme, ku Banka Skandinave apo Amerikane ofronin kredi shumë të lirë në monedhë të huaj si Franga, Euro apo Dollar Amerikan.



Grafik 8: Indeksi i PBB-se per Ukrainen, Moldavine dhe Gjeorgjine ne 2007 krahasuar me 1991.

Komentet mbi efektet negative të ekonomive post komuniste janë të rëndësishme pasi ato pretendojnë se privatizimet në ekonomi sollën përfitime vetëm për një grusht njerëzish dhe rritja ekonomike e matur me PBB nuk tregon në të vërtetë zhgënjimin e madh që ka ardhur nga procesi i tranzicionit. Në këtë kuptim vihet re që si parti politike të “majta” dhe ato të “djathta” në tërësi kanë ndjekur të njëjtat receta në menaxhimin e ekonomisë me privatizime dhe reforma në dobi të ekonomisë së tregut. Por në këtë proces vihet re që besimi në partitë politike është shumë i ulët duke vendosur më pas në pikëpyetje dhe legjitimitetin e reformave në ekonomi, sidomos kur vihet re që ka dhe nivel të lartë të korrupsionit. Diskutimi mbi efektet e neoliberalizmit në ekonomitë e Europës Lindore bëhet dhe më i komplikuar kur krahasohet me Kinën e cila nuk vuajti nga recensionin e viteve 1990, por përkundrazi pati ritme të larta të rritjes ekonomike.

Ndaj në rast se reformat neoliberale shihen vetëm në frymëzimin e tyre për reforma institucionale të shpejta nën terapinë e shokut, atëherë deabti mbi përfitimet e neoliberalizmit komplikohen kur sheh recensionin e madh që përjetuan vendet e Europës Lindore. Por siç pamë më sipër teoria e rritjes ekonomike nuk është aq e lehtë dhe konsensuale në vetvete. Ashtu siç thuhet dhe nga revista prestigjioze The Economist asnjëherë nuk ishte shkruar një libër më parë 1990 se si mundet të kemi një tranzicion nga një shtet komunist në një shtet kapitalist, duke theksuar pasigurinë e mëdha që kishin politikbërësit përëndimor


dhe lindor në politikat e tyre në ekonomi. Siç do të shohim dhe më vonë, me kalimin e kohës mbështetja popullore për reforma zvogëlohet dhe për këtë arsye reformat e bëra në fillim të viteve 1990 nuk ishin shpesh nën terapinë e shokut pavarësisht impaktit social të saj.

Tabela 3: Indeksi Lirisë dhe të Ardhurat


			Rumani	65.1	9499
			Poloni	66	13647
	Indeksi Lirisë	PBB/Frym e	Letoni	66.5	15375
Ukraina	46.3	3900	Hungari	67.3	13480
Rusia	51.1	14611	Maqedoni	68.2	4838
Moldavia	55.5	2239	Sllovaki	68.7	18064
Bosnja	57.3	4661	Armeni	69.4	3504
Serbia	58.6	6353	Ceki	70.9	19844
Kroaci	61.3	13607	Lituani	72.1	15537
Slloveni	61.7	23289	Gjeorgji	72.2	3605
Mal i Zi	62.6	7106	Estoni	75.3	18788
Bullgari	65	7498			

Ky grafik na bën të kuptojmë se marrëdhënia mes lirisë ekonomike dhe mirëqenies ekonomike janë të lidhura me njëra tjetrën. Këto të dhëna janë matur nga institute Fraser i cili mat se sa mbështetëse janë institucionet shtetërore ndaj lirisë së tregut. Në këtë kuptim ata matin se sa e lirë është zgjedhja personale, shkëmbimi vullnetar i produkteve, liria për të konkurruar, dhe siguria e pronës private duke bërë bashkë 42 indikator që mundet të krahasohen me njëra tjetrën mes shteteve. Që nga publikimi për herë të parë në vitin 1996 të dhënat e këtij

instituti janë përdorur më pas për të matur marrëdhënien e lirisë së tregut në rritje ekonomike apo në uljen e varfërisë në botë.



Grafik 9: Indeksi i Lirisë dhe PBB për Frymë



Grafik 10: Rritja Ekonomike Mesatare mes shteteve 1991-2011

Në kapitujt në vazhdim do të diskutohet mbi teorinë e rritjes ekonomike dhe sesi ajo ndikon në ulje të varfërisë, së dyti do të shihet sesi reformat neoliberales, të matura nga indikatorët e *BERZH*, kanë ndikuar në rritjen ekonomike. Duke qënë se kriza e vitit 2008 ishte një krizë financiare, ky studim do të shqyrtojë dhe të dhënat përsa i përket sistemit financiar në Shqipëri dhe impaktit të euroizimit në vendet e Europës Lindore. Duke qënë se kriza financiare e vitit 2008 zbehu rolin e reformave neoliberales, në këtë studim është e rëndësishme që të analizohet dhe ndryshimi në mbështetje për reformat në popullsi. Kjo do të matet me të dhënat e *BERZH* për gjithë vendet e Europës Lindore në vitin 2006 dhe 2010.

KAPITULLI 3: PËRDORIMI I TË DHËNAVE DHE METODOLOGJIA

3.1. Hyrje

Sic pamë në kapitullin e shkuar neoliberalizmi ka disa lloje përkufizimesh dhe përdorimesh në literaturë. Por në këtë punim do të përdoret më gjerësisht për të nënkuptuar: politika reformatore në ekonomi që liberalizojnë ekonominë, eliminojnë kontrollin e çmimeve, de-rregullojnë tregjet e financiare dhe ulin barrierat tregtare; duke ulur rolin e shtetit në ekonomi, sidomos nëpërmjet privatizimit të aseteve shtetërore, duke ofruar shkurtim të shpenzimeve publike dhe stabilizim makroekonomik, duke përfshirë kontroll të fortë të ofertës monetare, eliminimin e deficitit buxhetor dhe uljen e subvencioneve shtetërore.

Në këtë kapitull shpjegohen llojet e të dhënave të marra kryesisht nga Banka Botërore si dhe *BERZH*. E para ofron të dhëna vjetore për tërë vendet lindore përse i përket PBB/ Frymë, inflacion, investime etj. Ndërkohë që *BERZH* ofron të dhëna përse i përket reformave institucionale si dhe një bazë të gjere të dhënash përse i përket mbështetjes publike nëpërmjet 27.000 pyetësorëve të mbledhura në vitin 2006 dhe 2010. Për këtë arsye në këtë kapitull do të tregojmë përse përdorim regresionet Panel Data për të analizuar efektet e reformave institucionale mbi rritjen ekonomike dhe nga ana tjetër regresion logjistik rendor për të parë sesi

ndryshon probabiliteti në nivel individual për të mbështetur ose jo ndërhyrjen e shtetit në ekonomi

3.2. Të Dhënat

Është e rëndësishme për të dhënë një informacion më të plotë se çfarë nënkuptohet me përbërësit e reformave institucionale. Lista standarde që përdoret nga shumë prej studimeve të Europës Lindore janë indikatorët e Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (*BERZH*). Kjo Bankë e cila u themelua që në vitin 1991, 18 muaj pasi Presidenti Frances François Mitterrand e hodhi si ide, ka patur si synim kryesor për të siguruar një Europë Lindore të re pas luftës së ftohtë me ekonomi tregu. Sipas vetë Bankës roli i saj ka qënë historik dhe ka një eksperiencë unike për të çuar në ndryshim në rajon dhe më tej. *BERZH* që në fillimet e saj ka patur si objektiv kryesor punën për të garantuar ekonomi të orientuara drejt tregut dhe në promovimin e iniciativave dhe sipërmarrjes private.

Kjo bankë ka qënë e përfshirë në fusha të tilla si reforma e sistemit bankar, liberalizimin e çmimeve, privatizimet, duke përfshirë si legjislacionin përkatës dhe debatin politik si dhe krijimin e infrastrukturës ligjore për të siguruar të drejtat e pronësisë. *BERZH*, sic dhe përmendet në shumë artikuj në mënyrën e shpërndarjes së ideve Neoliberales në Europën Lindore, ka qënë aktive në këshillim, trajnime dhe ekspertizë teknike e shoqëruar kjo me investime të mëdha,

por gjithashtu me ofrimin e kapitalit të nevojshëm për zhvillimin e tregut financiar në këtë rajon (*Bockmanm & Eyal, 2002*).

BERZH ka eksperiencë në këtë rajon që në fillimet e reformave të para institucionale. Objektivi i saj parësor ka qenë asistimi i këtyre vendeve për të krijuar ekonomi tregu dhe duke ofruar të dhëna të rëndësishme për tetë tregues të publikuara në mënyrë periodike në *Raportet e Tranzicionit*. Të dhënat e përdorura nga *BERZH* bazohen në burime kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në metodologjinë e tyre në matjen e reformave institucionale të cilat më pas vlerësohen me një shkallë pikësh nga 1 pikë, që do të thotë shumë pak reforma, deri në 4+ që nënkuptohen se këto shtete kanë ndërtuar institucione të ngjashme me vendet e industrializuara.

Balcerowicz bën dallimin dhe paraqet tre komponentë kryesor të reformave që karakterizuan procesin e tranzicionit në Europën Lindore:

1. *Liberalizimi* (Shkalla e parë e reformave institucionale)
 - *Liberalizim në nivelin mikroekonomik të çmimeve* (eliminimi i kontrollit të çmimeve)
 - *Heqja e çdo lloj barrierave sasiore në tregtinë e jashtëm dhe lehtësinë e konvertimit të kursit të këmbimit.*
 - *Heqja e barrierave të brendshme për të lejuar sipërmarrjen e lirë.*

2. *Reformat Institucionale të Fazës së Dytë* (ndryshime të institucioneve ekzistuese, privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore, riorganizimi i administratës shtetërore, reforma në sistemin e taksave dhe atë financiar)

3. *Politika të stabilizimit Makroekonomik.*

Liberalizimi si dhe politikat stabilizuese mundet të ofrohen menjëherë. Liberalizimi është i barabartë me heqjen e barrierave ekzistuese. Kjo është shumë e thjeshtë nga ana teknike por kuptohet jo dhe aq nga ana e politikave ekonomike pasi disa interesa specifike do të dëmtohen dhe kundërshtimi do të jetë më i madh për këto politika. Ndërkohë ato që janë quajtur politika të fazës së dytë aplikohen kur duhet të përgatitesh për infrastrukturë të re ligjore dhe organizative dhe që kuptohet do më shumë kohë që të implementohen (Balcerowicz, 2001).

Më poshtë paraqiten tetë indikatorët kryesor të përdorur nga *BERZH* për të matur reformat e ndërmarra që në fillim të tranzicionit në vendet e Europës Lindore.

1. *Liberalizimi i Brendshëm i Çmimeve:*

Fokusohet në heqjen e gjithë çmimeve të kontrolluara nga shteti dhe ndërhyrjes së shtetit me anë të subvencione në ekonomi. Objektivi kryesor i liberalizimit është mundësimi i agentëve ekonomikë për të adaptuar dhe reflektuar kostot reale në sjelljen dhe preferencat e tyre. Ekuilibrat e tregut lejojnë shpërndarjen e informacionit të plotë të produktit në shoqëri.

2. *Liberalizim i Jashtëm:* Heqja e shumë kufizimeve sasiore dhe administrative në import dhe eksporte (megjithëse produktet bujqësore bëjnë shpesh herë përjashtim), largimin e shtetit në praktikat e ndërhyrjes së drejtpërdrejt në import apo eksport të produkteve, pjesëmarrje në *OBT*, që do të thotë adoptimi i standardeve ndërkombëtare të tregtisë së jashtme.

3. *Politikat Konkurruese* – hyrje e lirë në shumë tregje, institucione rregullatorë që mbikëqyrin fuqinë në treg, dhe luftën ndaj monopoleve abuzuese.

4. *Privatizime të Mëdha*- progresi matet me përqindjen e privatizimeve të ndërmarrjeve të mëdha shtetërore në nivelet 25, 50 dhe 75 për qind, si dhe cilësia e qeverisjes së këtyre korporatave.

5. *Privatizime të Vogla* dhe lehtësia për të hyrë në treg- privatizim i menjëhershëm dhe i plotë i ndërmarrjeve të vogla shtetërore pa asnjë lloj kufizimi, lehtësia e tregtisë së truallit nga ana e pronësisë së re dhe lehtësia e hyrjes së firmave të reja në treg

6. *Reforma e Ndërmarrjeve* (Ristrukturimi dhe Qeverisja e Ndërmarrjeve)


Që tregjet të jenë efikase ato kanë nevojë për institucione mbështetëse që ti ofrojnë rregulla loje formale dhe informale të një ekonomie tregu. Institucionet çojnë në ulje të kostos së transaksionit dhe kostos së informacionit duke ulur pasiguritë dhe duke vendosur struktura stabël që lejojnë ndërveprimet. Mungesa e

institucioneve çon në probleme serioze për bizneset sidomos për vendet në tranzicion me trashëgiminë e sistemit socialist. Me rënien e sistemit të komanduar administratorët e firmave u bënë agjentët e parë të lirë të pavarur duke operuar në tregje rudimentare.

Investitorët e huaj duhet gjithashtu të adaptohen në strategjitë e tyre kur vepronin në vendet e tranzicionit duke u përballur me kosto të larta transaksioni në këto tregje por gjithashtu dhe vetë brenda këtyre kompanive. Këto kosto janë më të larta se në vendet perëndimore pasi periudha e tranzicionit krijon një infrastrukturë institucionale jo të plotë. Investitorët e huaj që supozohet të sjellin *know-how* me investimet e tyre dhe që më pas sjellin rritje ekonomike rezervohen të hyjnë në këto tregje pasi ato kanë pak informacion për partnerët e tyre lokal dhe gjithashtu operojnë në ligje rregullatorë jo të qarta dhe fikse dhe duhet të bashkëveprojë më një burokraci me pak eksperiencë në një sistem gjyqësor jo efikas dhe nivele të larta korrupsioni. (*Thornton and Mikheeva, 1996*). Për këtë arsye deri vonë mënyra kryesore e përvetësimit (*acquisition*) ishte privatizimi por që më pas kërkonte negociata komplekse me autoritetet shtetërore. Pas blerjes këto firma kërkonin më pas investime të konsiderueshme dhe ristrukturim të ndërmarrjeve dhe të strategjisë dhe kulturës

Për këtë arsye *BERZH* mat reformat në ndërmarrje nëpërmjet politika të rrepta për subvencionet dhe kreditimin, respektimi dhe aplikimi i legjislacionit për

falimentim, qeverisje efektive e korporatave nëpërmjet bankave dhe tregjeve kapitale, investitor dhe sipërmarrës aktiv, tregje mirëfunksionuese në kontrollimin e korporatave, evidencë e një ristrukturimi efikas dhe investime. Përmirësimi i performancës së kompanive duhet të jetë kyçi i çdo tranzicioni nga një ekonomi e komanduar në një ekonomi të orientuar drejt ekonomisë së tregut. Mënyra standarde e nxitjes ka qenë rritja e konkurrueshmërisë, dhe rritja e qeverisjes së korporatave duke lejuar privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe heqjen e subvencioneve shtetërore në mënyrë që firmat të përballojnë vetë humbjet dhe fitimet duke u adaptuar në kushtet e konkurrencës, praktikë që literaturë e quan shtrëngesë e fortë buxhetore (*Hard Budget Constraint*).



Grafik 11: Indeksi i reformave institucionale. Burimi: BERZH

Por eksperiencia e ristrukturimit të ndërmarrjeve është e ndryshme. Në studime të tjera (*Djankov & Murrell, 2002*) shkruhet se eksperiencia e vendeve CIS (*Commonwealth of Independent States*), e përbërë nga Rusia dhe 11 shtete të tjera ish Sovjetike, ka qenë e ndryshme nga vendet e tjera që nuk ishin anëtare të CIS. Sipas tyre reforma të tilla si privatizimi dhe shtrëngesa e fortë buxhetore kanë patur impakt më të vogël. Gjithashtu ndërkohë që argumentet për efektin pozitiv që ka privatizimi në përmasimin e qeverisjes së korporatave në vendet e zhvilluara dhe me të ardhura të mesme janë të besueshme në vendet e tranzicionit kjo është më pak e vlefshme pasi kjo lidhet me mënyrat e privatizimit dhe në ndryshimet ligjore dhe institucionale.

Duhet të bëre një dallim mes reformave në qeverisje të ndërmarrjeve në nivelin mikroekonomik: ristrukturimi i ndërmarrjeve ekzistuese dhe rialokimi i burimeve. Ristrukturim nënkupton përmirësim të performancës së firmave ekzistuese duke ndryshuar objektivat e tyre, incentivat si dhe kufizim mbi menaxherët. Megjithëse rezultatet varen nga struktura e pronësisë, infrastruktura ligjore për qeverisjen e korporatave dhe performanca e tregjeve kapitale.

Sipas *Erstein 2001* vendet që kishin qenë më parë në influencën e perandorisë Austro-Hungareze si Çekosllovakia, Hungaria, Polonia Jugore dhe Sllovenia kishin një traditë ligjore Evropiane dhe një eksperiencë të madhe në kapitalizëm

para Luftës së Dytë Botërorë. Këto shtete kishin një kod tregtar të plotë (megjithëse të vjetër) në ligjet e tyre. Ndërkohë shtetet e Ballkanit trashëguan

Tabela 5: Korrelacioni mes indikatorëve të reformave

	Privatizim i Madh	Privatizim i Vogël	Qeverisje Korporata	Liberalizim Çmimi	K. Këmbimit Treg Jashtme	Politika Konkurrencës	Reforma Bankare	Inst Jo Bankare
<i>Privatizim i Madh</i>	1							
<i>Privatizim i Vogël</i>	0.8159	1						
<i>Qeverisje Korporata</i>	0.8653	0.7885	1					
<i>Liberalizim Çmimi</i>	0.7431	0.8018	0.6816	1				
<i>K. Këmbimit Treg Jashtme</i>	0.8525	0.8616	0.8049	0.8451	1			
<i>Politika Konkurrencës</i>	0.7938	0.6963	0.8596	0.5971	0.691	1		
<i>Reforma Bankare</i>	0.8716	0.8033	0.9297	0.7111	0.8425	0.8285	1	
<i>Inst Jo Bankare</i>	0.7576	0.7041	0.8546	0.5572	0.6676	0.8682	0.8438	1

sisteme ligjore dhe institucionale të Perandorisë Otomane me një kod tregtar jo shumë të zhvilluar dhe me pak eksperiencë në ekonominë e tregut. Nga ana tjetër

eksperienca Sovjetike me kapitalizmit ishte shumë e shkurtër dhe shumë e hershme duke bërë bazën ligjore të ekonomisë së tregut akoma më të vështirë për të implementuar, respektuar dhe kuptuar. Bazuar në këtë interpretim nuk është rastësi që vendet që janë të parat në reformat e sipërmarrjes dhe qeverisjes janë pikërisht vendet që kanë qenë nën influencën e perandorisë Austro-Hungareze.

Sipas Bankës Botërore transparenca dhe qeverisja e mirë e korporatave janë themelet e një sistemi të fortë të kreditimit dhe të sektorit të korporatave (World Bank, 2011). Transparenca ekziston kur informacioni është mbledhur dhe bëhet i gatshëm në dispozicion të palëve të tjera dhe, kur kombinohet me sjelljen e mirë e "korporatave," duke krijuar një mjedis të informuar dhe komunikues të favorshëm për bashkëpunim më të madh mes të gjithë palëve. Transparenca dhe qeverisja e korporatave janë veçanërisht të rëndësishme në tregjet në tranzicion, të cilat janë më të ndjeshme ndaj luhatjeve ndaj faktorëve të jashtëm. Pa transparence vlera e kredisë nuk do të pasqyrojë rreziqet reale duke çuar në norma të larta të interesit dhe tarifa të tjera. Transparenca dhe qeverisja e fortë korporatave janë të nevojshme në transaksione të brendshme dhe ndërkufitare dhe në të gjitha fazat e investimit: në fillim të dhënies së kredisë, menaxhimin e ekspozimit kur është marrë kredi, dhe sidomos kur huamarrësi është në vështirësi financiare dhe huadhënësi është duke kërkuar për të zgjidhur marrëveshjen. Huadhënësit kërkojnë besim në investimet e tyre, dhe besimi mund të sigurohet vetëm


nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, qoftë para ose gjatë një ristrukturimi ose pasi plani i riorganizimi është zbatuar.

7. Reforma Bankare dhe liberalizimi i normave të interesit- liberalizim i plotë i normave të interesit, asnjë lehtësi në akses dhe rifinancim i lirë, ligje dhe rregulla bankare të njëjta me *Bank for International Settlements*, standarde për nivelin e kapitalit të nevojshëm që duhet patur, mbikëqyrje dhe disiplinë e tregut financiar sipas Komitetit të Bazelit, lehtësi për të aksesuar të gjitha shërbimet financiare bankare në treg, rritje e kreditimit në ekonomi, provigjone për kreditë e dhëna ndërmarrjeve private, privatizimi i bankave.

8. Tregje dhe institucione financiare jo bankare.

Skema kolektive investimesh, skema pensionesh private, kompani leasing, likuidet tregu dhe kapitalizimit të bursës, mbrojtja e aksionarëve në minorancë, tregje financiare transparente dhe efikase, risk sistemik minimal, procedura të sigurtat blerje dhe shitje aksionesh. Sipas *Miskiewicz (2010, faqe 42)* indikatorët e *BERZH* janë të korreluara ngushtë me njëra tjetrën. Më e rëndësishmja sipas përlllogaritjeve të bëra prej tij mbetet qeverisja e korporatave dhe reforma bankare korrelacioni =0.916. Sipas tij kjo nuk është surprizë pasi vetë institucionet e qeverisjes së korporatave vijnë në ndihmë të financuesve në një ekonomi dhe një rritje e kreditimit në ekonomi bëhet e vështirë

të arrihet pa të. Ndërkohë në përllogaritjet e bëra për të dhënat nga viti 1991 deri në vitin 2012 vihet re që korrelacioni midis qeverisjes së korporatave dhe reformës bankare bëhet akoma dhe më i fortë në 0.92 duke vërtetuar dhe llogaritjet e bëra nga *Miskieviz (2010)* për periudhën 1999-2002 për 27 shtete.



Grafik 12: Mesatare e të Ardhurave për Frymë

Siç vihet re dhe nga krahasimi i bërë mes llogaritjeve për periudhën 1990-2002 me të dhënat për periudhën 1990-2012 të llogaritura në këtë studim u vu re që në të gjithë indikatorët e përmirësimit institucional në Europën Lindore është bërë progres megjithëse ajo që vihet re është se ato reforma që janë më të lehta për t'u implementuar siç janë dhe liberalizimi i brendshëm i çmimeve apo liberalizimi i

Tabela 7: Të Dhënat mbi Fillimet e Privatizimeve

<i>Shteti</i>	Viti i Liberalizimit	Programi i Stabilizimit	Fillimi i recesionit	Viti i fundit i recesionit	Kohëzgjatja e recesionit	Prodhimi më i ulët
<i>Shqipëria</i>	1993	1992	1990	1992	3	0.604
<i>Bosnja</i>	1998	1997	1989	1994	6	0.12
<i>Bullgaria</i>	1994	1997	1990	1997	8	0.632
<i>Kroacia</i>	1991	1993	1989	1993	5	0.595
<i>Çekia</i>	1991	1991	1990	1992	3	0.846
<i>Estonia</i>	1993	1992	1989	1994	6	0.608
<i>Maqedonia</i>	1991	1994	1989	1995	7	0.551
<i>Hungari</i>	1992	1990	1990	1993	4	0.819
<i>Letoni</i>	1993	1992	1991	1995	5	0.51
<i>Lituani</i>	1993	1992	1990	1994	5	0.533
<i>Poloni</i>	1990	1990	1990	1991	2	0.822
<i>Rumani</i>	1994	1993	1989	1992	4	0.75
<i>Serbi</i>	2001	1993	1989	1993	5	0.4
<i>Sllovaki</i>	1991	1991	1990	1993	4	0.75
<i>Slloveni</i>	1991	1992	1989	1992	4	0.82
<i>Vendet ish Sovjetike</i>						
<i>Armenia</i>	1996	1994	1990	1993	4	0.31
<i>Azerbajxhan</i>	1998	1995	1989	1995	7	0.37
<i>Bjellorusi</i>	akoma	1994	1990	1995	6	0.627
<i>Gjeorgji</i>	1996	1994	1989	1994	6	0.254
<i>Kazakistan</i>	1995	1994	1989	1995	7	0.612
<i>Kirgistan</i>	1994	1993	1991	1995	5	0.504
<i>Moldavi</i>	1995	1993	1990	1999	10	0.317
<i>Rusi</i>	1993	1995	1990	1998	9	0.553
<i>Taxhikistan</i>	2000	1995	1989	1996	8	0.392
<i>Turkeministan</i>	akoma	1997	1989	1997	9	0.42
<i>Ukraine</i>	1996	1994	1990	1999	10	0.365
<i>Uzbekistan</i>	akoma	1994	1991	1995	5	0.834

tregtisë së jashtme janë ato që kanë patur dhe efektin më të madh. Ndërkohë reformat që duan më shumë kohë dhe që janë më të vështira për t'u implementuar siç është qeverisja e korporatave dhe institucionet jo financiare kanë mesataren më të ulët të reformave si dhe rritjen më të ulët nga periudha 2002-2012.

3.3. Metodologjia

3.3.1 Modeli 1: Rritja Ekonomike dhe Reformat Neoliberales

Në këtë seksion do të tregojmë avantazhet e përdorimit të panel data për të matur rëndësinë e faktorëve si kursime, kushtet fillestare, stabiliteti makroekonomik apo reformat institucionale në përcaktimin e rritjes ekonomike në vendet e Europës Lindore. Siç pamë në të dhënat e mësipërme niveli i të ardhurave për frymë luhateshin shumë nga shteti në shtet dhe mbështetja për reformat të cilat do të garantonin më shumë liri tregu viheshin në pikëpyetje pas krizës financiare sidomos kur merrej parasysh pabarazia e madhe që ekziston në shtete të ndryshme. Për këtë arsye siç është theksuar në shumë studime rritja ekonomike ndikon menjëherë në ulje të varfërisë ndaj mbetet e rëndësishme të matet efekti i reformave institucionale që promovojnë lirinë e tregut në rritje ekonomike dhe për rrjedhojë në ulje të varfërisë.

3.3.2 Cross Section dhe Seritë Kohore

Analiza mes shteteve (Cross-sectional) përdor të dhëna pesë ose dhjetë vjeçare si p.sh $\Delta t = t - t_0 = 15$. Ajo funksionon duke marrë të dhënat kohore të çdo shteti dhe më pas i mbledh së bashku për të gjetur efektin mesatar që kanë ndryshore të pavarura mbi ritmin e rritjes ekonomike. Është një metodë më e mirë sesa “*growth accounting*” sepse mundohet të shpjegojë ndryshimet e produktivitetit mes shteteve. Kjo metodë u përdor për herë të parë nga *Mankiw et al (1992)*, e cila është e ngjashme me modelin si i Solow por Mankiw ka shtuar dhe kapitali njerëzor si faktor të rëndësishëm. Ky model mundëson për konvergjencën e kushtëzuar dhe nuk parashikon se vendet e varfra do të mundet të arrijnë vendet e pasura në mënyrë automatike. Kritika që vjen për këtë model është se supozimi i saj se gabimet e regresionit nuk janë të lidhura me nivelet e investimit si dhe ritmet e rritjes së popullatës, duke lejuar matjen e të dhënave mes shteteve me metodën e mesatares së katrorit më të vogël (OLS). Por ky regression nuk lejon që të merret në konsideratë heterogjiniteti mes shteteve pasi i merr koeficientet në kohë si konstante pa efekte specifike fikse të çdo shteti. Një shqetësim tjetër në përdorimin e kësaj metode në të dhënat tona ka të bëjë me mungesën e të dhënave të mjaftueshme për vendet e Europës Lindore duke sjellë më pas probleme me “*degrees of freedom*” në regresion.

Analiza e serive kohore do të vinte ne ndihmë për të matur heterogjinitetin e këtyre shteteve, duke shfrytëzuar në maksimum matjen e atyre parametrave që kanë impakt mbi çdo shtet që s'është e mundur në analizë mes shteteve “cross-section”. Por nga ana tjetër analiza e serive kohore nuk mundet të masë ato faktorë, ndryshore, që janë të përbashkëta mes shteteve. Kjo është e rëndësishme që të anashkalohet pasi ne jemi të interesuar se çfarë impakti kanë ndryshore si reformat institucionale mbi rritjen ekonomike të këtyre shteteve.

3.3.3. Panel Data

Ndërkohë që të dhënat mes shteteve “*cross sectional*” mundet që të matin marrëdhënien afatgjatë mes ndryshoreve kjo metodë nuk shfrytëzon në maksimum avantazhet që vijnë nga analiza e serive kohore. Të dhënat në panel nga ana tjetër shfrytëzojnë si seritë kohore ashtu dhe ndryshoret mes shteteve në. Sipas *Temple (1999)* të dhënat në panel do të përdoren gjithnjë e më shumë për të kuptuar rritjen ekonomike, sidomos kur me kalimin e viteve shtohen dhe të dhënat makroekonomike për vendet në zhvillim. Të dhënat në panel dhe regresioni i tyre mundet të anashkalojnë shumë prej problemeve të “*cross sectional*” dhe të përdoren mjaftueshëm “degrees of freedom” sa të mund të integrojmë një numër të mjaftueshëm ndryshoresh të pavarura. Sipas *Temple(1999)* të dhënat në panel gjithashtu mundet të heqin problemin e “heterogjenitetit të pamatur”.

Efekte fikse apo rastësore?

Një model i efekteve fikse (FE) konsideron ndryshoret e pavarura si jo rastësorë, e cila dallon nga modelin i efekteve rastësor “*random*” (RE), i cili i konsideron ndryshoret shpjeguese si të përfshirë nga ngjarje rastësore. Një model i tipit FE përdoret për identifikimin e impaktit të variablave, të cilët ndryshojnë me kalimin e kohës. Kjo teknikë eksploron lidhjen midis variablave të pavarur dhe rritjes ekonomike brenda të njëjtit vend. Kur përdorim FE-në, ne supozojmë se variablat janë të ndikuar nga një karakteristikë individuale dhe nevojitet të kontrollojmë statistikisht për këtë. Logjika pas modelit të efekteve rastësor (RE) qëndron në supozimin se ndryshimi ndërmjet njësive (vendeve) është rastësor (random) dhe i pakorreluar me variablat e pavarur të përfshirë në model. Pra dy metodat bazohen nëse qi do ta përdorim si fiks apo rastësor:

$$y_{it} = x_{it} + h_i + u_{it}, \quad t = 1, 2, \dots, T, \quad (\text{Eq. 2})$$

Ku x_{it} përmban ato ndryshore që mundet të ndryshojnë në shtete (i) dhe vite (t). Kurse h_i njihet si efekte të pamatshme të cilat nuk ndryshojnë me kohën kurse u_{it} është gabimi pasi ndryshon mes shteteve (i) dhe viteve (t). Sipas *Wooldridge (2002)* efekti random RE është sinonim me korrelacion zero mes ndryshoreve të pamatshme të pavarura dhe efekteve të pamatshme:

$$\text{cov}(x_{it}, h_i) = 0, t = 1, 2, \dots, T.$$

Ndërkohë efekti fiks lejon një korrelacion mes ndryshoreve të pamatura η_i edhe ndryshoreve të observuara të matura x_{it} . Përdorimi i FE është më i mirë në ato raste kur numri i njësive është relativisht i vogël dhe të një natyre të veçantë që bën identifikimin e njësive të rëndësishme. Në shumicën e rasteve në panel data përdoret regresioni me efekte fikse pasi lejon për çdo “*intercept*” të çdo shteti në veçanti që mundet të masë si për ato ndryshore të matshme dhe ato të pamatshme.

Por teknika statike e të dhënave në panel si për efektet fikse dhe random nuk kap ato rregullime dinamike heterogjene përgjatë ekuilibrit afatgjatë (Pesaran et al. 1999). Ndaj modelimi i dinamikave në periudhën afatshkurtër kërkon një modelim tjetër ekonometrik.

3.3.4 Metoda e Korrektimit të Gabimeve

Ky model u përdor për herë të parë nga *Islam (1995)* pas studimit të *Mankiw et al (1992)* me metodën “*cross sectional*”. Ai tregoi se modelet me efekte fikse dinamike mund të korrigjojnë për anëshmërinë që vjen në vlerësim të ndryshoreve për shkak të mungesës së integritetit të disa ndryshoreve të tjera duke marrë parasysh dhe kushtet specifike të shteteve si konditat fillestare:

$$Dy_{it} = h_i + q(y_{it-1} - a - bx_{it-1}) + g_1 Dx_{it-1} + g_2 Dy_{it-1} + e_{it} \quad (\text{Eq.3})$$

Në këtë model përdorim ndryshoren η_i si një parametër që mundet të shpjegojë të gjithë ndryshoret e pamatura që potencialisht janë të korreluara me ndryshoren

x_{it} . Në këtë model Y supozohet që ndryshon nga periudha t në t-1 për shkak të ndryshimeve të ndryshoreve të pavarura x nga periudha e mëparshme t. Në modelin e mësipërm koeficienti β mundet të kap efektet afatgjata që ndryshorja x ka në PBB për frymë. Δy_{it} është ndryshorja e varur dhe tregon ndryshimin në log PBB për frymë. Kurse θ tregon shpejtësinë e konvergjencës. Por ky model nuk lejon që koeficientët në periudhën afatshkurtër γ_1 dhe γ_2 të mundet të ndryshojnë mes shteteve. Këto ndryshore në fakt janë supozuar që të mundet të matin heteregjonitetin afatshkurtër të atyre faktorëve që ndikojnë në ekonomi.

3.3.5. Matësi i Mesatares në Grup

Ky model mundet të lejojë për heterogjenitetin mes shteteve duke lejuar koeficientet të ndryshojnë. Ky model konsiston në matjen e regresioneve të veçanta për çdo shtet dhe më pas duhet të gjejmë koeficientet mesatarë për koeficientet për çdo shtet. Por ajo që nuk shkon në këtë model është efekti që mundet të kenë disa të dhëna të përkohshme në mesataren e përgjithshme të koeficienteve:

$$Dy_t = h + q(y_{it-1} - a - bx_{it-1}) + g_1 D_{it-1} + g_2 Dy_{it-1} + e_t \quad (\text{Eq.4})$$

Metoda e mesatarizimit në grup u përdor për herë të parë nga *Pesaran et al (1999)*. Kontributi i këtij modeli të ri ka të bëjë më zgjidhjen e tërë problemeve të evidentuara më sipër, pasi lejon disa koeficientë që të jenë të ndryshëm nga shteti

në shtet ndërkohë që disa të tjerë i mban të pandryshuar. MMG parashikon që koeficientët në periudhën afatgjatë janë homogjenë, ndërsa konstantet, parametrat afatshkurtër si dhe shpejtësia e korigjimit të gabimit θ_i janë heterogjene. *Pesarsan et al. (1999)* argumenton se është e duhur që të mendojmë se marrëdhënia dhe ekuilibri afatgjatë mes ndryshoreve të jetë i ngjashëm mes grupeve të ndryshme për shkak të efekteve që influençojnë këto grupe njëkohësisht dhe me të njëjtën vlerë.

$$Dy_{it} = h_i + q_i(y_{it-1} - a - b x_{it-1}) + g_{1i} D x_{it-1} + g_{2i} Dy_{it-1} + e_{it} \quad (\text{Eq.5})$$

Duke përdorur këto modele të panelit dinamike ne mundet të matim efektet e ndryshme që mundet të kenë ndryshore të ndryshme mbi rritjen e PBB-së për frymë në kohë të ndryshme. Efekti dinamik lejon ekuilibrin afatgjatë mes PBB për frymë dhe ndryshoreve që influençojnë atë.

$$\log y_{it} = \sum_{j=1}^m \hat{a}_{ij} y_{i,t-j} + \sum_{j=0}^g \hat{a}_{ij} EBRD_{i,t-j} + \sum_{j=0}^g \hat{a}_{ij} P_{i,t-j} + h_i + e_{it}$$

$$Dy_{it} = h_i + q(y_{it-1} + b_1 EBRD_{i,t-1} + b_{2i} P_{i,t-1}) + \sum_{j=1}^{m-1} \hat{a}_{ij} Dy_{i,t-j} + \sum_{j=0}^{n-1} \hat{a}_{ij} EBRD_{i,t-j} + \sum_{j=0}^g \hat{a}_{ij} P_{i,t-j} + u_{it}$$

3.3.6 Pasiguritë e modelit

Numri i faktorëve që mundet të ndikojnë në rritjen ekonomike në vendet e Europës Lindore mundet të jetë shumë i madh. Këto ekonomi përjetuan transformim politik, ekonomik dhe social të paprecedentë, duke i bërë kërkimet empirike shpesh herë të vështira për shkak të dhënave jo shpesh të besueshme. Një arsye tjetër përse ky model mundet jetë i pasigurt ka të bëjë me mungesën e një teorie të pranuar mbi rritjen ekonomike. Teoritë tradicionale të rritjes për shembull nuk mundën të parashikonin në kohë ato faktorë që do të mund të lejonin rritje ekonomike të kënaqshme pas recensionit të fortë. Ekonomistë si *Blanchard (1991)* në fakt as nuk e përdorin zhvillimin e institucioneve si të rëndësishme në librin e “*Tranzicioni në Europën Lindore*”. Së fundi edhe në rast se ne kemi të dhëna për Europën Lindore të plota dhe të besueshme shpesh herë lind pyetja se sa duhet të jetë numri i ndryshoreve që ne duhet të përfshijmë në studim. Sipas Temple (2005, f.34) janë më shumë se 145 ndryshore që janë identifikuar në literaturë si faktor të rritjes ekonomike dhe që janë statistikisht domethënëse. Shumëllojshmëria e këtyre ndryshoreve në fakt thekson mungesën e një konsensusi për ndryshoret që ndikojnë në rritjen ekonomike.

Ndaj në këtë seksion do të ngrihet një hipotezë e tillë: reformat institucionale në Europën Lindore, të matura nga indikatorët e *BERZH*, janë një ndër faktorët kryesorë që mund të shpjegojnë diferencat në rritjen ekonomike mes shteteve të

Europës Lindore pas vitit 1991. Modeli që do të përdoret do të bazohet në literaturë dhe do të përdorë inflacionin (si indikator i stabilitetit makroekonomik), kursimet si dhe indeksin e reformave institucionale. Përdorimi i këtyre ndryshoreve është i ngjashëm dhe me disa studime të tjera të bërë në këtë fushë.

Rritja e log PBB për frymë do të jetë ndryshorja e varur. Ndryshoret afatgjatë të përdorura janë lag i reformave, lag i log të inflacionit, lag i log të kursimeve. Në mënyrë që të mundet të kuptojmë ndryshimet afatshkurtër ne do të përdorim lag diferencën e PBB për frymë si dhe lag të dy periudhave të diferencës së PBB për frymë. Në mënyrë që të matet dhe impakti i reformave në periudhën afatshkurtër përdoret lag diferencën e reformave mesatare.

3.4. Modeli II: Ashensori Social

A mundet të interpretojmë ngadalësimin e reformave institucionale bazuar në mungesën e mbështetjes popullore pas krizës financiare të vitit 2008? Në këtë model do të analizojmë arsyet në nivel mikro të sjelljes së qytetarëve në mbështetje ose jo të reformave në ekonomi dhe të një roli më të madh të shtetit me justifikimin e uljes së pabarazisë në vend. Sipas ekonomistit Uilliamson që një ekonomi të ketë sukses me reformat e saj institucionale duhet të ketë parasysh tre faktorë: një lidhë vizionar, politika ekonomike koherente si dhe mbështetje popullore për reformat. Rëndësinë e kësaj të fundit e mbështet dhe *Rodrik (1996)* si dhe *Drazen (2000)*. Por këto dy punime në fakt japin vetëm vlerësim teorik se

papunësia dhe niveli i të ardhurave janë domethënës pa ndonjë të dhënë empirike mbi këto vlerësime. Studime të shumta kanë bërë vlerësime indirekte të mbështetjes popullore për reforma duke marrë për bazë rezultatet e zgjedhjeve të partive që mbështesin reformat ekonomike dhe atyre që nuk i mbështesin si *Warner (2001)*, por kjo praktikë nuk vlerëson saktë nëse mbështetja vjen për partinë apo për politikën e saj. Ndaj shpesh herë janë preferuar dhe sondazhet e bëra ku disa prej tyre gjejnë se mbështetja për reforma ekonomike varet kryesisht në bazë të eksperiencës personale të qytetarëve *Koela (2002)*.

Ndërkohë që studime të tjera si *Hayo (2004, f.4-6)* tregojnë përse në tërësi një shoqëri është pro apo kundër mbështetjes së reformave. Është vënë re se një rritje e inflacionit me 100% do të reduktonte mbështetjen për reforma me 1%, sikundër dhe niveli i lartë i papunësisë, rritja me 10%, ul mbështetjen për reforma me 16%. Por ky studim vëren se dy indikatorë janë të rëndësishëm për mbështetjen e reformave: de-rregullimi financiar si dhe mirëfunksionimi financiar duke rritur mbështetjen me 23%. Nga ana tjetër është vënë re se privatizimi në tërë vendet e Europës Lindore ka një efekt negativ në mbështetjen për reforma. Për qytetarët e kjo politikë ka qenë e gabuar duke ndikuar më shumë negativisht dhe se papunësia në mbështetje për reforma. Por ndërkohë që kriza ekonomike preku tërë shtetet e Europës Lindore duke pasur efekt negativ në rritje ekonomike dhe duke rritur papunësinë në këto vende atëherë studimi i lartpërmendur tregon se dhe

mbështetja për reforma do të bjerë. Në këto kushte duke përdorur të dhënat e pyetësorëve të *BERZH* (2006,2010) do të ndërtojmë një model për të matur sesi kanë ndryshuar sjelljet e qytetarëve në mbështetje të ndërhyrjes më të madhe të shtetit në ekonomi, kryesisht për të ulur varfërinë. Të dhënat të cilat janë në shqyrtim përbëhen nga 29,000 pyetësor të shpërndarë në 29 shtete të ndryshme të Europës Lindore si dhe disa shtete të zhvilluara të perëndimit si Gjermania dhe Italia. Këto të dhëna të shteteve të zhvilluara kanë shërbyer në studim për të bërë analizën dhe diferencën e sjelljes së qytetarëve karshi rolit të shtetit mes vendeve në tranzicion si dhe vendeve me institucione tregu efikase por me shtet social të mirë zhvilluar.

Në çdo shtet *BERZH* në bashkëpunim me Bankën Botërore ka mbledhur 1000 pyetësorë gjatë viteve 2006 si dhe 2010. Këto pyetësorë janë të ndarë në shtatë seksione të mëdha: konsumi i familjarëve, shpenzimet e familjeve, vlerat dhe qëndrimet e tyre ndaj ngjarjeve ekonomike, eksperiencat e tyre në tranzicion, shëndetësi si dhe sjellja e tyre politike. Çdo intervistë ka zgjatur 45 minuta dhe janë të detajuara në marrjen e sa më shumë informacioni përsa I përket eksperiencës së individëve dhe familjeve të tyre gjatë tranzicionit, qëndrimet e tyre ndaj privatizimeve dhe rolit të shtetit si dhe sjellja e tyre karshi këtyre reformave duke u matur në qëndrimet e tyre ndaj partive politike si përcjellëse të vullnetit të tyre.

Këto të dhëna janë unike pasi në këtë studim na mundësojnë nëpërmjet metodave ekonometrike të regresionit logjistik ne të mund të masim dhe të krahasojmë sjelljen dhe perceptimet subjektive të qytetarëve përsa i përket zhvillimeve ekonomike dhe politike të tyre. Modeli i parë makroekonomik i përmendur më sipër na ndihmon ne që të bëjmë një matje statistikore dhe të shohim arsyet e divergjencave në rritjen ekonomike. Megjithëse rezultatet e kësaj hipoteze na ndihmojnë në tërësi të kuptojmë dhe analizojmë performancën e shteteve mes tyre, ne duhet gjithashtu të kuptojmë dhe sjelljen e qytetarëve ndaj këtyre reformave pasi për të qenë të suksesshme në periudhën afatgjatë këto reforma duhet të pranohen nga publiku.

Ky model na ndihmon të kuptojmë të ardhmen e politikave neoliberales në ekonomi. Siç kemi përmendur më sipër reformat neoliberales synonin avancimin e tregut në ekonomi nëpërmjet privatizimeve, de-rregullimit e tërheqjes së shtetit në tërësi nga ndërhyrjet për të garantuar rritje ekonomike të lartë. Ndërkohë në rast se vërtetohet një ndryshim i perceptimit të publikut për rolin e shtetit kjo do të justifikonte dhe një kthim pas të politikave neoliberales dhe ngadalësim të reformave institucionale. Ky model do të analizojë sjelljen në nivel individual të mbështetjes së ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Duke analizuar sjelljen e individëve përsa i përket probabilitetit për të mbështetur ose jo reformat ekonomike dhe për rrjedhojë ndërtimin institucioneve që janë të rëndësishme për

ritje ekonomike. Të dhënat janë të rendit rendor atëherë për të analizuar efektin që kanë ndryshore të tilla si perceptimi për të ardhmen, besimi te qytetarët e tjerë, papunësia etj. do të përdoret regresioni logjistik rendor (*ordered logit*).

Në ato raste kur ndryshorja e varur është një numër rendor (*ordinal*), do të merrnim të dhëna të gabuara në rast se përdorim regresionin OLS. Modeli logjistik rendor (*ordered logistic*), që njihet dhe si probabiliteti proporcional, është modeli më i preferuar në këto raste. Në mënyrë që ne të mund të analizojmë arsyet përse qytetarët mbështesin ose jo ndërhyrjen e shtetit për të ulur pabarazinë na duhet të përdorim pyetësorët e *BERZH* për vitin 2006 dhe vitin 2010. Duke u bazuar në teorinë e mësipërme përse i përket mobilitetit social dhe sjelljes së individit ne përdorim regresionin *ordered logit*. Për të matur një regresion binar logjistik (*logistic*) ne masim probabilitetin që të ndodhë një event që ne kemi në shqyrtim. Në rast se ndryshorja e pavarur nuk merr vlerat 0 apo 1 por ka më shumë alternativa si përgjigje atëherë përdoret modeli *ordered logit*.

Modelet rendore logjistik përdoren për të vlerësuar marrëdhëniet midis një variable të varur rendore dhe një grupimi variablash të pavarura. Një variabël rendor është një variabël që është kategorik dhe rendor, për shembull, "të varfër", "mirë", dhe "i shkëlqyer", e cila mund të tregojnë statusin shëndetësor aktual të një personi ose riparimin e një makine. Nëse ka vetëm dy vlerësime ose përgjigje mundet të përdoret regresioni logit ose probit.

Në regresionin rendor logjistik, një rezultati vlerësohet si një funksion linear i variablave të pavarura. Probabiliteti për të marrë si përgjigje zgjedhjen i korrespondon me probabilitetin se funksioni i vlerësuar linear, plus gabimin e rastit (random error), është brenda intervalit të segmentit të vlerësuar për:

$$\Pr(\text{outcome} = i) = \Pr(\kappa_{i-1} < \beta_1 x_{1j} + \beta_2 x_{2j} + \dots + \beta_k x_{kj} + u_j \leq \kappa_i)$$

u_j supozohet të ketë shpërndarje logjistike në logit rendor. Në secilin rast, ne vlerësojmë koeficientet $\beta_1, \beta_2, \dots, \beta_k$ sëbashku me $\kappa_1, \kappa_2, \dots, \kappa_{k-1}$, ku k është numri i rezultateve të mundëshme.

Probabiliteti për çdo observim të dhënë në një regresion rendor logjistik jepet:

$$p_{ij} = \Pr(y_j = i) = \Pr(\kappa_{i-1} < x_j \beta + u \leq \kappa_i)$$

$$\frac{1}{1 + \exp(-\kappa_i + x_j \beta)} - \frac{1}{1 + \exp(-\kappa_{i-1} + x_j \beta)}$$

Log likelihood jepet:

$$\ln L = \sum_{j=1}^x (w_j) \sum_{i=1}^k I_i(Y_i) \ln p_{ij}$$

ku w_j është pesha opsionale dhe :

$$I_i(y_j) = \begin{cases} 1, & \text{nese } y_j = i \\ 0, & \text{cdo rast tjeter} \end{cases}$$

Modeli III Testi i Kursit të Këmbimit dhe Kreditimi Financiar

Duke qenë se dhe Shqipëria është një vend me ekonomi të vogël e të hapur stabiliteti i kursit të këmbimit është shumë i rëndësishëm për shumë ndryshore të ekonomisë si inflacioni i importuar, konkurrueshmëria e eksporteve vendase dhe kosto e kredisë në monedhë të huaj etj. Në këtë këndvështrim do të analizohet sjellja e Lekut ndaj dy monedhave kryesore: euros dhe dollarit amerikan në kushtet kur kursi zyrtar i këmbimit është tërësisht fleksibël.

Ka shumë studime që tregojnë se balanca tregtare preket direkt nga niveli i kursit të këmbimit. *Huchet-Bourdon dhe Korinek (2011)* kanë bërë një studim mbi efektin që ka kursi i këmbimit në volatilitetin e volumit tregtar në sektorin e bujqësisë dhe industrisë mes Eurozonës, Kinës dhe SHBA-së. Gjetja e tyre është mjaft interesante pasi tregon se nëse dollari amerikan do të zhvlerësohej me 10% kundrejt juan-it kinez atëherë kjo do të sillte përmirësim në tregtinë e jashtme me Kinën prej 13%, ose ulje të defiçitit tregtar me 35 miliardë Dollarë.

Shqipëria aktualisht ndjek një regjim fleksibël të kursit të këmbimit. Tradicionalisht argumenti kryesor në favor të kësaj politike është që politika monetare nuk është e ndikuar nga niveli i paracaktuar i kursit të këmbimit. Një ndër arsyet përse në një ekonomi ka nivel të lartë të kreditimit në monedhë të huaj është kosto e huamarrjes në monedhën vendase dhe në monedhën e huaj.

Një model i thjeshtë $AR(1)$ është:

$$y_t = \rho y_{t-1} + u_t$$

Ku y_t është ndryshorja me interes, t është indeksi i kohës, ρ është koeficienti dhe u_t është gabimi. Një “unit root” është present nëse $\rho = 1$ dhe në këtë rast modeli nuk do të ishte stacionar, pra të dhënat e shkuara kanë një efekt në vlerën e monedhës sot. Në rast të kundërt kur të dhënat janë stacionare atëherë të dhënat kthehen në mënyrë frekvente drejt një mesatareje.

Regresioni mundet të jepet në këtë formë:

$$\nabla y_t = (\rho - 1)y_{t-1} + u_t = \delta y_{t-1} + u_t$$

Ku ∇ është diferenca e parë pra ne testojmë nëse $\delta = 0$ (ku $\delta = \rho - 1$).

Në rast se vlera e z është më e madhe sesa vlera e z kritike atëherë ne e pranojmë faktin që Hipoteza 0 është e vërtetë, pra të dhënat nuk janë stacionare. Mënyra e dytë e vlerësimit është vlera e McKinnon e p -së është më e madhe se vlera kritike atëherë ne e pranojmë H_0 .

H_0 : të dhënat kanë një “unit root” dhe nuk janë stacionare

H_1 : të dhënat nuk kanë Unit root dhe janë stacionare.

Të dhënat analizojnë luhatjet ditore të monedhës vendase me tre monedhat e rëndësishme ndërkombëtare: EURO, USD dhe GDP. Të dhënat fillojnë nga data 1 Janar 2004 deri më 18 Janar 2015. Shtetet që do të merren në shqyrtim janë disa prej shteteve në tranzicion (Shqipëria, Serbia, Rumania, Polonia, Kroacia, Maqedonia) të cilat kanë kurs këmbimi fleksibël. Kjo do të na ndihmojë të shohim nëse ka shtete të cilat mundet të ndjekin një politikë të fshehtë të mbajtjes së kursit të këmbimit nën kontroll dhe jo ta lërë atë të jetë krejtësisht fleksibël. Rezultatet e regresioneve dhe të testit *Dickey-Fuller* më pas krahasohen me klasifikimin zyrtar të bërë nga FMN për sa i përket monedhave vendase. Gjithashtu me anë të një rëgresioni të thjeshtë mundohemi t'i japim përgjigje kësaj pyetjeje:

A ka impakt kredidhënia në rritjen Ekonomike në Shqipëri? Kësaj pyetjeje i japim përgjigje nëpërmjet një regresioni të parë ku llogarit paraqet ndryshimin në nivelin e kreditimit në ekonomi. Në masim ndryshimin e kreditimit me anë të diferencës mes kredisë së dhënë në një periudhë në ndryshim me një periudhë tremujore të mëparëshme. Ajo varet nga disa ndryshore të pavarura si trendi i kredidhënies në periudhën paraardhëse e cila tregon në një farë mënyrë dhe pritshmëritë e rritjes ekonomike dhe aktivitetit ekonomik në vend. Një ndryshore tjetër e pavarur që shpjegon ndryshimin e rritjes së kreditimit ka të bëjë me diferencën e vënë re mes performancës së kredive të këqija në ekonomi.

$$\begin{aligned}
& \ln(ct) - \ln(ct - 1) \\
& = k + 1ct - 1 + \alpha 2ct - 2 + \alpha 3Ln(NPLt) \\
& - \ln(NPLt - 4) + \alpha 4nt - 1 + \alpha 5nt - 2
\end{aligned}$$

Nga ana tjetër të dhëna më poshtë tregojnë nëse kemi ose rritje ekonomike në varësi kushteve ekonomike, pra seri të tremujorit të mëparshëm dhe të tremujorëve të mëparshëm të rritjes ekonomike si dhe niveli i kredisë dhe performance e saj. Në këtë model mundohemi të masim efektin që ka në rritje ekonomike kreditimi në ekonomi e matur me $\beta 3Ct + \beta 4Ct - 1 + \beta 5Ct - 2$.

Ndryshoret Instrumentale (Instrumental Variables)

$$\begin{aligned}
2SLS \ln gdp_t - \ln gdp_{t-4} = & k_1 + \beta 1gt - 1 + \beta 2gt - 2 + \beta 3Ct + \beta 4Ct - \\
& 1 + \beta 5Ct - 2
\end{aligned}$$

Interpretimi i efektit që ka patur kreditimi në rritje ekonomike bëhet vetëm për rastin e Shqipërisë dhe nuk është pjesë thelbësore e studimit tonë. Por shërben më tepër për të analizuar të dhënat e rritjes ekonomike gjatë 15 viteve të fundit dhe për të parë rolin që ka sistemi financiar në promovimin e rritjes ekonomike.

Ky kapitull theksoi dhe njëherë shumëllojshmërinë e të dhënave dhe tre llojeve të metodologjive ekonometrike të përdorura. Për të matur hipotezën e parë të efektit

të reformave institucionale në rritje ekonomike përdorim regresionin panel dhe mesatares në grup. Ndërkohë për të analizuar sjelljen e qytetarëve në Europën Lindore dhe në Shqipëri në vecanti janë marrë në shqyrtim mbi 40,000 pyetësor të përfutuara në 27 shtete ndër vite nga BERZH dhe që ky studim i analizon në një këndvështrim specifik me anë të softëarit STATA për rastin e Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit. Të dhënat e përdorura më pas në këtë analizë merren dhe nga databaza e Bankës Botërore përse i përket preferencave dhe kërkesave të biznesit në vend. Sic u theksua dhe më parë këtë analizë e bëjmë nëpërmjet regresionit logjistik dhe masim impaktin e ndryshimeve të preferencave në politika ekonomike. Për më tepër duke qënë se sistemi financiar është përfaqësimi parësor i politikave neoliberales mundohemi të kryejmë një test mes shteteve të Europës Lindore me anë të regresionit të serive kohore për të matur nëse kursi i këmbimit në Shqipëri është i ndryshëm nga politika zyrtare. Të dhënat e përdorura në këtë rast janë marrë nga *FMN* dhe për një periudhë 10 vjeçare. Në kapitullin 4 shpjegohen rezultatet e dy hipotezave të para të impaktit në rritje ekonomike dhe preferencat për reforma. Ndërsa në kapitullin pesë do të bëhet një përshkrim i rëndësisë së kursit të këmbimit në ekonomi dhe të rezultateve të përfutuara nga analiza krahasimore e bërë.

KAPITULLI 4: REZULTATE

4.1. Hyrje

Ky kapitull shërben për t'i dhënë përgjigje direkte dy hipotezave të ngritura në fillim të kësaj doktorature: nëse reformat institucionale shpjegojnë një pjesë të mirë të divergjencës mes ekonomive të Europës Lindore përsa i përket rritjes ekonomike dhe së dyti, nëse ashensori social individëve është një faktor i rëndësishëm për të legjitimuar reformat institucionale neoliberales në Europën Lindore. Në të do të paraqiten rezultatet e regresionit si dhe testet e nevojshme për të pranuar ose hedhur poshtë këto hipoteza. Në këtë proces paraqiten të dhëna dhe interpretime teorike të ndryshoreve të përdorura në regresion dhe nga ana tjetër këto rezultate do të krahasohen me rezultate të studimeve të tjera për të parë ngjashmëritë ose jo me to.

4.2. MODELI 1

A mundet të shpjegohet divergjenca e vënë re në rritjen ekonomike në Europën Lindore për shkak të ndryshimeve në nivelin e reformave institucionale neoliberales të ndërmarra në këto ekonomi dy dekadat e fundit?

Hipoteza 1

Ato shtete të cilat kanë ndërmarrë më shumë reforma institucionale neoliberales kanë patur rritje ekonomike më të lartë.

4.2.1. Ekonomia në Europën Lindje

Të ardhurat për frymë në Europën Lindore nuk mundet të jenë të njëjta për të gjitha shtetet, pasi disa shtete tashmë janë bërë pjesë e Bashkimit Evropian ndërkohë që shtete të tjera janë prekur dhe nga konflikte dhe luftëra të brendshme që mund të ketë ndikuar në PBB. Por pavarësisht këtyre fakteve hendeuku i krijuar këto 20 vite mes disa shteteve është jashtëzakonisht i lartë dhe shqetësues. Për shembull vendi me PBB për person më të ulët është Moldavia e cila në vitin 2007 para krizës globale kishte të ardhura për frymë të barabartë me \$2,416. Kjo ndiqej nga Gjeorgjia dhe Armenia me \$4405 dhe \$ 5391 respektivisht, ndërkohë që Shqipëria, që vetëm pesë vite më parë konsiderohej si vendi më i varfër në Europë, kishte të ardhura për frymë të barabarta me \$6027. Nga ana tjetër vende si Sllovenia dhe Republika Çeke kishin të ardhura për frymë rreth pesë herë më të larta. Sllovenia në vitin 2011 kishte të ardhura për frymë të barabartë më \$25,576 kurse Republika Çeke kishte të ardhura për frymë të barabartë me \$22,505.

Së dyti duhet vënë re që dhe ritmet e rritjes së PBB-së kanë qenë të ndryshme për secilin prej këtyre vendeve. Është e habitshme sesi për shembull shtete si Gjeorgjia, Moldavia apo dhe Ukraina në vitin 2007 kishin PBB më të ulët sesa më 1989, që e thënë ndryshe më të varfër sesa kishin para rënies së komunizmit. Gjithashtu është e habitshme se si vende të tjera si Sllovenia, Sllovakia, Polonia apo Hungaria arritën të kalojnë nivelet e të ardhurave të vitit 1989 para vitit 2000.

Po ashtu është tejet e habitshme divergjenca që pati Polonia dhe Ukraina ku Polonia mundi të dyfishojë të ardhurat nga viti 1992 në 2007 në \$15,401 për frymë ndërkohë që Ukraina mbeti në pothuajse të njëjtat nivele si më 1992 në 2007 në \$6,635.


Një interpretim i shpejt i këtyre të dhënave tregon se diferencimi në rritje ekonomike nuk është thjeshtë për shkak të pozicionit gjeografik apo vitet e kaluara në komunizëm. Kjo shpjegohet më së miri nga performanca e rritjes ekonomike të Estonisë e cila arriti standarde më të larta jetese sesa Lituania apo Letonia. Për këtë arsye është e qartë që komenti i ekonomistit Islam (2004) është tejet i drejtë kur thotë që *“vendet në zhvillim nuk mund të rrinë të qetë dhe të besojnë se ka proçese të jashtme që do tu garantojnë atyre rritje ekonomike që mund t’i çojë në të ardhura të larta si ato të vendeve të pasura”*.

Të dhënat e mësipërme tregojnë qartësisht se rritja ekonomike nuk vjen e njëtrajtshme dhe makroekonomia mundohet të analizojë pikërisht strukturën, performancën dhe sjelljen e ekonomisë si një e tërë. Në veçanti makroekonomia moderne mundohet të kuptojë luhatjet afatshkurtër në PPB-së (ciklet e biznesit) dhe përcaktuesit afatgjatë të rritjes ekonomike. Pavarësisht diskutimeve PBB-ja mbetet indikator kryesor që mat performancën e ekonomisë dhe që siguron mirëqenie për tërë popullatën.

Por, keqmenaxhimi i ekonomisë ka sjellë dhe dështime të politikave deri në Luftën e Dytë Botërore me pasoja për njerëzimin dhe ekonominë botërore. Ndaj analizimi dhe interpretimi i saktë i arsyeve që çojnë në stabilitet dhe rritje ekonomike është i nevojshëm. Gjithashtu nuk duhet harruar se teoritë ekonomike, nga vetë përkufizimi janë thjeshtësim i realitetit të botës reale. Ndaj problemi kryesor i teorisë dhe modeleve ekonomike është mënyra se si të kuptojmë kompleksitetin e sjelljes së miliona njerëzve në ekonomi. Modelimet na japin mundësinë për të ndërtuar “laboratorë të munguar” në shkencat sociale. Ndaj në modelime makroekonomike ne mundohemi që të përqendrojmë analizën në disa faktorë kyç që çojnë në rritje ekonomike dhe më pas përzgjedhim ato indikatorë që duhen përmisuar për të arritur objektivat e vendosura nga shoqëria apo politikbërësit. Por pikërisht ky proces nuk ka qenë i lehtë për ekonomistët në shekullin e 20-të.

Shqipëria si dhe vendet e tjera të Europës lindore për një kohë të gjatë shpenzuan energji të panumërta njerëzore për të industrializuar ekonominë e tyre me shpresën se kjo do të çonte në rritje ekonomike dhe mirëqenie për të tërë. Bazuar në teoritë ekonomike Marksist Leniniste kjo dëshmoi e gabuar deri në vitin 1991. Beteja e ideve do të vazhdojë për një kohë të gjatë dhe është e pamundur që të arrihet në përfundimin se forma e sotshme e organizimit ekonomik do të qëndrojë në përjetësi. Kriza e vitit 2008 vetëm sa ekspozoi këtë fakt dhe akademikë dhe

politikbërës janë akoma në procesin e analizës se çfarë shkoi keq në sistemin e vjetër dhe si mundet të evoluohet në një sistem më të mirë. Por nuk duhet harruar se krizat ekonomike janë të pashmangshme. Të paktën historia njerëzore këtë ka treguar. Por ajo që dihet është se krizat nuk janë identike.



Grafik 1: Të Ardhurat për Frymë në Shqipëri 1870-2010


Siç shihet dhe nga të dhënat dhe në rastin e Shqipërisë të ardhurat për frymë janë rritur shumë ngadalë gjatë pesë dekadave të fundit. Të dhënat e mësipërme vijnë nga studimi i kryer nga profesori amerikan *Madison (2008)* i Universitetit Gerogetoun i cili përmbledh të dhënat për ekonominë botërore. Të dhënat për periudhën 1870-1913 janë përafërsime të të dhënave të mbledhura nga kronikat e

kohës. Por ajo që vihet re në fakt është se Shqipëria ashtu si dhe shumë vende të tjera rurale në Ballkan nuk ka patur rritje ekonomike domethënëse gjatë kësaj periudhe. Ajo që pritet dhe nga të dhënat është se gjatë viteve 1950-1970 vendi pati përfitimet e para nga investimi në makineri dhe teknologji. Kështu të ardhurat për frymë sipas të dhënave në vitin 1950 ishin 1000 \$/frymë dhe në fund të vitit 1970 ishin dyfishuar në 2000 \$/frymë.

Vihet qëndrimi në vend gjatë viteve 1980. Sipas këtyre të dhënave në ekonominë shqiptare është mundur të rriten të ardhurat me vetëm 100 dollar në dhjetë vjet. Ndaj shtrohet pyetja se si ka mundësi që megjithëse politikat ekonomike ishin të njëjta dhe popullata ishte më e kualifikuar se në vitet 1950 rritja ekonomike pothuajse mbeti në vend? Çfarë e bëri dekadën e vitit 2000-2010 të sjellë përfitime aq të mëdha sa nuk ishin arritur më parë në ekonominë tonë, pavarësisht angazhimit të madh shtetëror?

Krahasimi i Ekonomive Botërore

Në vitin 1870 Suedia ishte shteti më i varfër i Europës Perëndimore. Ajo ishte pothuajse tre herë me varfër sesa Mbretëria e Bashkuar. Ndërkohë që në vitin 2008 Suedia ka të ardhura për frymë më të larta sesa Mbretëria e Bashkuar dhe se shumë shtete të tjera të Europës Perëndimore.



Grafik 2: Produktiviteti për Punëtor, Shqipëri, Greqi, Rumani dhe Bullgari. Burimi i të dhënave: Banka Botërore, statistika.

Ndërkohë grafiku më sipër tregon se si ka performuar produktiviteti për punëtor mes vendeve të ballkanit. Të dhënat janë marrë nga Banka Botërore dhe janë përmbledhur për të parë sesi Greqia e cila përqafoi institucione demokratike dhe në tërësi ekonomi tregu munda të shkëputet nga vendet e tjera të Ballkanit si Shqipëria, Rumania dhe Bullgaria gjatë viteve 1960-1990. Kjo diferencë në produktivitet demonstroi pikërisht rolin e institucioneve që inkurajojnë sipërmarrjen dhe përdorimin dhe inovacionin teknologjik për të ofruar rritje të produktivitetit për punëtor.

Rritja ekonomike është një fenomen i ri. Nxitja e parë ka ndodhur në Mbretërinë e Bashkuar dhe më pas në Francë në mes të viteve 1800. Në fakt rritja ekonomike para këtyre viteve ka ndodhur me një hap shumë të ngadaltë. Sipas përlogaritjeve të Maddison (2001) të ardhurat për frymë në ekonominë botërore në vitin 1000 nuk ishin më të larta se në vitin 1. Sikundër të ardhurat në vitin 1820 ishin vetëm 53% më të larta se në vitin 1000⁵, ose e thënë ndryshe një rritje ekonomike të barabartë me 1/19 % rritje ekonomike në vit për këtë periudhë kohe. Ndërkohë që gjatë viteve 1820-70 ajo u rrit me 0.5% dhe më pas me 4% në vitet 1950-1970. A ishte rritja e ngadaltë në 1000 vite presioni Malthusian i rritjes së popullatës dhe efekti i saj mbi burimet natyrore të shterëshme? Apo ishte diçka tjetër? Përse pati një rritje të menjëhershme të rritjes ekonomike në shekullin e 19-të dhe jo më parë Aghion (2009)? Me fjalë të tjera si mundet të shpjegohet tranzicioni nga bujqësia në industri përpunuese, dhe më pas në shërbime dhe më pas në një ekonomi ku rritja bazohet në akumulimin e kapitalit në inovacion?

4.2.3 Rezultate Pooled Mean Group

Tabela e mëposhtme tregon rezultatet e modelit të Mesatares në Grup (Pooled Mean Group) përsa i përket performancës së rritjes ekonomike dhe reformave institucionale në Europën Lindore. Kolona e parë tregon për një efekt afatgjatë

⁵ Aghion (2009) shpjegon në mënyrë të detajuar tërë literaturën e rritjes ekonomike. Detajet në këtë shkrim përshkruajnë rritjen e paprecedentë të mirëqënies anembanë botës gjatë dy shekujve të shkuar.

dhe pozitiv të reformave institucionale në rritjen ekonomike apo të PBB/frymë. Ky rezultat është domethënës në nivelin 1% dhe PMG imponon një koeficient homogjen afatgjatë mes shteteve, që përmison efikasitetin e vlerësuesëve. Koeficienti i lag mesatares është i barabartë me 3.24, ku ceteris paribus, një rritje në indikatorin e reformave institucionale do të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike në vitin pasardhës. Duhet theksuar se kjo vlerë është disa herë më e ulët se e një studimi tjetër të bërë për efektin e reformave ekonomike që gjen se koeficienti është 7.14 në Arellano-Bover vlerson në in *Falcetti et al. (2006)*, por është më i lartë sesa 2.49 që gjen i njëjti studim kur përdor metodën *within grup*. Kolona e dytë në tabelën 1 tregon efektin e pjesshëm që ka vetëm reforma institucionale në sistemin financiar mbi rritjen ekonomike. Ky indikator është pozitiv dhe domethënës duke theksuar rëndësinë që ka mbikëqyrja e sektorit bankar në promovimin e kreditimit dhe lehtësimit të financimit të investitorëve vendas dhe të huaj në ekonomi. Por efektin më të madh në ekonomi e ka liberalizimi i tregut që mbështet dhe argumentet e mëparshëm mbi lirinë e tregut si institucioni më i duhur për të garantuar efikasitet në prodhim. Në fakt impakti që ka ky indikator në rritje ekonomike është dhe më i rëndësishëm sesa reforma financiare.

Tabela 7

Ndryshorja e Varur: Ndryshimi Logaritmik i te Ardhurave

	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
Koeficientet afatgjate					
LogKursime-1	0.11 (0.71)	0.42*** (0.10)	0.54*** (0.15)	0.45*** (0.17)	1.15*** (0.31)
LogInflacion-1	0.12*** (0.05)	-0.05* (0.03)	0.10** (0.04)	-0.05 (0.05)	-0.54*** (0.15)
Reform mesatare-1	3.24*** (0.74)				
Financiare Reform-1		1.02*** (0.11)			
SipermarrReform-1			2.04*** (0.40)		
Liberalisim tregu -1				2.05*** (0.46)	
log remitanca -1					0.31** (0.15)
Konverginca mesatare					
Coeficient LogY-1	-0.026*** (0.01)	-0.034** (0.02)	-0.018* (0.01)	-0.02* (0.01)	-0.014* (0.01)
Koeficient mesatar afatshkurters					
LagΔLogY	0.28*** (0.08)	0.32*** (0.09)	0.30*** (0.10)	0.34*** (0.07)	0.24*** (0.08)
L2ΔY	-.13** (.066)				-.16*** (0.06)
LagΔAverage		-.03 (.08)	-.087 (.07)		
LagΔLogInfaltion				-0.01 (0.01)	
Constant	0.03*** (.01)	0.20** (0.86)	0.07 (0.01)	0.05* (0.01)	0.08*** (0.03)
Numri i shteteve ..	24	24	24	24	24
Numri i paramterave	360	384	301	384	360
Log Likelihood	752	736	734	725	69
BIC	28	28	28.45	28.48	28.2

(***, **, dhe * tregojne nivel domethenie 1%, 5% dhe 10%)

Tabela 8

Ndryshorja e Varur: Ndryshimi Logaritmik I të Ardhurave

	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
Koeficientet Afatgjate					
LogInflacion-1	0.10** (0.05)	-0.15* (0.05)	0.12** (0.05)	0.07 (0.04)	-0.31*** (0.02)
Reforma Mesatare-1	2.8*** (0.53)	2.4 (0.45)	2.28*** (0.50)	2.1*** (0.57)	
Reform Financiar -1		-0.71 *** (0.23)			
ReformSipermarrje-1			0.91* (0.53)		
LiberalizimTregu -1				1.16** (0.52)	
LogFDI-1					0.02*** (0.01)
Konvergjica Mesatare					
Koefficient LogY-1	-0.024* * (0.01)	-0.021*** (0.01)	-0.023*** (0.01)	-0.0197** (0.01)	-0.043* (0.02)
Koeficient Mesatar AfatShkurter					
LagΔLogY	0.27*** (0.10)	0.31*** (0.07)	0.27*** (0.09)	0.26*** (0.09)	0.35*** (0.06)
L2ΔY	-0.15* (0.06)	-.13** (.06)	-0.11* (0.06)		-0.11 (0.06)*
LagΔMesatare	-0.04 (0.02)		-0.03 (0.03)	-0.45* (0.02)	
Lonstant	0.07*** (0.16)	0.07*** (0.2)	0.05*** (0.12)	0.03 (0.02)	0.40** (0.18)
Numer I shteteve	24	24	24	24	24
Numer i Observimeve	360	384	360	360	38
Log Likelihood	807	737	808	808	717
BIC	27.8	22.5	33.7	33.7	16.55

(Shënim: Kjo tabelë paraqet të dhënat e rezultatit PMG. BIC qëndron për Bayesian Information Criterion. Vlerat në kllapa janë gabimet standarte. ***, **, dhe * tregojnë domethënien në 1%, 5%, dhe 10%)

Tabela 9

Ndryshorja e Varur: Ndryshimi Logaritmik I te Ardhurave

	(1)	(2)	(3)
Long Run Coefficients			
LogInflation-1	-0.05* (0.03)	-0.02* (0.01)	0.05 (0.04)
Average Reform-1			
Financial Reform-1	1.16*** (0.16)		
EnterpriseReform-1		0.39*** (0.01)	
MarketLib-1			1.87*** (0.33)
Average Convergence Coefficients			
LogY-1	-0.037* ** (0.07)	-0.048* (0.02)	-0.029** (0.02)
Average Short Run Coefficients			
LagΔLogY	0.32*** (0.07)	0.30*** (0.06)	0.27*** (0.08)
L2ΔY	-0.07 (0.06)		
LagΔenterprise		-0.03** (-0.01)	
LagΔinflation			0.01 (0.03)
Constant	0.25*** (0.07)	0.41* (0.21)	0.12 (0.03)
Number of Countries	24	24	24
Number of Observations	360	384	301
Log Likelihood	759.45	760.52	743.13
BIC	22.05	22.43	21.02

(Shënim: Kjo tabelë paraqet të dhënat e rezultatit PMG. BIC qëndron për Bayesian Information Criterion. Vlerat në kllapa janë gabimet standarte. ***, **, dhe * tregojnë domethënien në 1%, 5%, dhe 10%)

Nga ana tjetër indikatori i reformës në tregje është një mesatare e reformave në liberalizim të çmimeve, liberalizim tregtar si dhe indikatori i konkurrueshmërisë në ekonomi. Liberalizimi i çmimeve është i rëndësishëm pasi i lejon sinjalizimin në kohë dhe pa kosto vendimmarrësit në ekonomi për të lejuar hapësirat për të ndërmarrë vendime fitimprurëse. Indikatori më i lartë për këtë ndryshore tregon se qeveria nuk ka asnjë kontroll mbi çmimet përveçse në raste të veçanta mbi si transporti dhe monopole natyrore. Indikatori i konkurrueshmërisë nga ana tjetër tregon se sa efikase janë institucionet mbikëqyrëse të shtetit për të penguar dominimin e disa firmave në ekonomi dhe të konkurrencës së pandershme. Siç dhe u pa më sipër grupet e interesit kanë mundësi të influencojnë më pas dhe rregullat e lojës në shoqëritë në tranzicion. Për këtë arsye ky indikator, sa më i lartë të jetë, aq më pak mundësi kanë firmat për të patur rol dominues në ekonomi pa u ndëshkuar. Gjithashtu ky indikator tregon dhe se sa e hapur është ekonomia me ekonomitë e tjera globale, kjo vlerësohet duke analizuar nëse kanë hequr çdo lloj bllokimi administrativ të importeve ose eksporteve.

Ashtu dhe siç pritet ndryshorja e kursimeve ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike afatgjatë të këtyre vendeve. Por në modelin e dytë e heqim si faktor në periudhën afatshkurtër. Të dhënat tregojnë se vlera e parametrave ndryshon duke e bërë dhe vlerën e koeficientit të reformave financiare negative. Sic mundet të shihet në tabelën dy.

Tabela 3 nga ana tjetër është model më i mirë për të kapur efektet e pjesshme që kanë reformat në rritjen ekonomike. Aty kontrollohen kursimet si dhe mesataren e reformave në periudhën afatgjatë; kjo e fundit heq dhe problemin e multikolinearitetit.

Ne na intereson të shohim se cilët ndryshore ndikojnë më shumë në rritjen ekonomike pasi në këtë mënyrë mundet të bëjmë dhe rekomandimet e nevojshme për politikbërësit. Rezultatet e tabelës 3 tregojnë se liberalizimi i tregut mbetet serish indikator me më shumë impakt në rritjen ekonomike me një koeficient të barabartë me 1.87 duke qenë statistikisht domethënës në 1%. Nga ana tjetër duket sikur reforma institucionale në financë ka një impakt më të madh sesa reforma në sipërmarrje. Rezultatet e këtij studimi janë të ndryshme nga ato të studimit të bërë nga *Chubrik (2004)* se indikatorët e sipërmarrjes dhe të mirëqeverisjes ndikonin më shumë në rritje ekonomike.

4.2.4 Përzgjedhja e Modelit

Rezultatet e mësipërme tregojnë se vlerësuesit MMG është shumë i ndjeshëm prej ndryshoreve që përzgjidhen për t'u vendosur në model. Për shembull indikator i impaktit të reformave financiare mund të ketë vlerë pozitive në një model dhe negative në një model tjetër, megjithëse në të dy rastet vihet re që ky indikator është domethënës në 1%. Kjo lehtësi në ndryshimin e të dhënave tregon qartë nevojën e testeve të mëtejshme për të përzgjedhur dhe modelin më të mirë.

Një hap i parë do të ishte krahasimi i vlerave të *log likelihood* mes regresioneve të ndryshme. Pritet që në ato raste kur kemi të dhëna për log likelihood më të madhe atëherë modeli shpjegon dhe më mirë të dhënat. Në këtë rast Tabela 1 interpreton dhe më mirë të dhënat për vendet në tranzicion. Por në rast se përdorim këtë metodë atëherë mund të arrijmë në përfundimin e gabuar duke qenë se *log likelihood* mundet të jetë më e lartë sa herë që ne rrisim numrin e parametrave në regresion. Për këtë arsye kjo metodë nuk mundet kurrësi të jetë përfundimtare në përzgjedhjen e modelit më të mirë.

Për këtë arsye përdoret Kriteri i Informimit Bayesian -*Bayesian Information Criterion* (BIC). Ky është kriteri që përdoret për të përzgjedhur modelin më të saktë kur modelet e vlerësimit nuk kanë të njëjtin numër parametrash. Formula e së cilës është:

$$BIC = -2 \ln(L) + k \ln(n)$$

ku n është numri i observimeve, k është numri i parametrave të përfshira në model dhe L është maksimumi i log likelihood. Rezultatet e BIC janë të prezantuara në fund të tabelave të mësipërme dhe në rastet kur vlera e BIC është më e vogël atëherë ai model është më i mirë në vlerësimin e të dhënave. Nga të dhënat duket se modeli në tabelën 3 përfaqëson më mirë interpretimin e të dhënave, ndërsa tabela 2 duket se është më pak informuesja. Në këto rezultate janë bërë dhe vlerësimet kur përdoren regresionet PMG, MG dhe DFE. Tabela 4 nga ana tjetër

tregon rezultatet kur përdoren tre mënyra të ndryshme të të maturit të të dhënave ku mesatarizimi në grup MG, nuk imponon kufizime, PMG imponon kufizime afatgjata, dhe DFE kufizon tërë koeficientet dhe variancat e gabimit të jenë të njëjta. PMG në këtë këndvështrim preferohet ndaj MG sepse ka saktësi më të lartë dhe se nuk ndikohet nga të dhëna jashtë mesatares që mundet të ketë një shtet në një vit të caktuar. Rezultatet e Tabelës 4 tregon se gabimet standard të PMG janë në mënyrë konsistente më të ulëta sesa të modelit MG dhe DFE. Duhet thënë se të dhënat PMG dhe DFE janë statistikisht më domethënëse sesa MG. Duke përdorur testin Hausman sigurohemi që vlerësuesit PMG japin rezultate më konsistente sesa MG. Kufizimet në homogjinitetin afatgjatë nuk mundet të hidhen poshtë as nga testi Hausman që do të thotë se PMG është serish më i mirë sesa vlerësimi MG. Ndaj duhet theksuar vlerësimi i modelit sipas PMG e dhënë në Tabelën9.

Tabla 10: Efekti I Pjesshem I Reformave ne Tregje

Matur me PMG, DFE dhe MG

Panel A			
	PMG	MG	DFE
Koeficient Afatgjate			
Lag Log Inflacion	.05 (.040)	-.36 (.27)	-.08 (.07)
Lag Reforma Tregje	1.87*** (.33)	2.5 (2.13)	1.13*** (.40)
Shpejtesia e Knvergjences	-.29*** (.08)	-.047* (.25)	- .037*** (.01)
Hausman Test	$\chi^2(2) = (b-B)'[(V_b - V_B)^{-1}](b-B)$ $= 8.29$ $Prob > \chi^2 = 0.0159$		

Tabela 11: Efekti I Pjesshem I Reformave ne Tregje Financiare

Matur me PMG, DFE dhe MG

Panel B			
	PMG	MG	DFE
Lag Log Inflacion	-.05* (.03)	-1.19 (1.08)	-.063* (.03)
Lag Reforma Tregje	1.16*** (.16)	3.0* (1.7)	.22*** (.09)
Shpejtesia e Knvergjences	-.037*** (.07)	-.096* (.03)	-.081*** (.014)
Hausman Test	$\chi^2(2) = (b-B)'[(V_b - V_B)^{-1}](b-B)$ $= 6.66$ $Prob > \chi^2 = 0.0358$		

Tabela 12: Efekti I Pjesshem I Reformave ne Siperarrje

Matur me PMG, DFE dhe MG

Panel C			
	PMG	MG	DFE
Long-Run Coefficients			
Lag Log Inflacion	-.025* (.01)	-.02 (.10)	-.06* (.036)
Lag Reforma Tregje	.39*** (.1)	1.46* (.74)	.19* (.10)
Shpejtesia e Knvergjences	-.048*** (.027)	-.051* (.036)	-.077*** (.014)
Hausman Test	$\chi^2(2) = (b-B)'[(V_b - V_B)^{-1}](b-B)$ $= 3.94$ $Prob > \chi^2 = 0.1394$		

4.2.5.Shpejtësia e Konvergjencës

Shpejtësia e konvergjencës në të dhënat e mësipërme luhet nga 2% deri në 4.3%. Pra në çdo vit kemi një ulje me afërsisht 2% në vit të hendekut mes kushteve fillestare dhe nivelit të rritjes ekuilibër “*steady state*” të rritjes ekonomike. Duhet theksuar se këto të dhëna nuk janë shumë larg nga studimet e tjera të bëra mbi rritjen ekonomike. Ndërkohë që nivelet e larta të koeficienteve të konvergjencës kanë të bëjnë me rënien e madhe të prodhimit ekonomik pas rënies së sistemit të centralizuar.

Tabelë 13: Shpejtësia e Konvergjencës⁶.

Barro and Lee	Barro and Sala-i-Martin	Mankiw, Romer and Weil	Sacha and Ėarner	Barbone Zaldueno
0.0286	0.0302	0.0178	.0168	.0248

Temple et al. (2005) tregon se në literaturën e rritjes ekonomike janë dy pyetje kryesore që kanë nevojë për përgjigje përse i përket diferencave të PBB për frymë. Së pari, a është heterogjeniteti e të ardhurave për frymë mes shteteve e përkohshme apo e përhershme? Së dyti, në rast se janë të përhershme a tregon performance heterogjenitet strukturor në rolin që kanë kushtet fillestare në rritjen ekonomike afatgjatë? Studime për vendet e Europës Lindore (DeMelo, 2001) kanë treguar se kushtet fillestare nuk mundet të përdoren më si faktor që ndikon

⁶ (Barbone, 1996)

në arsyet se përse kemi diferenca mes të ardhurave për frymë në Europën Lindore. Ndaj mesa duket ky heterogjenitet strukturor mundet të shpjegohet nga diferenca në nivelin e reformave institucionale, që ndikon më pas dhe në shpejtësinë e konvergjencës.

Ndërkohë mundet të përdoret në regresionet e mësipërme lag e diferencës së PBB/frymë dhe lag i diferencës së reformave mesatare për të matur efektet afatshkurtra në ekonomi. Roli kryesor i këtyre ndryshoreve është kontrolli i korrelacionit mes gabimeve me kalimin e kohës. Në periudhën afatshkurtër impakti i reformave në rritje ekonomike është negative, megjithëse këto ndryshore janë jo-domethënëse statistikisht. Ndërkohë përse i përket stabilitetit makroekonomik të dhënat e mësipërme nuk dalin në një përfundim të qartë. Për shembull të dhënat në tabelën 3 treguan se nivele të larta të inflacionit ka gjasa të kenë një impakt negativ në rritje ekonomike dhe janë domethënëse në 10%. Ndërkohë që vlera e saj ndryshon në modelin e tretë ajo del pozitive dhe jo domethënëse duke treguar që ky variacion i madh i koeficientit e bën jo shumë bindës në impaktin që ka në rritjen ekonomike të vendeve Europës Lindore.

4.2.6. Literatura e Rritjes Ekonomike në Europën Lindore

Nuk duhet harruar se arsyeja që vendet e Europës Lindore filluan reformat e mëdha ishte pikërisht besimi se ato do të sillnin rritje ekonomike dhe më pas nivele të larta të ardhurave të ngjashme me vendet e Europës Perëndimore. Por

diferenca në të ardhura mes vendeve të pasura dhe atyre të varfëra është akoma shumë e habitshme për miliona qytetar që jetojnë në shtete të tilla si Moldavia, Armenia apo dhe Shqipëria ndërkohë që shtete të tjera si Sllovenia apo Hungaria kanë arritur nivele të ardhurash jo shumë larg vendeve të industrializuara. Është gjithashtu po aq e habitshme përse gjatë viteve 1992-2002 PBB për frymë u rrit me 51% në Poloni dhe ra me 63% në Ukrainë.

Njëzet vite pas rënies së Murit të Berlinit Harvrylyshyn (2003, f3) shpjegon se:

“Literatura në rritjen ekonomike të vendeve në tranzicion shpjegon diferencën në rritje ekonomike sipas tre kategorive të mëdha: (i) ndryshoret makroekonomike, si niveli i inflacionit dhe defiçitit buxhetor; (ii) ndryshore që shpjegojnë ndryshimet e bëra në kuadër të reformave strukturore në veçanti liberalizim dhe privatizim dhe (iii) ndryshore të cilat theksojnë rëndësinë e kushteve fillestare të ekonomisë si struktura makroekonomike dhe ndryshimeve strukturore në fillim të tranzicionit dhe luftërave apo konflikteve të brendshme”.

4.2.7. Kushtet Fillestare

Ekonomitë e Europës Lindore filluan tranzicionin nën kushte të ndryshme nga njëra tjetra pavarësisht se në dukje ishin nën të njëjtin regjim ekonomik. Për këtë arsye kërkues të ndryshëm në mes të viteve 1990 filluan të shpjegojnë performancën ekonomike të këtyre vendeve si pasojë e kushteve fillestare si kontribuues të rritjes ekonomike më vonë. Këto kushte fillestare mateshin si:

distancënga Brukseli, rritja ekonomike gjatë komunizmit, burimet natyrore, niveli i industrializimit dhe urbanizimit, të ardhurat për frymë në vitin 1989, inflacioni i kontrolluar, premium i kursit të këmbimit në tregun e zi si dhe vitet e shpenzuara nën regjimin komunist.

Studimi i parë i detajuar mbi impaktin e kushteve fillestare të ekonomisë në rritjen ekonomike e pati de Melo (1997), dhe që më pas u mbështet nga Raporti i Tranzicionit të *BERZH* (2004). Ndërsa *Murell* (2006) shton se rritja ekonomike e vendeve në tranzicion varet nga kushtet fillestare më shumë se gjithë faktorët e tjerë. *Fischer et al.* (2000) për shembull përdor një regresion mes shteteve dhe arrijnë në përfundim se vitet në komunizëm dhe niveli i qytetarëve të shkolluar përcaktonte performancën ekonomike gjatë tranzicionit. *Popov* (2007) nga ana tjetër shton se rritja ekonomike varet nga rritja para tranzicionit.

Por argumentimi se kushtet fillestare do të vazhdonin të përcaktonin ritmet e rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë u hodhën poshtë nga studimi i *de Melo* (1997). Sipas tij megjithëse të rëndësishme kushtet fillestare kanë shumë pak impakt me kalimin e kohës. Për më tepër shtohet se burimet natyrore mundet të kenë efektin e kundërt në ekonomi duke ndikuar në performancën e ekonomisë pasi rezultojnë në sjellje abuzive nga ana e shtetit, korrupsion, dështime të politikave dhe kërkesë më ulët për arsimin të popullatës (*Campos, 2002*).

4.2.8. Stabiliteti Makroekonomik

Vitet e para të tranzicionit sollën riorganizim të thellë të ekonomisë dhe të faktorëve të prodhimit. Rezultati i menjëhershëm ishte rritja e nivelit të çmimeve duke çuar në nivele të larta të inflacionit në vitet e para të tranzicionit. Për shembull në Shqipëri inflacioni arriti deri në 263%, në Rusi 874% dhe në Ukrainë 4784%. Kjo padyshim pati efekt të menjëhershëm në kursimet e qytetarëve dhe në vendimet e tyre në shpenzim. Efekt gjërryese të inflacionit kishin nevojë për masa të menjëhershme dhe *Fischer (1996)* argumenton në studimin e tij për 25 shtete në tranzicion se politika monetare tkurrëse, reforma në politikat monetare, kontrolli i pagave, politika të qarta dhe transparente të kursit të këmbimit, defiçite fiskale të ulëta ishin jetësore për të kontrolluar spiralen e inflacionit. Që atëherë një konsensus i fortë është vendosur në literaturën e vendeve në tranzicion mbi stabilitetin makroekonomik në rritjen ekonomike. Loungani dhe Sheets përdorin analizën në panel për të treguar se pavarësia e Bankës Qendrore është e rëndësishme për të krijuar besueshmëri në ekonomi dhe stabilitet makroekonomik që sjell më pas një mjedis sipërmarrës, investime dhe vitalitet në sektorin privat (*Loungani, 1997*).

4.2.9. Niveli i Reformave

Ky seksion prezanton rezultatet e studimeve të mëparshme rreth rolit të reformave institucioneve në ekonomitë e Europës Lindore. Sipas studimeve të *de Melo*

(2001) reformat institucionale kanë një impakt negativ në fillim por më pas ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike. Faktorë të tjerë si kushtet fillestare të ekonomisë nuk kanë impakt efekt direkt në rritjen ekonomike por në shpejtësinë e reformave të ndërmarra nga qeveritë; *shih Havrylyshyn (2003) dhe Campos (2000)*.

Pavarësisht paralajmërimit mbi kompleksitetin që ekziston mes reformave dhe rritjes ekonomike në vendet e tranzicionit, *Falcetti et al. (2006)* tregon për një marrëdhënie të fortë mes reformave në një periudhë dhe rritjes në periudhën tjetër. Ai përdor të dhëna vjetore mbi të ardhurat për frymë dhe si ndryshore të pavaruara kushtet fillestare të ekonomisë, lag të reformave dhe stabiliteti makroekonomik. Ata justifikojnë përdorimin e lagged të reformave pasi po të përdorin nivelin aktual të reformave do të ketë ndërveprim fals mes tyre.

Studimi i tyre tregon se ka një marrëdhënie pozitive me reformat në një periudhë dhe rritjen ekonomike në periudhën pasardhëse, gjithashtu një rëndësi ka dhe bilanci fiskal, duke theksuar stabilitetin makroekonomik në gjenerimin e rritjes ekonomike. Ky studim ndryshe nga studimet e mëparshme shton dhe tre faktorë të tjerë që mundet të jenë të rëndësishëm në kontributin e rritjes, në këtë model shtohen dhe efektet e çmimit të naftës, duke qenë se disa shtete janë të pasura me burime natyrore. Gjithashtu ata kontrollojnë për presionet që mundet t'i vinë ekonomisë nga kërkesa nga jashtë për ato shtete që janë më të integruara me

ekonominë botërore. Por pavarësisht këtyre faktorëve nuk mundet të hidhet poshtë fakti se reformat institucionale kanë patur efekt në rritjen ekonomike.

Nga ana tjetër në një raport të *BERZH* (2004) tregon se pas disa testesh statistikore reforma institucionale kishte impakt domethënës pavarësisht diferencave në kushtet fillestare dhe ekspozimit ndaj tregjeve ndërkombëtare. Një studim i ngjashëm u bë në vitin 2008 dhe përfundimi ishte akoma dhe më i rëndësishëm se ai i vitit 2004. Radulescu dhe Barlow nga ana tjetër mbeten skeptikë për këto përfundime. Sipas tyre vetëm inflacioni është domethënës dhe nuk ka evidencë që në periudhën afatgjatë liberalizmi i tregut ka impakt pozitiv në rritje. Sipas tyre liberalizimi në fillim ul rritjen ekonomike dhe më pas vërehet rritje por kjo nuk është domethënës afatgjatë (*Radulescu, 2002*). Por kjo është në kontradiktë më *Havrylyshyn (2003)* i cili del në përfundimin se liberalizimi ekonomik është dhe më i rëndësishëm se mjedisi institucional, megjithëse roli i kësaj të fundit rritet me kohën. Lawson dhe Wang arrijnë në përfundim se liberalizimi i tregut ka një efekt pozitiv në rritje ekonomike por reforma në sektorin financiar nuk ka efekt fare (*Lawson, 2004*).

4.3. Shpejtësia e Reformave

Terapia e shokut përfshin programe radikale të reformave të cilat kryhen në një periudhë të shkurtër kohe. Xhefri Saks (*Jeffrey Sachs, 1994, f. 268*), e karakterizon terapinë e shokut si një program reformash që do të instalojë

kapitalizmin në mënyrë të shpejtë dhe të gjithanshme”. Buck, Nolan, Filatotchev and Wright (2000, p. 379) nga ana tjetër thonë se terapia e shokut është një privatizim i shpejtë i industrisë, liberalizim i çmimeve dhe i reformave politike për demokratizim në të njëjtën kohë. Duke u bazuar në këto përkufizime si dhe në shumë artikuj të tjerë duket që e përbashkëta në terapinë e shokut është shpejtësia dhe shtrirja e reformave të njëkohshme. Pra në rast se kryhen disa reforma të shpejta, por i limiton ato vetëm në disa sektorë atëherë ato nuk janë pjesë e “terapisë së shokut”. Kjo më pas shtyn pikëpyetjen se çdo të thotë reforma e shpejtë, sa është numri i sektorëve që duhet të preken që të quhet terapi shoku?

Në fakt një shtet i cili kalon terapinë e shokut si proces i transformimit nga një shtet komunist në shtet kapitalist ka pesë faza të politikave ekonomike: stabilizim makroekonomik, liberalizimin e ndërmarrjeve, liberalizimin e tregtisë, krijimi i institucioneve të përshtatshme për ekonominë e tregut, si dhe krijimi i mbështetjes së asistencës sociale, duke qenë se në periudhën afatshkurtër ekonomia do të preket nga rritja e papunësisë, çmime të larta dhe normë e lartë e kredisë *Fischer* (1993).

Reformat graduale nga ana tjetër janë e kundërta e asaj çfarë sugjerohet nga terapia e shokut. Në këtë kuptim kjo qasje e reformave kërkon të reformojë më pak industri dhe me hapa të ngadaltë e të sigurte, ku sipas studimeve ato shtete që

ndoqën reformat graduale iu deshën katër deri në katërmëdhjetë vjet për të përfunduar reformat *Popov (2000)*.

Ndërkohë që duket sikur literatura mbi Europën lindore ka një lloj konsensusi se reformave institucionale ka një efekt pozitiv në rritjen ekonomike nuk mundet të thuhet e njëjta gjë për shpejtësinë e reformave. Në fillim të tranzicionit të gjithë shtetet post komuniste ishin mbështetës të reformave dhe liberalizimit ekonomi. Kështu që pyetja me të drejtë shtrohej se përse duhej të shtyhej në kohë diçka që dukej sikur ishte me përfitim? Dy shkolla mendimi kanë dalë në interpretimin ose në dhënien e përgjigjes mbi këtë çështje: gradualistët që theksojnë rëndësinë e reformave të sekuençave, duke qenë se është e nevojshme të bësh disa reforma para se të bësh të tjerat, si për shembull të kesh një infrastruktur ligjore para se të fillosh privatizimet. Nga ana tjetër ata që mbështesnin terapinë e shokut sugjeronin se në mënyrë që të marrësh përfitimet e një tregu të lirë këto ekonomi duhej të bënin reforma të plota.

De Melo (1997) gjen se reformat e shpejta kanë një efekt pozitiv, *Murrell et al. (1999)* tregon se shpejtësia e reformave nuk ka efekt fare në rritjen ekonomike, *Staher (2003)* arrin në përfundimin se reformuesit e parë ka gjasa të kenë përfitime më të mëdha në përudhen afatgjatë. Por ky studim duket sikur i vjen në ndihmë të dy shkollave të mendimit pasi thotë se reformat e shpejta janë me

benefit por nga ana tjetër reformat e ngadalta nuk janë negative, përkundrazi pozitive nëse përdoret sekuenca saktë.

Stiglitz (2004) është te studimet e para që teston nëse privatizimi i shpejtë pati impakt në rritjen ekonomike gjatë dekadës së parë. Ai del në përfundimin se terapia e shokut nuk është e saktë dhe nuk mori parasysh rëndësinë e institucioneve dhe të shtetit të së drejtës. Për këtë arsye privatizimi i shpejt çoi “në zhvatje të aseteve dhe jo në krijim të pasurisë”. Gradualistët argumentojnë se liberalizimi i tregut duhej të kishte lejuar për ndërtimin e institucioneve ligjore dhe financiare për të luftuar fuqinë e monopoleve të reja dhe korrupsionit. Staher tregon se reforma jo të mirësikronizuara janë me efekt negative në rritje si në periudhën afatgjatë ashtu dhe afatshkurtër. Paketa reformash që përfshijnë privatizime të mëdha pa privatizime të vogla, hapje të tregjeve pa reformat shoqëruese, liberalizim bankar pa ristrukturim të firmave çon në rritje ekonomike më të ulët *Staehr (2003)*.

Popov (2000) bën një përmbledhje më të detajuar të studimeve mbi Europën Lindore ku shkruan se si terapia e shokut si gradualizmi nuk pati ndonjë efekt në rritjen ekonomike ndaj i gjithë debati për shpejtësinë e reformave është i panevojshëm. Në studimet e bëra në 30 shtete post komuniste vihej re se rritja ekonomike nuk ndikohej nga ndryshore të tilla si inflacioni, shpejtësia e reformave. Në fakt e vetmja ndryshore që ndikonte në rritje ekonomike ishin

kushtet fillestare të ekonomisë si: numri i viteve nën komunizëm, urbanizimi, struktura e industrializimit të ekonomisë etj. Sipas Popov kushtet fillestare ndikojnë në 60% të arsyeve të luhatjeve makroekonomike, dhe në rast se shtohet dhe ekonomia e zezë, ku përdor të ardhurat e qeverisë si indikator i përafërt, atëherë ajo rritet në 75%.

Studime të fundit tregojnë se zgjedhja mes terapisë së shokut apo gradualizmit varet nga regjimi ekonomik që shtetet kanë. Kështu përfundimet janë se terapia e shokut do të ishte më e përshtatshme për vende që kanë një ekonomi mikes si vendet e Amerikës Latine. Ndërkohë që shtete socialiste si Kina kanë qënë të suksesshme me një qasje të reformave gradualist. Dështimi i terapisë së shokut e cila implementohet në vendet socialiste mundet të shihet te rasti i Rusisë.

4.4. MODELI II

Mbështetja për Ekonominë e Tregut dhe Fazat e Reformave

Pyetja Kerkimore II

Reformat neoliberales synojnë avancimin e tregut në ekonomi nëpërmjet privatizimeve, deregullimit të tregut dhe tërheqje të shtetit në tërësi nga ndërhyrjet për të garantuar rritje ekonomike të lartë. Ndërkohë në rast se vërtetohet një ndryshim të perceptimit të publikut për rolin e shtetit kjo do të justifikonte dhe një kthim pas të politikave neoliberales dhe ngadalësim të reformave institucionale. Por teoritë thonë se asensori social, pra mundësia për të ngjitur shkallët sociale në një shoqëri, do të inkurajonte pozitivisht individët që jetojnë në Europën Lindore që të mbështesnin qeverinë për të ndërmarrë reforma të nevojshme për të garantuar rritje ekonomike.


Hipoteza II

Ashensori social është faktor i rëndësishëm në mbështetje për reforma neoliberales në vendet e Europës Lindore.

Qëndrimet e publikut ndaj ekonomisë së tregut, tregjeve financiare dhe rolin e shtetit në mund ta masim në kohë dhe të shohim sesi kriza financiare ka ndikuar në perceptimet e tyre për reformat institucionale. Të dhënat të cilat analizohen në

këtë punim përbehen nga 29.000 pyetësor të vitit 2006 dhe nga 29.000 pyetësor të zhvilluara në vitin 2010. Duke qenë se ato janë në distancë kohore dy vjeçare para dhe pas krizës financiare të vitit 2008 ne mundet të masim dhe të shohim sesi goditjet nga jashtë në ekonomi mund të sjellin më pas dhe efekt në mbështetje dhe preferenca të ndryshme të rolit të shtetit në ekonomi.

Duke qenë se procesi I tranzicionit ka patur qëllim kryesor promovimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut këto pyetësor na ndihmojnë të shohim sesa e suksesshme ka qenë kjo politikë për të bindur qytetarët mbi meritat e këtij sistemi ekonomik dhe për të parë gjithashtu si qëndrojnë shqiptarët në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Duket qartë që me fillimin e krizës ekonomike mbështetja për ekonominë e tregut është në rënie, jo vetëm në Europën Lindore por edhe në Shqipëri. Më pak se gjysma mbështetin në vitin 2010 ekonominë e tregut mbi çdo lloj forme alternative të organizimit të ekonomisë. Ndërkohë ka një rritje të ndjeshme të përkrahjes së rolit më të madh të shtetit, pasi ekonomia e kontrolluar shihet si një alternativë më e pëlqyeshme sesa në vitin 2006.




Grafik13: Preferenca për Ekonominë e Tregut. Krahësim mes Shqipërisë dhe Europës Lindore 2006 dhe 2010

Ashtu si në Europën Lindore dhe në Shqipëri kriza ka ndikuar negativisht në preferencat e publikut për meritat e ekonomisë së tregut. Pavarësisht se në Shqipëri mbështetja për ekonominë e tregut ishte më e lartë se mesatarja e Europës Lindore sërisht kriza e uli mbështetjen nga 66% në vitin 2006 në 44% në vitin 2010. E njëjta gjë vihet re dhe në shtetet e tjera.

Një ndër pyetjet e drejtuara publikut Shqiptar në vitin 2006 kishte të bënte me faktin nëse mendonin se gjërat në atë vit ishin më mirë se në vitin 1989? Sipas këtyre të dhënave pothuajse 70% e publikut mendonte se gjërat ishin mirë ose shumë më mirë, krahasuar me të dhënat për të gjithë vendet e Europës Lindore ku vetëm 30% e të pyeturave mendonin se gjërat ishin më mirë ose shumë më mirë. Ndërkohë që pamë perceptimet e qytetarëve përsa i përket pabarazisë, mbështetjes për privatizime apo për reforma tjera institucionale duhet theksuar se sfera në të cilën neoliberalët sulmohen më shumë është qasja e tyre për rolin e shtetit në shërbime dhe në avancimin e çështjeve sociale.

Siç dhe është theksuar në kapitullin dy neoliberalët besojnë në lirinë e individit. Por kritikët kritikojnë neoliberalët se se individit duhet të jetë gjithashtu përgjegjës për mirëqenien e tij. Krikika vazhdon se neoliberalizmi mundet të shihet si një rikthim në format primitive të individualizmit. Ajo reflekton pushtetin e elitave që mbështetet nga Darwinizmi Social, një interpretim popullor në shekullin e 19-të, që është ripaketuar si neoliberalism (darwinizëm ekonomik). Kjo e fundit shihet si një aplikim i dorës së padukshme që promovon njëkohësisht dhe mirëqenie ekonomike dhe sociale. Kjo vjen për shkak të konkurrencës në ekonomi ku do të mbijetojnë më të shëndetshmit që për neoliberalët kjo është drejtësi.



Grafik 14: Shqipëria 2006: A keni besim në marrëdhënie me njerëzit?

Në këtë pikë darvinizmi social do të tregonte që besimi mes njeri tjetrit duhet të ishte në zhdukje në vendet e Europës Lindore me kalimin e kohës. Por praktikisht ajo që vihet re është se nga viti 2006 deri në 2010 qytetarët shqiptar kanë treguar më tepër besim te njeri tjetri e për rrjedhojë një ndjenjë pozitive në shkëmbim mallrash, në marrëveshje biznesi etj. Përsa i përket besimit te njeri tjetri vihet re një ndarje mes besimit në tërësi të qytetarëve mes njeri tjetrit. Një ndër to infrastruktura sociale është shumë e rëndësishme për të arritur një ekonomi mirë funksionuese. Është për t'u çuditur sesi 65% e qytetarëve që ishin mbi 40 vjeç në 2006 besonin më shumë njerëzve në kohën e komunizmit sesa në periudhën e

demokracisë. Afërsisht në të njëjtat nivele shfaqen të dhënat dhe për Europën Lindore.

4.5.1. Rezultate Modeli II

Ndërkohë vihet re se qytetarët shqiptarë besonin më pak njërit tjetrit sesa vendet e tjera të Europës Lindore në vitin 2006. Në këtë vakum normalisht qytetarët duhen përfaqësuar nga institucionet përfaqësues për të mbrojtur interesat e tyre. Të dhënat tregojnë që në këtë periudhë 73% e shqiptarëve nuk u besonin partive politike dhe vetëm 13% kishin besim te to. Ndërkohë në vendet e tjera të Europës Lindore mesatarisht 53% e popullsisë nuk kishte besim te partitë politike.

Ne tersi sa i besoni njerëzit?		
	2006	2010
Mosbesim i plotë	36%	4%
Mosbesim i ulët	18%	12%
Indiferent	16%	34%
Besim i pakët	22%	39%
Besim i plotë	6%	4%
e vështirë ta them	1%	6%

Të dhënat e mëposhtme tregojnë se probabiliteti për të përzgjedhur opsionin e tretë, më shumë ndërhyrje të shtetit për të ulur varfërinë në ekonomi, do të ulët në rast se qytetarët mendojnë se e ardhmja e fëmijëve të tyre është pozitive apo mundësia për të ecur në jetë do të rritet në të ardhmen. Kjo justifikon atë që teoria e njeh si mundësia e ashensorit social. Gjithashtu ndryshe nga të dhënat e

mëparshme se të varfrit nuk do të kërkonin një rol më të madh të shtetit në ulje të varfërisë nuk verifikohet nga të dhënat e mësipërme. Në tërësi vihet re se në rast se shpenzimet mujore janë të larta, pra që përkthehet në të ardhura më të larta e të intervistuarave, atëherë dhe kërkesa për ndërhyje të shtetit ulet ndjeshëm. Por nga ana tjetër ajo që vihet re është se rritja e besimit të partitë politike përkthehet gjithashtu dhe në një pranim të pohimit se kjo ndërhyrje e shtetit është e justifikueshme. Kjo gjithashtu vihet re dhe për rastin kur gjendja shëndetësore e të intervistuarave nuk është e mirë apo kur të intervistuarit janë të moshuar.

Ne presim që probabiliteti që të pyeturit të mbështesin përgjigjen 1, që shteti nuk duhet të ndërhyjë për të ulur varfërinë në ekonomi, do të rritet në rast se ata mendojnë se e ardhmja e fëmijëve do të jetë më pozitive, pra në rast se nga 1-7 ata zgjedhin përgjigjen 7 rritet dhe probabiliteti që të zgjedhin përgjigjen 1, të mos ketë ndërhyje të shtetit. Nga ana tjetër, me rritjen e moshës dhe me përkeqësimin e kushteve shëndetësore, qytetarët ulin mbështetjen për pohimin se shteti nuk duhet të ndërhyjë në ekonomi dhe e rrisin atë kur pohimi është se shteti duhet të ndërhyjë për të ulur pabarazinë në vend. E rëndësishme mbetet dhe fakti që besimi në partitë politike, pra institucionet përfaqësuese, kanë gjithashtu rëndësi në mbështetjen ose jo të ndërhyrjes së shtetit për të ulur pabarazinë.

Në tërsi ne presim që eksperiencia e qytetarëve të ketë qenë e ndryshme si në komunizëm ashtu dhe gjatë periudhës së tranzicionit. Ndaj dhe faktorët që

ndikojnë në mbështetje ose jo të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi nuk duhet të jenë të njëjta. Për shembull në Shqipëri në rast se qytetarët kanë patur eksperiencë pozitive gjatë tranzicionit kërkojnë më pak ndërhyrje të shtetit, nga ana tjetër besim të qytetarët e tjerë, pra infrastruktura sociale e cila të ndihmon në kohë të vështirë, është gjithashtu me efekt negative në ndërhyrjen e shtetit. Nga ana tjetër në rast se qytetarët besojnë se partitë politike janë të besueshme, pra ato do të bëjnë ato që thonë në rast se vinë në pushtet, atëherë qytetarët janë akoma të gatshëm që të delegojnë këtë pushtet te to për të ulur varfërinë në vend.

Është e rëndësishme të theksohet se ashtu sikundër dhe teoria e parashikon mundësia për të ecur në jetë, pra ashensori social, ka të njëjtin efekt në tërë vendet e Ballkanit, përjashtuar Maqedoninë. Faktorët e tjerë si mosha e të pyeturit, punësimi në 12 muajt e fundit, perceptimi për të ardhmen e fëmijëve duket se nuk kanë rëndësi për të përcaktuar ndërhyrjen e shtetit në ekonomi. Por vlen të theksohet se tërë vendet e Ballkanit, janë të gatshme të lejojnë që pabarazia të adresohet nga shteti në rast se partitë politike janë të besueshme për ta.

*Tabela 14: Regresioni Ordered Logistic
Ndërhyrja E Shtetit Për Barazi Në Ekonomi*

Perceptimi për të ardhmen e fëmijëve	-0.022 (2.48)*
Mundësia për të ecur në jetë (mobiliteti)	-0.131 (14.73)**
Besimi te qytetarët e tjerë	-0.096 (9.39)**
Gjendja shëndetësore në të cilën ndodhen	0.041 (2.60)**
Mosha e të pyeturit	0.001 (0.55)
Edukimi	-0.105 (8.10)**
Punësimi në 12 muajt e fundit	-0.161 (5.25)**
Besimi në Partitë Politike	1.022 (46.78)**
exp_ae	-0.000 (2.81)**
_cons	-1.823 (15.65)**
_cons	0.593 (5.16)**
<i>N</i>	27,892
	LR chi2(8)=3154.29
	Prob > chi2
	Pseudo R2=0.0761

Tabela 15: Mbështetja për ndërhyrje shtetërore në vendet Ballkanike

	Shqiperia	Bosnja	Maqedonia	Serbia	Mal i Zi	Bullgaria
<i>Perceptimi për të ardhmen e fëmijëve</i>	.017	-.06	-.061	.07	.02	-.12***
<i>Mundësia për të ecur në jetë (mobiliteti)</i>	-.215***	-.15	-.037	-.16**	-.15***	-.09*
<i>Besimi te qytetarët e tjerë</i>	-.20**	-.149**	-.02	-.12**	-.10	-.07
<i>Gjendja shëndetësore në të cilën ndodhen</i>	.13	.01	.44**	.05	.13	-.00
<i>Mosha e të pyeturit</i>	.00	-.00	-.00	.00	.00	.00
<i>Edukimi</i>	-.052	-.04	-.162**	.00	.05	-.21*
<i>Punësimi në 12 muajt e fundit</i>	-.00	.677***	-.11	.09	-.05	.11
<i>Besimi në Partitë Politike</i>	1.38**	1.68***	1.23***	1.2***	.92***	1.20**
<i>Niveli Aktual i Shpenzimeve Mujore</i>	-.00	-.00	-.001	-.00*	-.00	-.00***

Këtë model e testojmë nëpërmjet efektit marxhinal të dy/dx . Siç shihet nga të dhënat probabiliteti që të mbështetësh një ndërhyrje më të madhe të shtetit për të ulur varfërinë rritet me afërsisht 2.2% në rast se kemi besim të partitë politike në vend. Nga ana tjetër efekti i mobilitetit social si dhe besimi të qytetarët është gjithashtu i rëndësishëm por efekti është më i vogël se 1% për të dyja rastet.

Tabela 16: Cilët faktorë ndihmojnë të ecësh në jetë

	Shqipëri	Maqedoni	Serbi	Kosoë	Itali	Gjermani
<i>Përpyjekja dhe puna</i>	44%	32%	33%	46%	40%	56%
<i>Inteligjenca dhe aftësitë</i>	20%	12%	11%	10%	31%	30%
<i>Lidhjet Politike</i>	24%	48%	49%	32%	25%	8%
<i>Thyerja e Ligjeve</i>	4%	7%	11%	7%	3%	1%

Çfarë arsyes do të zgjidhnin shqiptarët alternativën e parë, pra jo ndërhyrje të shtetit: .

Tabela 17: Vlerësimi marxhinal pra outcome=1 (jo ndërhyrje e shtetit)

Marginal effects after ologit y = Pr(q305_1==1) (predict, outcome (1)) = .01635739	
	Shqiperia
Perceptimi për të ardhmen e fëmijëve	-.00
Mundësia për të ecur në jetë (mobiliteti)	.001**
Besimi te qytetarët e tjerë	.003***
Gjendja shëndetësore në të cilën ndodhen	-.001
Mosha e të pyeturit	-.00
Edukimi	-.052
Punësimi në 12 muajt e fundit	.00
Besimi në Partitë Politike	. -.022***
Niveli Aktual i Shpenzimeve Mujore	-.00

Përsa i përket përzgjedhjes së opsionit 3, pra një ndërhyrje e madhe e shtetit për të ulur varfërinë në Shqipëri, vihet re se në ato raste kur besohen partitë politike mbështetja ose probabiliteti për të zgjedhur këtë opsion rritet me afërsisht 25% ndërkohë që ulet me 2% në rast se qytetarët kanë patur mobilitet social dhe me 4% në rast se i besojnë qytetarëve të tjerë.

Tabela 18: Vlerësimi marxhinal pra outcome=3 (ndërhyrje e shtetit)

Marginal effects after ologit	
y = Pr(q305_1==1) (predict, outcome (1))	
= .01635739	
Shqiperia	Dy/dx
Perceptimi për të ardhmen e fëmijëve	.01
Mundësia për të ecur në jetë (mobiliteti)	-.02**
Besimi te qytetarët e tjerë	-.038***
Gjendja shëndetësore në të cilën ndodhen	.022
Mosha e të pyeturit	.00
Edukimi	-.008
Punësimi në 12 muajt e fundit	-.002
Besimi në Partitë Politike	.25***
Niveli Aktual i Shpenzimeve Mujore	-.00

4.5.2.Debati Shteti apo tregu në uljen e varfërisë dhe rritja ekonomike

Varfëria është gjendja në të cilën mungon një sasi e caktuar jetike e pasurisë materiale ose të hollave. Varfëria absolute apo skamja i referohet mungesës së nevojave themelore të njeriut, të cilat zakonisht përfshijnë ushqimin, ujin, higjienën, veshjen, strehimin, kujdesin shëndetësor dhe arsimimin. Varfëria relative përkufizohet si pabarazi ekonomike në vende apo në shoqëri në të cilën jetojnë njerëzit. Të dhënat e Bankës Botërore tregojnë se në botë sot jetojnë 1.1 miliard njerëz nën nivelin e pranuar si varfëri ekstreme prej 1.25\$ në ditë. Ndërkohë që Sfida e Mijëvjeçarit është drejt fundit të saj, një përpjekje tjetër ndërkombëtare po risjell në vëmendje rëndësinë e uljes së nivelit të varfërisë ekstreme me 1 miliard njerëz deri në 2030. Sfida e Mijëvjeçarit, e cila përfundon në 2015, ishte një marrëveshje mes liderëve të shteteve në mbarë botën për të rënë

dakort në disa objektiva të përbashkëta për të ulur varfërinë ekstreme, edukim fillor universal, të mundësonin barazinë gjinore, të fuqizonin gratë etj.

Sido që të jetë objektivat e rëna dakort në këtë marrëveshje dhe masat e ndërmarra në kuadër të saj kanë patur një efekt të vogël në uljen e varfërisë krahasuar me rolin e tregjeve të lira që mundësuan rritje ekonomike duke u përkthyer më pas në ulje të varfërisë. Me hyrjen në fuqi të politikave neoliberale në Europën Lindore, Amerikë Latinë si dhe Azi u mundësua një rritje ekonomike rreth 2 për qind më e lartë se më parë. Në fakt rritja ekonomike gjatë viteve 1960-2000 në vendet në zhvillimin ishte mesatarisht 4.3% në vit, ndërkohë që në vitet 2000-10 ishte 6%, dhe shumë studime tregojnë se rritja ekonomike kontribuon me $\frac{3}{4}$ në uljen e varfërisë. Kështu shembulli klasik merret Kina ku 680 milion njerëz dolën nga kthetrat e varfërisë gjatë 1981-2010 dhe varfëria ekstreme ra nga 84% në 1980 në 10% në 2013.

Por vetëm rritja ekonomike nuk mjafton për të ulur nivelet e varfërisë. Të dhënat tregojnë se ato shtete që kanë më pak pabarazi mundet të ulin dhe varfërinë më shpejt. Ravallion (2013) tregon se në qoftë se ekonomia rritet me 1% në vendet me pabarazi të madhe atëherë varfëria ulet me vetëm 0.6% krahasuar me 4.3% në vendet që janë më të barabarta. Pabarazia e madhe ka kosto jo vetëm për vendet në zhvillim por është shndërruar në një shqetësim dhe për vendet e zhvilluara si Shtete e Bashkuara të Amerikës. Në një shkrim të titulluar “Kosto e Pabarazisë”


Xhozef Stigliz shkruan se pabarazia çon në rritje ekonomike më të ngadaltë dhe në më pak efikasitet. Mungesa e mundësive do të thotë se asetë më të rëndësishëm në ekonomi, njerëzit, nuk përdoren maksimalisht. Shumica e njerëzve që janë të varfër nuk po shfrytëzojnë potencialet e tyre pasi të pasurit në shoqëri duan më pas shërbime publike dhe nga frika se qeveria përdor politikën fiskale për rishpërndarje do të përdorin fuqinë e tyre politike për të ulur taksat dhe shpenzimet qeveritare.

Të dhënat e marra nga pyetësi i Life in Transition 2010, tregojnë se 64% e popullsisë është dakort ose plotësisht dakort për një adresim të pabarazisë në shoqëri. Por ajo që duhet theksuar ndoshta është fakti se Shqipëria ka mesataren më të ulët në rajon përse i përket mbështetjes për adresim të pabarazisë mes të varfërve dhe të pasurve. Kështu për shembull 86% e qytetarëve Serbë janë dakort ose plotësisht dakort me uljen e pabarazisë, e njëjta gjë ndodh dhe në Maqedoni 85% apo Kroaci 78%. Duhet theksuar se kjo ndoshta ka ardhur dhe nga kriza ekonomike që kaluan këto shtete gjatë vitit 2009. Tabela më poshtë tregon pikërisht rënien ekonomike të tyre gjatë kësaj periudhë që më pas reflektohet në një mbështetje më të madhe për ulje të pabarazisë në vend.

TABELA 19: Sa dakort jeni me pohimin e mëposhtëm:

Pabarazia mes të pasurve dhe të varfërve duhet ulur:					
Përgjigja %	Shqipëri	Bosnjë	Kroacia	Maqedonia	Serbia
Nuk e di	3.51	4.14	4.47	0.75	1.65
Plotësisht Kundra	3.03	2.76	4.27	2.52	2.90
Kundra	9.57	7.54	3.38	2.33	3.16
Indiferent	20.66	17.39	9.84	9.24	6.98
Dakort	36.78	40.48	30.22	49.16	42.66
Plotësisht Dakort	26.45	27.69	47.81	36.01	42.66

Burimi: LiT 2010



Grafik15: Rritja Ekonomike 2009. Burimi: Banka Botërore

Po t'i kthehemi sërish statistikave, nga viti 2002 deri në vitin 2008 varfëria në vend u ul në mënyrë konstante, duke treguar se rritja ekonomike pavarësisht se nuk u përkthye në ulje të nivelit të papunësisë, arriti të heqë shumë qytetarë nga varfëria absolute. Bazuar në të dhënat e vrojtimeve të INSTAT-it, Bankës

Botërore dhe UNDP-së, rezulton se në 2008, rreth 12.4% e popullsisë jetonte në varfëri absolute (rreth 373 137 persona), nga 25.4% në vitin 2002 (rreth 813 196 persona). Atëherë argumenti të shtyn të besosh se qeveria apo institucionet publike duhet të bëjnë çmos që të garantojnë rritje ekonomike dhe jo të përqendrohen në politika që çojnë në uljen e pabarazisë, siç mund të jetë politika e re e taksës progresive, e cila u argumentua krejtësisht për arsye etike e morale dhe jo në funksion të efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë sonë. Por nga ana tjetër sic dhe pamë më sipër ekonomistë si Stiglitz thonë se pabarazia në ekonomi ngadalëson ritmet e rritjes ekonomike apo se vendet që kanë më pak pabarazi mundet të ulin dhe varfërinë më shpejt.

Ndaj dhe pikëpyetja se Ravellion (2013, f. 20) përqendrohet se cili aspekt i pabarazisë ka rëndësi. Argumenti teorik bazuar në dështimet e tregut të kreditimit tregojnë për rëndësinë e pabarazisë në asete dhe jo në të ardhura. Sipas këtij studimi tregohet se pabarazia në pasuri(asete) ka më shumë impakt në rritje ekonomike dhe sipas *BERZH* në vitin 2010 Shqipëria pati një rritje të pabarazisë në asete, ndryshe nga shumë shtete të tjera në tranzicion duke ndikuar negativisht në varfëri. Sipas *BERZH* kjo pabarazi përkthehet më pas në pabarazi mundësish për shumë familje të varfra. Por pyetja që shtrohet është se përse është rritur varfëria në Shqipëri në një periudhë kur kemi patur rritje ekonomike si ajo e viteve 2008-2012? *BERZH* argumenton se remitancat kanë qenë një ndër

kontribuesit kryesor të uljes së pabarazisë në vendet e Europës Lindore dhe për këtë arsye kanë ndikuar direkt në uljen e varfërisë në vend. Sipas Bankës Botërore niveli remitancave drejt vendeve të varfra do të rriten me 8% në vit duke theksuar trendin e kundërt më të Shqipërisë ku dërgesat e emigrantëve kanë qënë në rënie konstante gjatë 5 viteve të fundit duke justifikuar rritjen e varfërisë në të njëjtën periudhë.

Në nivelin makro niveli i lartë i remtancave ka mundësuar financimin me valutë pothuajse gjysmën e deficitit tregtar. Por në nivelin mikro remitancat ndihmuan në uljen e varfërisë në vend duke bërë diferencën kryesore mes familjeve të varfëria dhe jo të varfra sipas DeSoto (2002). Zakonisht këto para përdoren si një asistencë për të siguruar ushqim, veshje apo përmirësim të kushteve të jetesës. Por vetëm një pjesë e vogël e dërgesave të emigrantëve përdoret për investim në edukim apo në aktivitet ekonomik duke treguar qartë se remitanca kanë ndikuar direkt në uljen e varfërisë por nuk kanë ndikuar në zhvillim të qëndrueshëm të vendit dhe në krijim të vendeve të punës. Ndaj në kushtet ku ndodhet ekonomia Shqiptare bëhen shumë të rëndësishme reformat ekonomike si instrument që qeveritë mundet të përdorin për t'i ardhur në ndihmë shtresave të varfra, por vetëm në rast se kushtet janë të përshtatëshme për ta për të përfituar, pasi çdo reforme pro tregjeve duhet të jenë të qëndrueshme. Në rast se ato nuk sjellin përfitim për shumicën e popullatës atëherë ato nuk do të kenë mbështetjen e saj.

Ndër të tjera kriza ekonomike botërore ka patur efektin e saj dhe në ekonominë tonë. Sipas INSTAT-it, nga viti 2008 deri në 2012, varfëria në vend është rritur sërish me 28 896 persona. Por ashtu sikundër dhe para 40 vitesh, vendimmarrësit sërish besojnë se pabarazia dhe varfëria janë çështje dhe problematika etike e morale dhe nuk duhet interpretim dhe zgjidhje nga ekonomistët. Sipas studimeve të shumta ndërkombëtare, rritja ekonomike është faktori kryesor që çon në uljen e varfërisë dhe më pas në kualifikim të burimeve njerëzore dhe këta të fundit sërish në rritje ekonomike. Politikisht, zgjedhjet e fundit treguan se shqiptarët duan të luftojnë pabarazinë në ekonominë e tyre. Por statistikat tregojnë se të pasurit, ata që fitojnë më shumë se 1000 euro në muaj, në vend janë rreth 15 mijë persona nga 440 mijë të punësuar. Për këtë arsye duket e vështirë të mendohet se pabarazia dhe varfëria do të luftohet me rritje të taksave. Synimi i politikave qeveritare duhet të jetë vetëm rritja ekonomike dhe rikthimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë sonë në rajon për të ulur varfërinë dhe për të mos qenë më të varfrit në Europë. Në rast se këto reforma institucionale të kombinuara me zhvillim të kapitalit njerëzor, me përfshirjen në ekonomi të gjithë qytetarëve e pa diskriminim do të mundësojnë një rritje ekonomike më të lartë se ato që kemi parë deri tani atëherë ne do të presim ulje të mëtejshme të varfërisë në vend. Politikat rishpërndarëse nuk do të mund ta arrijnë atë.

4.5.3. Mbështetja për Ekonominë e Tregut dhe Fazat e Reformave

Mbështetja publike për ekonominë e tregut janë shumë të rëndësishme për të lejuar më pas reforma të mëtejshme transformuese në vendet e Europës Lindore. Uilliamson (1994) identifikon mbështetjen publike si një ndër tre faktorët kryesor për të patur reformat të suksesshme. Nga ana tjetër shihet se megjithëse jo një parakusht i mjaftueshëm mbështetja publike rrit shanset për të patur reforma të arritshme dhe të suksesshme. Në fakt shumë publikime teorike tregojnë se ndryshore të tilla si niveli i papunësisë apo të ardhurat për frymë mundet të shpjegojnë arsyen e mbështetjes publike për reforma Rodrik (1996), Drazen (2000) dhe Roland (2002).

Një tjetër ide e mbështetur nga disa ekonomistë është se në fazat e para të zhvillimit liberalizimi i tregut duhet të vi përpara demokratizimit të vendit. Një këndvështrim që mbështetet nga reforma kaotike e ndodhur në Europën Lindore kur u ndërmorrën menjëherë liberalizim politik dhe ekonomik (*Stiglitz, 2006*). Disa të tjerë tregojnë sesi kriza ekonomike të vazhdueshme, sidomos në Amerikën Latine, nuk mundet të zgjidhen nga qeverisje demokratike, të cilat mund të jenë penguese kur duhet të ndërmerren reforma jo popullore. Disa autorë të tjerë sugjerojnë se dëshira për liri politike dhe institucione demokratike vinë vetëm atëherë kur shtetet kanë arritur nivele të caktuara të komfortit material dhe të lirisë së tregut (*Miller et al., 1996*). Ndaj, jo vetëm që është më praktike të shtyhet

demokracia deri sa të kemi liri të tregut por këto masa janë në përputhje dhe me preferencat e publikut.

Nga ana tjetër Grosjean përdor të dhënat për Europën Lindore dhe gjen se ndërtimi i institucioneve demokratike mundet të funksionojë si një ingredient që favorizon liberalizmin e tregut dhe nga ana tjetër liri e hershme e tregjeve nuk garanton më vonë mbështetje për demokracinë. Kjo në fakt është në kundërshtim me këndvështrimin se kërkesa për më shumë demokraci vjen kur ne kemi ndërtuar kapitalizëm që mirë funksionon (*Grosjean, 2011*). Ky studim del në përfundimin se demokratizimi i vendit shndërrohet në një kusht të domosdoshëm për mbështetje të mëtejshme për liri ekonomike. Por kjo nuk kundërshton faktin se reformat për liri ekonomike komplikohen më tej kur kemi demokraci.

Një shpjegim i mundshëm për marrëdhënien pozitive mes demokracisë dhe mbështetjes për reformat e tregut jepet nga Acemoglu dhe Robinson (2007). Sipas tyre më shumë të drejta në demokraci do të thotë një besim më të madh se në të ardhmen qeveria do të çojë në rishpërndarje të pasurisë duke sjellë dhe mbështetje ndaj reformave liberalizuese. Sipas tyre është pabarazia politike, dhe jo detyrimisht pabarazia ekonomike që përcakton dhe sjelljen afatgjatë të ekonomive. Ndaj sipas në mungesë të drejtave politike, çdo rritje e pabarazisë në ekonomi do të bëjë më të vështirë çdo hap për reforma të tjera liberalizuese në ekonomi.

Shpesh jepet si kundër argument fakti se disa ekonomi aziatike mundën të arrinin reforma ekonomike pa patur nevojë për demokratizim të mëtijshëm. Por sic tregojnë dhe *Acemoglu (2001)*, zhvillimi ekonomik në këto vende nuk u shoqërua me rritje të pabarazie që shihet si penguesi kryesor i reformave ekonomike. Shtete të tilla si Tajvani apo Koreja e Jugut u zhvilluan me pushtet autokratik por më egalitare sesa vendet e tjera duke u bërë përjashtimi, dhe jo rregulli në vendet me ekonomi në tranzicion.

Pra argumenti kryesor është se vendet të cilat janë më të demokratizuara janë gjithashtu më të gatshme të pranojnë reformat ekonomike dhe për këtë arsye këto reforma të jenë të suksesshme afatgjatë. Por kjo duhet të jetë e vërtetë në ato raste kur qytetarët u besojnë institucioneve qeverisëse. Një shembull është Evropa Perëndimore ku e drejta e votës u shoqërua me programe të paprecedenta të rishpërndarjes së pasurisë nga ana e elitës për të shmangur më tej dhe përplasjet apo revolucionet popullore Acemoglu (2000).

Por, siç pamë dhe më sipër në shkencat sociale preferencat për më shumë rol të shtetit në ekonomi dhe për politika rishpërndarëse mundet të varen nga preferencat individuale ekonomike. Kështu në rast se ata marrin asistencë sociale janë pro ndërhyrjes së shtetit, ose në rast se rajoni i tyre përfiton nga investimet publike apo ndjenja e altruizmit të pasurve. Por studime të tjera shqyrtojnë më tepër efektet që ka një regjim mbi perceptimet për rolin e shtetit. Alesaina (2009)

kryen një studim mbi efektet që pati qeverisja 45 vjeçare mbi mënyrën e të menduarit mbi qytetarët e Gjermanisë Lindore përse i përket ekonomisë së tregut, rolit të shtetit në shërbimet sociale dhe rolit të saj në politikat rishpërndarëse nga të pasurit te më të varfrit. Në rast se regjimet politike nuk do të kishin asnjë impakt mbi preferencat individuale atëherë nuk duhet të kishte diferenca mes banorëve të lindjes dhe perëndimit. Një hipotezë është se qytetarët largohen nga regjimi i mëparshëm dhe janë kundër rolit të shtetit dhe nga ana tjetër është hipoteza se ndërhyrja e madhe 45 vjeçare dhe indoktrinimi i vazhdueshëm bën që qytetarët të vazhdojnë të mendojnë se shteti është i rëndësishëm në arritjen e mirëqenies individuale. Por studimi i tyre arrin në përfundimin se qytetarët e Gjermanisë Lindore akoma dhe sot janë më pro përfshirjes së shtetit në ekonomi sesa Gjermanët Perëndimor. Në analizën e tyre do të duhen një ose dy gjenerata (20 deri në 40 vjet) që një Gjermano Lindor të ketë të njëjtat këndvështrime si ata perëndimor. Kjo diferencë lidhet direkt dhe kryesisht me traditën komuniste të ndërhyrjes apo dhe indoktrinimit që ka mbetur si pasojë e shkollimit publik. Pra pavarësisht faktit se komunizmi e bëri Gjermaninë lindore më të varfër qytetarët atje serish presin më shumë, dhe për rrjedhojë janë më në favor të saj, nga politikat rishpërndarëse të shtetit.

Por kjo evidencë nuk vjen vetëm nga Gjermania por edhe shtete të tjera në Amerikën Latine apo në Europën Lindore nuk janë plotësisht të bindur mbi rolin e

tregut dhe sipërmarrjes private pavarësisht përfitimeve që kanë patur në rritje ekonomike. Kështu përpara krizës ekonomike vendet e Europës Lindore patën një rritje ekonomike të përafërt me 5.5% në vit dhe shtytësi kryesor ishte sektori privat. Ndaj pritshmëritë do të ishin për një mbështetje të reformave pro tregut. Në një studim mbi vendet e Amerikën Latin në vitin 2003 u arrit në përfundimin se pothuajse 2/3 e të pyeturve besonin se privatizimi nuk sjell asnjë përfitim për ekonominë e tyre dhe më shumë se 40% mendonin se shteti nuk duhet të lejonte sektorin privat të prodhonte (*Lora, 2003*).

Mbështetja e publikut mbi privatizimet është e rëndësishme sepse ajo garanton reticencën e privatizimit në periudhën afatgjatë. Vetëm kërcënimi për rishikim të licencave të privatizimeve dobëson incentivat e sektorit privat për të investuar në fabrika apo industri që kanë qenë në pronësi të shtetit. Investitorët zakonisht u duhet që të bëjnë investime para prake të cilat janë të parikuperueshme më vonë. Në rast se politikat populiste kërcënojnë investimin e tyre ata janë të tërhequr për të investuar në industritë ku operojnë. Për më tepër në vende të tilla me shtet ligjor të ulët si Rusia apo Ukraina, klasa politike mundet të rishikojë të drejtat e privatizimit për t'ia dhënë atë shtetit ose mbështetësve të tyre duke dobësuar të drejtat e pronësisë.

Denisova hedh disa arsye se përse qytetarët mundet të jenë në kundërshtim me privatizimet. Një ndër këto është se privatizimi mundet të ndikojë direkt në

karrierën e e qytetarëve. Në tërësi ata qytetar që janë më të kualifikuar kanë mundësi për të shfrytëzuar çdo proces të privatizimit dhe ndaj e mbështesin atë ashtu sikundër e kundërshtojnë ato grupe shoqërore të cilat janë të kualifikuara për firma të cilat janë në pronësi të shtetit dhe kanë frikë për të ardhmen e tyre. Kështu ata persona që janë në moshë më të madhe e dinë se sistemi privat ka më pak nevojë për kualifikimet e marra përpara reformave të tranzicionit *Denisova (2007)*.

Në studimin e tyre ata gjejnë se një rritje me 10 vjet në moshën e të pyeturve rrit mundësinë e mbështetjes nga ana e tyre për rishikim të privatizimeve me 0.7% dhe shtetëzim të pronës me 1.5%. Gjithashtu vihet re se personat me pak kualifikim janë po aq të predispozuar që të mbështesin rishikimin e procesit të privatizimit me 2% dhe të nevojës për shtetëzim me afërsisht 5%. Në tërësi si qytetarët me moshë të madhe si ata me pak kualifikim mbështesin shtetëzimin pasi mendojnë se vetë procesi i privatizimit është i padrejtë. Ashtu siç dhe mundet të parashikohet ata qytetar të cilët mendojnë se kanë avancuar krahasuar me vitin 1989 apo se kanë në pronësi një apartament apo shtëpi janë në tërësi kundër procesit të rishikimit të privatizimit.

Denisova (2007) tregon se probabiliteti që ata të kundërshtojnë shtetëzimin e aseteve private rritet me 3.5%. Por nga ana tjetër sipas studimit të tyre qytetarët e Europës Lindore të cilët janë prekur negativisht gjatë tranzicionit, si ulje te pagës,

mungesë të ushqimit, shitje të apartamentit etj., zakonisht i veshin vështirësitë e tyre personale me faktin që ka rritje të privatizimeve në ekonomi. Kjo e fundit zakonisht është një proces i vështirë për t'u kuptuar me disa masa të shtrira në kohë dhe me efekte që ndjehen në periudhën afatgjatë. Ndaj shpesh herë qytetarët mundet të përdorin eksperiencën e tyre private si matës të reformave.

Tabela 20: Cfarë duhet bërë me kompanitë e privatizuara	<i>Shqipëri</i>	<i>Europa Lindore</i>	<i>Rusia</i>
<i>Pronësia të mos ndryshojë</i>	15.50%	19.53%	18.70%
<i>Ta mbajnë pronarët aktual nëse paguajnë vlerën e vërtetë të firmës</i>	51.96%	33.83%	31.10%
<i>Të shtetëzohet</i>	13.84%	29.67%	37.20%
<i>Të shtetëzohet dhe më pas të rishiten me proces transparent</i>	19.16%	16.97%	13%

Të dhënat nga pyetësi Jeta në Tranzicion (LiT 2006), tregon se në vendet e Europës Lindore në tërësi pothuajse 1/3 e popullsisë do të ishte pro shtetëzimit të shumë prej ndërmarrjeve të privatizuara dhe pothuajse 17% prej tyre do të donin të shtetëzonin dhe më pas të rishiteshin me një proces privatizimi më transparent. Ndërkohë vihet re shumë pak mbështetje për alternativën që pronësia të mos ndryshojë, pra të mbetet në duart e pronareve privat që e kanë aktualisht. Ajo që vihet re në plan të parë është se ka një mbështetje për privatizimin në rast se pronarët e saj paguajnë taksa më të larta që të justifikojnë këtë pronësi. Kjo

mbështetje vihet re dhe përsa i përket ri-shtetëzimit të pronës private dhe më pas me synimin e privatizimit të drejtë sipas të gjithë procedurave ligjore dhe transparente.

Duhet thënë se eksperiencia e vendeve të Europës Lindore nuk ka qënë e njëjtë përsa i përket procedurave të privatizimit dhe siç mundet të shihet në dy raste e mësipërme sjellja e publikut Shqiptar është krejtësisht e ndryshme nga ajo e publikut rus. Në Rusi ka një mbështetje dhe më të lartë se mesatarja e vendeve të Europës Lindore, 37% e publikut, për shtetëzim të pronës private dhe kalimin e saj në duar të shtetit. Ndërkohë në Shqipëri ri-shtetëzimi i ndërmarrjeve private ka shumë pak mbështetje vetëm 14% e publikut është pro kësaj. E njëjta gjë vihet re faktikisht dhe për vende të tjera të Europës Lindore dhe Qendrore. Në Slloveni mbështetja për shtetëzim të ndërmarrjeve ishte po aq e ulët sa në Shqipëri ndërkohë që mbështetja për pronësinë të mos ndryshojë ishte më e lartë se vendet e tjera në afërsisht 32% e popullsisë.

Tabela 21 Ne mendimin tuaj ne cilat fusha duhet te investoje shteti si prioritare?

	2006	2010
Edukim	18%	36%
Shendetesi	37%	33%
Strehim	8%	5%
Pensione	13%	9%
Ndihme Sociale per te Varferit	2%	6%
Mjedis (cilesi e ujit)	6%	2%
Infrastrukture (rruge publike)	14%	6%
Nuk e di	2%	2%

Tabela 22 Ne mendimin tuaj ne cilat fusha duhet te investoje shteti si prioritet te dyte?

	2006	2010
Edukim	23%	12%
Shendetesi	22%	26%
Strehim	8%	12%
Pensione	19%	13%
Ndihme Sociale per te Varferit	5%	13%
Mjedis (cilesi e ujit)	5%	5%
Infrastrukture (rruge publike)	17%	12%
Nuk e di	2%	2%

4.5.4. Ndërhyrja e Shtetit

Ndërkohë duket sikur popullata pati pritshmëri të ndryshme nga qeveria përsa i përket atyre faktorëve që ata i shihnin me interes për ndërhyrje të shtetit në ekonominë Shqiptare. Sipas të dhënave qytetarët vlerësonin në rast se shteti do të ndërhynte për të përmisuar arsimin dhe shëndetësinë në vend, ku afërsisht 45% e të pyeturve mbështesnin si prioritet, dhe vetëm 17% kërkonin ndërhyrje më të madhe për të përmisuar infrastrukturën publike. Siç shihet dhe nga të dhënat më sipër qytetarët Shqiptar kishin si prioritet akoma të rëndësishëm investimin në shëndetësi gjatë vitit 2010 kur kishte filluar dhe kriza ekonomike. Ajo që vihet re është rritja në rëndësi e ndihmës sociale ose pagesave të papunësisë në krahasim me vitin 2006.

Kjo preferencë e qytetarëve për më shumë investime publike reflektohet dhe në gatishmërinë e tyre për të paguar më shumë taksa me kushtin që ato shkojnë për përmirësim të shërbimit shëndetësor në vend.

Tabela 23 Jeni gati të paguani më shumë taksa për shërbimet e mëposhtme


	Po	Jo
Shërbim Shëndetësor	41%	48%
Edukim	35%	52%
Ndihmuar nevojtarët	42%	42%

Sipas një raporti të bërë publik nga McKensy (2012) vendet e Europës Lindore duhet të investojnë më shumë në ato sektorë të ekonomisë ku ato janë larg standardeve të BE-së. Sipas tyre për të garantuar ritme të rritjes ekonomike 4.6%, sa ishte para krizës financiare, këto shtete duhet të investojnë në infrastrukturë rrugore ku për momentin janë sa 40% të nivelit të mesatares së 15 shteteve të zhvilluara të BE-së. Pavarësisht kësaj nevojë të rëndësishme për investim rrugor qytetaret shqiptar kërkojnë më shumë investim publik në shëndetësi.

A mundet të shpjegohet kjo preferencë për rritje të shpenzimeve në shëndetësinë nga studimi i kryer nga Stuckler, Lawrence King dhe Martin McKee, të titulluar Privatizimet Masive dhe Kirza e Vdekshmërive në vendet Post Komuniste? Në këtë studim ata adresojnë impaktin që kanë patur reformat neoliberales mbi shëndetësinë e popullatës. Studimi i tyre fillon me të dhënat e UNICEF që i atribuon 3 milion vdekje të parakohshme tranzicionit, PNUD nga ana tjetër shton 10 milion njerëz të humbur për shkak të ndryshimit të sistemit dhe vetëm gjysma e shteteve kanë arritur në nivelin e jetëgjatësisë para fillimit të tranzicionit.

Sipas këtij studimi privatizimi i menjëhershëm rriti nivelin e papunësisë në këto vende dhe për rrjedhojë dhe përkeqësoi kushtet shëndetësore të punëtorëve. Terapia e shokut apo reformat e tjera të ndërmarra në Europën Lindore qartësisht injoruan koston njerëzore dhe u përqendruan vetëm në ndryshoret ekonomike. Ndaj në praktikë shkruan revista The Economist “privatizimi në masë ishte vrasje

masive (*The Economist*, 2009). Grafiku më poshtë tregon se në dekadën e parë jetëgjatësia ra me afërsisht pesë vite në Rusi e shoqëruar kjo dhe me rënien ekonomike, të ardhurat për frymë. Ndërkohë që dekada e dytë e tranzicionin shoqërohet me rritje ekonomike dhe në të njëjtën kohë me nivelet e jetëgjatësisë më të larta sesa viti 1991. Të dhënat e Bankës Botërore tregojnë gjithashtu se jetëgjatësia në Rusi kishte filluar të binte dhe përpara reformave të mëdha ekonomike.



Grafik 16: Jetëgjatësia dhe Rritja Ekonomike në Rusi

Por të zhvillojmë analizën e jetëgjatësisë në Rusi nga viti 1970 deri në mes të viteve 1980 vihet re se përkeqësimi shëndetësor kishte filluar më parë për shkak të dietës së varfër, përdorimit të alkoolit si dhe duhanit. Vetëm fushata e Gorbazovit në vitet 1986-1989 e rriti jetëgjatësinë me tre vite. Ndaj përfundimi se

reformat ekonomike çuan në rritje të vdekshmërisë duhet parë me rezervë, të paktën në Rusi. Të dhënat e mësipërme tregojnë për përkeqësim të kushteve të jetesës para reformave dhe ndoshta reforma graduale duhet të ishin ndërmarrë që në vitet 1970 kur në krye ishte Brezhnev, ndaj shkruan *The Economist* korrelacion nuk do të thotë shkak-pasojë.

Duke qenë se studimi i Stuckler pati jehonë të madhe ndërkombëtare, sidomos në kulmin e krizës financiare globale, studiues të tjerë u rikthyen dhe njëherë të dhënave për të parë nëse me të vërtetë privatizimet ishin shkaktarë të uljes së mesatares së jetëgjatësisë në Europën Lindore. Earle dhe Gehlbach (2009) nga universiteti i Uisconsin – Madison gjejnë se pasi merren parasyh të dhënat e *BERZH* për tërë vendet e Euopres Lindore marrëdhënia mes privatizimit dhe jetëgjatësisë është shumë e dobët dhe statistikisht jo domethënëse.

Por shpej herë janë pikërisht këto evidenca të ofruara nga ekonomistë dhe politikanë për të shtuar ndërhyrjen e shtetit në ekonomi dhe për të ndikuar më pas në rregullimin e ekonomisë. Por këto çojnë më pas në shqetësimin se rregullat e tepërta, pavarësisht qëllimit për të adresuar një shqetësim publik, shndërrohen në ngadalësues të lirisë ekonomike dhe mirëqënies. Teksa ekonomistë shprehin rëndësinë e institucioneve dhe ligjeve për të garantuar rritje ekonomike Uinston Churchill shkruante se “të kesh 10 mijë rregulla shkatërron tërë respektin që kemi për ligjin”. Këto rregulla në ekonomi janë në vetvete mbirregullim, që sjellin

kosto të fshehta për biznesin duke mos përfunduar as në buxhetin e shtetit e as në aktivitete produktive të ekonomisë.

Kjo kosto e lartë çon në çmime të larta dhe në ulje të rritjes ekonomike. Por pyetja që shtrohet është se çfarë mundet të bëjë një qeveri kur ekonomia e saj preket negativisht nga kriza të brendshme të tregjeve të saj apo nga kriza ndërkombëtare, të cilat nuk mund t'i kontrollojë? Kjo bëhet një çështje e nxehtë sidomos kur mendojmë se tregjet nuk janë perfekte e se ato mundet të dështojnë. Për këtë arsye, etatistët mendojnë se rregullimi dhe mbikëqyrja më e madhe ndaj tyre do të përmirësonte përfitimet ekonomike për tërë shoqërinë.

Por nga ana tjetër, pyetja shtrohet nëse qeveria, duke dashur të përmbushë detyrimet ndaj pritshmërive të publikut, adreson dështimet e tregut duke çuar në mbirregullim të ekonomisë dhe për pasojë, në përkeqësim të krizës dhe ulje të investimeve? Ekonomistët ndahen në këtë pikë, ku nobelistë si Maurice Allais thonë se “në mendjen time, liberalizmi dhe rregullimi i tregut nuk janë dy gjëra të ndara nga njëra-tjetra”. Stiglitz nga ana tjetër shton se “rregullat janë të nevojshme pasi shumë rrallë mundet të arrijmë në ekuilibër efikas mes aktorëve në ekonomi dhe rregullat shtetërore ndihmojnë në parandalimin e veprimeve të dëmshme dhe po ashtu në inkurajimin e veprimeve të shëndetshme”.

Në shembullin tipik ekonomik se përfitimi privat mundet të jetë më i vogël se kostoja në shoqëri, Stiglitz inkurajon dhe e sheh si të nevojshme ndërtimin e

rregullave kontrolluese në ekonomi. Pavarësisht se pranon prezencën e problemit të asimetrisë së informacionit dhe të rrezikut moral. Në këtë këndvështrim ngrihet pikëpyetja nëse mundet që të ndërtohen struktura rregullatore me aq kujdes sa për të marrë parasysh nevojat dhe interesat e gjithë palëve dhe për rrjedhojë, në një ekuilibër të përshtatshëm në ekonomi për shoqërinë.

Sulmi që mundet t'i bëhet lirisë ekonomike vjen dhe nga ndarja gjuhësore mes rregullimit, dhe antonimit të saj, që do të ishte çrregullim apo kaos vendimmarrjeje. Kështu në Shqipëri, ndërhyrja në tregje është e justifikuar si nevojë dhe pasojë e dështimit të thellë të tregjeve në fusha të tilla si arsimi, shëndetësia, energjia apo koncesionet dhe rregullat e shtuara, në fjalët e kryeministrit Rama, janë “emergjencë kombëtare”. Në fakt, e kundërta është e vërtetë.

Tregjet e lira janë të “mbirregulluara” dhe tregjet me ndërhyrje shtetërore janë gjithnjë hapa pas tregjeve me rregullat e tyre. Logjika të shtyn në mendimin se të kesh tregje të rregulluara nënkupton që të operosh në rregulla të qarta loje, por nga ana tjetër, ku ka më shumë rregulla të qarta sesa ligjet e ekonomisë. Çështja nuk është nëse duhet të kemi plan, thoshte Hayek, por kush duhet ta bëjë këtë plan, individi, firma apo shteti?

Por kjo çon në një përplasje të qasjes ndaj rolit të shtetit si kujdestar dhe atij liberal. Roli i këtij të fundit kufizohet në respektimin e kontratave apo të drejtat e

pronës duke ulur numrin e ligjeve dhe rregullave që kontrollojnë tregun dhe duke mos i ndryshuar shpesh ato. Kjo transparencë ul gjithashtu mundësinë për abuzim dhe sjellje korruptive nga ana e shtetit në kurriz të sipërmarrjes. Ndaj firmat janë të suksesshme ose dështojnë nëse plotësojnë nevojat dhe pritshmëritë e konsumatorit dhe jo të burokratit, që afatgjatë shndërrohen në interpretues rregullash e korruptiv në sjellje.

Në këtë filozofi disa qeveri duken sikur i japin më shumë rëndësi rregullimit të tregjeve, që mbështetet në indikatorët e World Economic Forum, ku barra e rregullave qeveritare e ka çuar shtete si Shqipëria nga vendi i 9-të në vitin 2012, në vendin e 33-të në vitin 2014. Ky indikator përmbledh perceptimin e sipërmarrësve për barrën kohore dhe financiare për të përmbushur detyrimet ndaj rregullave shtetërore për të bërë biznes. Përveç kostove direkte që kanë bizneset, këto barrierat rregullatore kanë dhe kosto të lartë fillestare për të hyrë në treg duke ulur konkurrencën dhe përfitimin e operimit në treg.

Pavarësisht përkeqësimit të këtij indikator, barra e rregullave qeveritare, Shqipëria mbetet sërish konkurruese me shtete të tjera dhe me indikatorë të tjerë institucionalë të ekonomisë së saj. Por një qasje liberale ndaj problemeve të ekonomisë sonë do t'i përgjigjej me përmirësim të të drejtave të pronës (vendi 116 në botë), pavarësisë gjyqësore, (vendi 101 në botë) etj. Shqetësuese pra mbetet filozofia e gabuar e adresimit të shqetësimit të bizneseve vendase duke

rritur rregullimin e ekonomisë. Si përfundim duhet theksuar që, edhe sikur ndërhyrja e qeverisë nëpërmjet rregullave të ishte e pakët, pyetëtorët tregojnë se komuniteti i biznesit sheh inefikasitetin e administratës publike si më shqetësues dhe sesa niveli i taksave, politikat ekonomike etj. Për më tepër drejtuesit e administratës publike nuk vendosin gjithnjë interesat publike përpara interesave të tyre private e institucionale.

Sa më shumë rregulla, aq më shumë mundësi për abuzim, duke çuar në atë që Friedman e quante si “tiranja e status-quo-së” ku pasi rregullat aprovohen, ato janë të vështira për t’u hequr dhe kur provohet se ato janë të dëmshme, pasi ka gjithmonë një palë të interesuar në ekonomi që përfiton nga këto rregullime dhe bën çmos që ato të mos anulohen.

KAPITULLI 5 KURSI KËMBIMIT DHE SISTEMI FINANCAIR NË SHQIPËRI

5.1 Hyrje

Në punimin e tij *Helleiner (1994, f119)* shpjegon se synimi kryesor i reformave neoliberales është ngadalësimi i niveleve të larta të inflacionit dhe përmirësimi i sistemit financiar në një shtet. Sipas vështrimit neoliberal investimi është stimuluesi kryesor i rritjes ekonomike, dhe pavarësisht emrit, është më afër modeleve neoklasike sesa modeleve liberale të përshkruara pas luftës së dytë botërore. Pas vitit 1980 ishte e qartë se shtete të cilat nuk kishin përqaftuar reforma neoliberales binin herë pas here në destabilitet të fortë financiar. Ndaj është e rëndësishme të kuptojmë arsyet kryesore që çojnë në rritje të kreditimit në ekonomi. Gjithashtu ky kapitull pasi bën një analizë të rëndësishme të financimit dhe zhvillimeve të saj në Shqipëri analizon rolin e stabilitetit të kursit të këmbimit në ekonomi. Studimet teorike kanë përfundime të ndryshme në lidhje me ndikimin e stabilitetit të kursit të këmbimit në rritjen ekonomike. Argumentet teorike në favor të normave fleksibël të këmbimit janë kryesisht të natyrës makroekonomike, si normat e fleksibël të këmbimit të mundësojnë rregullimin më të lehtë si përgjigje të goditjeve asimetrike të vendit.

Pyetja Kërkimore III

Duke qënë se sistemi financiar në Shqipëri shihet shpesh si një faktor i rëndësishëm i konsolidimit të ideologjisë neoliberale ky studim mundohet që të interpretojë sjelljen e institucioneve publike përsa i përket kontrollit të kursit të këmbimit dhe rolit që ka sistemi financiar në promovimin e aktivitetit privat në Shqipëri. Neoliberalizimi shihet si një ideologji e cila ndër të tjera synon të zhvendos kontrollin e faktorëve të prodhimit nga duart e shtetit drejt mekanizmave të tregut. Në këtë proces sugjerohet që shtetet të ulin deficitet buxhetore, të limitojnë subvencionet, të liberalizojnë tregun dhe gjithashtu të kenë një sistem financiar të zhvilluar duke mos lejuar një kurs këmbimi fiks. Duke qënë se sistemi financiar në Shqipëri shihet shpesh si një faktor i rëndësishëm i konsolidimit të ideologjisë neoliberale ky studim mundohet që të interpretojë sjelljen e institucioneve publike përsa i përket kontrollit të kursit të këmbimit dhe rolit që ka sistemi financiar në promovimin e aktivitetit privat në Shqipëri.

Hipoteza III

Shqipërisë, si një vend i Euroizuar dhe me shumë lidhje ekonomike me Eurozonën, nuk “i shkon përshtat” një kurs këmbimi fleksibël kundrejt euros.

5.2. Liberalizimi Financiar

Proçesi i liberalizimit financiar filloi në fillim të viteve 1960 dhe vazhdoi më pas në tërë vendet e zhvilluara duke inkurajuar kreditim të shpejtë e efikas që ndihmonte korporatat e këtyre vendeve për të financuar projektet e tyre në vende të ndryshme të botës në zhvillim. Liberalizimi financiar ishte një ndër pikat e rëndësishme të Konsensusit të Uashingtonit qëinkurajonte lirinë e lëvizjes së kapitalit nga vendet e zhvilluara drejt vendeve në zhvillim. Shpesh herë liberalizimi financiar shihet dhe si simboli i politikave neoliberales nga kritikët e saj. Esenca e liberalizimit financiar konsiston në heqjen e kontrollit të shtetit mbi: normat e interesit, politikat e bankës mbi kreditimin si dhe strukturën e pronësisë së bankave, pavarësinë e bankave private, lirinë e hyrjes së bankave të reja në treg etj.

5.2.1. A ndikon negativisht kontrolli i qeverisë në kreditim?

Kjo hipotezë është vërtetuar që në fillim të viteve 1970 nga *Ronald McKinnon dhe Eduard Shau (1973)* të cilët argumentojnë se ndërhyrja e shtetit në kontrollin e kreditimit ndikon negativisht në ekonominë e një vendi pasi ka më pak efikasitet në shpërndarjen e fondeve drejt atyre investitorëve apo individëve që duan të marrin kredi. Vendosija e praktikave të tilla si tavani i normës së interesit në fakt ndikon në uljen e nivelit të kursimit në një ekonomi dhe për pasojë dhe në mungesë të efikasitetit në këtë treg. Sipas studimeve të mëvonshme siç është

studimi i *Harvey (2003, f 25)* “A Çon në Rritje Ekonomike Liberalizimi Financiar”, tregohet se liberalizimi financiar çon në rritje ekonomike me afërsisht 1%. Kjo vjen kryesisht për shkak të mundësisë së investitorëve të huaj për të blerë asete në vende të ndryshme. Ky përfundim merr parasysh lloje të ndryshme të liberalizimit, grupim i ndryshëm i shteteve, ndryshore që ndikojnë në disa rajone, efektet e ciklit të biznesit, katër periudha të ndryshme kohe për të matur rritjen ekonomike etj. Pavarësisht efektit pozitiv të matur në liberalizimin financiar dhe më pas në rritjen ekonomike Harvey thekson se jo të gjithë shtetet përjetojnë të njëjtin impakt. Kjo varet sipas tyre për shkak të reformave makroekonomike, zhvillimi financiar, krizat bankare, reformat ligjore, shteti i së drejtës etj.

Studime të tjera tregojnë se rritja e liberalizimit financiar çon në rritje të kreditimit dhe më pas rritje ekonomike më të lartë me afërsisht me 2% në vit ku kreditimi bankar ishte faktori kryesor. Por nga ana tjetër kjo rritje e madhe ekonomike shpesh herë është shoqëruar me rreziqe në të ardhmen dhe me kriza ekonomike (*Aghion, 2005*). Duke arritur në këto rezultate pozitive për rritjen ekonomike që nga vitet 1970 bota përjetoj nje valë të gjatë të liberalizimit financiar. Ky liberalizmi financiar reflektohet në të dhënat e marra nga studimi i Levy i cili shprehet se këto ritme të larta të kredidhënies çuan dhe në huamarrje të madhe të bankave. Sipas tij në vitin 1950 sektori financiar kishte detyrime sa 3% e PBB-së së SHBA, në vitet 1970 ajo arriti 20% e PBB-së dhe në vitin 2008 ishte


120%. Kjo ishte një eksperiencë e re e rrezikshme e karakterizuar nga dekada të politikave neoliberale. Ndërkohë që kredidhënia e tyre në vitin 2008 arriti sa 271% e PBB-së. Nga ana tjetër sektorët e tjerë jo financiar, si qeveritë, qytetarët apo bizneset janë huamarrës neto sa 192% e PBB-së. Kjo rritje vjen si pasojë kryesisht e rrisë financiare apo produktet e reja financiare. Sipas *Mishkin (2013, f.175)* çdo krizë financiare paraprihet nga liberalizimi ose nga risia financiare, të cilat çojnë në rritje të lartë të kreditimit, sic pamë më sipër, ku qeveritë e kanë të vështirë t'i mbikëqyrin në kohë dhe ku bankat marrin më shumë rrezik përsipër se normalisht. Kjo vjen pasi institucionet financiare mund të mos kenë ekspertizën e duhur ose nxitjen e nevojshme për të treguar kujdes me kredi dhënien.

Nga ana tjetër risitë financiare si derivativët, pavarësisht se janë një burim i rëndësishëm i përfitimeve të bankave çoi në fakt në aktivitete të mëdha me rrezik për bankat. Këto transaksione ndodhin mbi banak (*over the counter*) dhe pa nevojën e ndërmjetësve duke i bërë serish të vështira për t'u kontrolluar dhe rregulluar nga institucionet mbikëqyrëse.

Por pavarësisht të dhënave të mësipërme të rritjes së kreditimit dhe të rolit të madh të institucioneve financiare duhet theksuar se globalizimi i shpejtë pas rënies së murit të Berlinit do të kishte qenë i ngadaltë pa zhvillimet në sektorin financiar. Ndaj gjatë periudhës së politikave neoliberale shumë prej rregullave që

kushtëzimin lëvizjen e kapitalit u hoqën nga shumë shtete në zhvillim dhe të zhvilluara.

Pyetja që shtrohet shpesh herë në literaturë është se cilët faktorë përcaktojnë sasinë e kredisë që institucionet financiare janë të gatshme për ti dhënë firmave ose individëve?



Grafik 18: Kreditimi në raport me PBB-në. Krahasim mes OECD dhe vendeve në Zhvillim

Arsyeja kryesore sipas disa studiuesëve është fuqia e kreditorëve. Kur kredi dhënesit mundet të imponohen huamarrësve në pagimin e kredisë, duke marrë kolateralin, ose duke vendosur dhe kontrollin e firmës, janë më të gatshëm që të


ofrojnë kredi. Këto teori të fuqisë janë formalizuar nga (*Aghion, 2005*), dhe *Hart dhe Moore (1994, 1998)*.

Këndvështrimi i dytë është se ajo që ka më shumë rëndësi për kredidhënësin është niveli i informimit mbi kredimarrësit ose historiku i tyre. Duke përdorur të dhëna nga 129 shtete dhe për institucionet kredituese për më shumë se 25 vjet *Shleifer (2003)* arrin në përfundimin se të drejtat ligjore të kredi dhënësve si dhe ndërtimi i institucioneve që ndajnë informacion janë statistikisht domethënëse si dhe shumë të rëndësishme për zhvillimin e kredisë private. Nga ana tjetër nuk ka asnjë evidencë se të drejtat e kreditorëve po konvergjojnë drejt origjinës ligjore të tyre, ose mes vendeve të pasura dhe vendeve të varfra. Ky përfundim sipas tyre hedh poshtë hipotezën e konvergjencës se vendet do të adaptojnë ligjet më të suksesshme dhe do të kenë të njëjtat pasoja pozitive në rritjen e kreditimit.

5.2.2. Europa Lindore

Duke iu rikthyer evidencës së Europës Lindore studime të bëra nga *Coudert (2010, f.105)* tregojnë se niveli i kreditimit për shumë vende të Europës Lindore ishte akoma shumë larg nivelit potencial të kreditimit në vitin 2007, pra para krizës financiare. Sipas këtij studimi Polonia apo Çekia kishin nivele akoma shumë të ulëta të kredidhënies 34% dhe 44% kredi/pbb, ndërkohë që duhet të ishte rreth 30% më e lartë. Ndërkohë që sipas këtij studimi për Shqipërinë, Hungarinë, Maqedoninë dhe Serbinë ishin 10-20% më larg potencialit të tyre sipas këtij studimi. Ndaj ajo çfarë duhet të theksohet është se pavarësisht rritjes së kreditimit me 50% në vit gjatë viteve 2002-2007 sërish këto vende mbeten larg potencialit të tyre pra janë në fazën e tyre të “catching-up”. Por gjatë kësaj periudhe kishte dhe shtete që kishin nivele të kreditimit më të larta se ç’mund të

mbanin ku kreditimi në Letoni arriti në 93% të PBB-së para krizës ose 30% më e lartë se ekuilibri i vlerësuar për to (Coudert & Pouvelle, 2010.).



Grafik19: Krahësim mes Kreditimit ndër vite mes Shqipërisë dhe Letonisë

Të dhënat e mësipërme në pamje të parë tregojnë për një përmirësim të kushteve të kredidhënies dhe për këtë arsye të ritmeve më të larta të rritjes ekonomike dhe të stabilitetit makroekonomik. Por pasojat e krizës financiare të vitit 2008 tregojnë qartësisht se ndërmjetësimi financiar mundet të ndërpritej lehtësisht dhe të çonte në krizë ekonomike duke krijuar skenarë të ngjashme me ekonomitë Aziatike në vitet 1990-të dhe se prezenca e bankave ndërkombëtare nuk garanton stabilitet financiar.

5.3. A ndikon kreditimi në rritje ekonomike (rasti Shqipërisë)

Të dhënat janë marrë për periudhën 2004 q1 deri në 2013 q1. Në to shihet se sa ndikohet ndryshimi në kreditim total i ekonomisë në varësi të niveleve të mëparshme të kredidhënies si dhe si reflektim i riskut në ekonomi, pra rritje e kredive të këqija.

$$\begin{aligned} \ln(ct) - \ln(ct - 1) \\ = k + 1ct - 1 + \alpha_2 ct - 2 + \alpha_3 \ln(NPLt) \\ - \ln(NPLt - 4) + \alpha_4 nt - 1 + \alpha_5 nt - 2 \end{aligned}$$

Tabela 24 Ct

<i>ct1</i>	-1.182 (8.16)**
<i>ct2</i>	-0.403 (2.99)**
<i>nt</i>	-0.072 (2.69)*
<i>nt1</i>	-0.085 (2.17)*
<i>nt2</i>	-0.064 (2.38)*
<i>_cons</i>	0 (0.02)
<i>R2</i>	0.87
<i>N</i>	40
<i>*p<0.05;</i>	<i>** p<0.01</i>

Nga ana tjetër të dhëna më poshtë tregojnë nëse kemi ose jo rritje ekonomike në varësi të kushteve ekonomike, pra seri të tremujorit të mëparshëm dhe të tremujorëve të mëparshëm të rritjes ekonomike si dhe niveli i kredisë dhe performance e saj.

Instrumental Variables

$$2SLS \ln gdp_t - \ln gdpt - 4 = k_1 + \beta_1 gt - 1 + \beta_2 gt - 2 + \beta_3 Ct + \beta_4 Ct - 1 + \beta_5 Ct - 2$$

Regresioni me dy faza (two stage least square) është teknikë statistikore që është përdorur në analizën e ekuacioneve strukturore. Kjo teknikë është zgjerimi i metodës OLS . Ajo përdoret në kushtet kur gabimet në ndryshoren e varur janë të lidhura me ndryshore e pavarura. Kështu gabimet në rritjen ekonomike e matur me ppb-gdp varen dhe nga performanca e ndryshoreve të pavarura si kreditë e këqija.

Tabela 25 Ndryshorja e pavarur rritja ekonomike

<i>Ct</i>	5.38	5.092
	-1.48	-1.48
<i>ct1</i>	8.674	8.02
	-1.1	-1.12
<i>ct2</i>	1.792	1.09
	-0.28	-0.22
<i>laggdp</i>	-1.239	-1.132
	(3.86)**	(2.70)**
<i>l2GDP</i>	-0.154	
	-0.36	
<i>_cons</i>	0.002	0.003
	-0.03	-0.05
<i>R2</i>	0.65	0.64
<i>N</i>	40	40
	* p<0.05; ** p<0.01	

Ajo çfarë vihet re nga ky model është se kreditimi dhe performanca e saj deri në vitin 2013 nuk ka patur efekt direkt në rritjen ekonomike.

5.3.1. Aksesit Financiar në Shqipëri

Një sistem financiar efikas dhe stabil garanton një çiftëzim të shpejtë dhe pa kosto mes atyre qytetarëve që duan të kursejnë dhe atyre që duan të investojnë, që Banka Botërore e vlerëson si thelbësore për një ekonomi tregu. Por për të zhvilluar tregjet financiare dhe institucionet financiare është e nevojshme që të prodhohen të dhëna të sakta e të besueshme për të dhënat kontabël e ligjore të huamarrësit si dhe historikun e tij me sistemin bankar. Kuptohet që më shumë njerëz do të kenë akses financiar në rast se implementohen me marrëveshjet ligjore mes palëve dhe ekzekutimin në kohë të kolateralit. Por në shumë shtete në zhvillim, përfshirë dhe Shqipërinë megjithëse janë bërë përpjekje për të instaluar një regjistër publik të kredive për të ulur problemet e zgjedhjes së gabuar (para kontratës) mungesa e ligjeve që lehtësojnë ekzekutimin në kohë të kolateralit rrisin mjaft problemet e rrezikut moral, (pas kontratës).

Kjo çon në rritje të kredive informale dhe në mungesë të kreditimit të shumë projekteve të cilat mundet të përmisojnë shumë indikatorë të tjerë makroekonomik. Të dhënat të përdorura nga Banka Botërore për aksesin financiar kanë të bëjnë me raportin mes depozitave dhe kredive, numri i degëve të bankave, numri i ATM-ve etj.

Tabela 26 Lehtësia për akses në financave mes vendeve të Europës Lindore

<i>Ekonomia 2013</i>	Sa prej kredive të dhena kerkonin kolateral (%)	Sa eshte vlere e kolateralit ne krahasim me vlerën e kredise %	Sa perqind e firmave mendojne se mungesa e financimit bankar eshte penguese per zhvillim
<i>Mesatare Boterore</i>	78.2	202.7	26.4
<i>Europa Lindore</i>	82.8	205.6	17.1
<i>Te ardhura te larta OECD</i>	65.5	157.4	12.8
<i>Shqiperia 2013</i>	90.9	255.2	6.5
<i>Bosnja</i>	82.5	190.1	14.1
<i>Bullgaria</i>	84.8	165.6	19.3
<i>Kroacia</i>	86.2	192.7	22.7
<i>Cekia</i>	75.9	158	16.4
<i>Estonia</i>	75	151.6	6.6
<i>Gjerogjia</i>	95.6	223.3	18.3
<i>Hungari</i>	77.3	180.4	9.1
<i>Kosove</i>	92.1	299.3	44.9
<i>Lituani</i>	74.2	192.8	17.3
<i>Maqedoni</i>	90.7	275.5	19.3
<i>Mal i ZI</i>	89.9	243.4	7.6
<i>Poloni</i>	59.5	153.9	15.6
<i>Rumani</i>	80.7	186.8	33.5
<i>Rusi</i>	84.2	154	28
<i>Serbi</i>	66.4	149.8	15.7
<i>Slloveni</i>	64.1	153.6	20
<i>Ukraine</i>	56.4	160.5	12.5

Analizë e Pyetësorit të Banka Botërore pwr bizneset dhe kreditimi

Në vitin 2013 në pyetësorin e bërë nga Banka Botërore me 360 firma në Shqipëri u arrit në përfundimet e mëposhtme. Kjo analizë me vendet e tjera të rajonit dhe vendeve të zhvilluara na ndihmon për kuptuar se sa i zhvilluar është ndërmjetësimi financiar në Shqipëri duke qenë se dhe kreditimi është akoma larg niveleve të vendeve të tjera në zhvillim.

Tabela 27 A mendoni se taksat janë penguese për zhvillimin e biznesit tuaj

Jo Penguese

Pengese e vogel

Pengese e moderuar

Pengese e madhe

	2005	2007	2009	2013
<i>Jo Penguese</i>	8%	20%	24%	31%
<i>Pengese e vogel</i>	11%	12%	13%	26%
<i>Pengese e moderuar</i>	40%	38%	38%	29%
<i>Pengese e madhe</i>	41%	25%	14%	11%

Treg financiar që nuk funksionon mirë çon në lindjen e “Huadhënësve grabitqarë” (Loan sharks), ata persona, ose grupe personash, që japin hua por që nuk janë të licencuar nga shteti e për rrjedhojë janë të jashtëligjshëm. Në fakt, “huadhënësit grabitqarë” njihen më tepër si një deformim që ndodh në një treg financiar në kohë krize, si dhe për normat e larta të interesit që ata u kërkojnë huamarrësve. Zakonisht palët hyjnë në një marrëveshje huadhënieje afatshkurtër, kryesisht me konsumatorë me të ardhura të ulëta, që kanë vështirësi të marrin hua nga bankat. Megjithëse shumat që ata marrin hua janë të vogla, le të themi 100 euro deri në

200 euro, norma efektive e kthimit në fakt arrin nga 300 për qind deri në 3000 për qind!

Pavarësisht këtyre kostove të larta, klientët e shfrytëzojnë këtë sektor jozyrtar të tregut, pasi nuk kanë një punë të sigurt, kanë humbur vendin e punës, apo kanë vonesa në marrjen e pagës etj. Gjithë këto shqetësime theksohen akoma më shumë kur një ekonomi kalon një krizë të fortë ekonomike, siç ishte dhe kriza globale e viteve 2008-2009. Për ta ilustruar gjallërimin e këtij fenomeni mund të përdorim të dhëna nga Mbretëria e Bashkuar, ku industria e financimit të “huave paradhënie” (payday loan) arriti në 4 miliardë paund në vitin 2012, nga 100 milionë paund në vitin 2004. Sipas studimeve të kryera në Mbretërinë e Bashkuar, rreth 38 për qind e të anketuarve që kërkonin financim nëpërmjet “huave paradhënie”, kishin marrë hua dhe nga familjarë të tjerë. Nga ana tjetër, në një vërtetim të kryer nga Banka e Shqipërisë në vitin 2013 me mbi 1210 individë të anketuar në 16 rrethe të vendit, doli që raporti i konsumatorëve të cilët marrin hua në banka është pothuajse i njëjtë me borxhin jozyrtar, ose atë që nuk regjistrohet si i tillë, por që shpesh bëhet shkak për konflikte sociale. Dy qëllimet kryesore të marrjes së huasë që rendit Banka e Shqipërisë janë: blerja dhe riparimi i një prone dhe mallrat e domosdoshme të konsumit. Vërtimi më i fundit i Bankës Qendrore reflekton se në rreth 40% të rasteve të huamarrjes, familjet u janë drejtuar burimeve formale (banka dhe institucione financiare jobankare) dhe në 60% të

burimeve joformale (persona fizikë dhe huamarrje nga dyqanet). Qëllimi kryesor i huamarrjes së familjeve mbetet “konsumi” në 32% të rasteve. Duhet theksuar se familjet që kanë deklaruar “rënie të aftësisë paguese”, në 48% të rasteve cilësojnë si arsye kryesore “rënien e të ardhurave familjare”.

Por duke qenë se huadhënia jozyrtare nuk është e monitorueshme, e për rrjedhojë, nuk kemi të dhëna, informacioni i marrë nga vrojtimi i mësipërm ngre disa shqetësime për tregjet financiare në Shqipëri. Shpeshherë tregjet jozyrtare të huadhënies nuk shihen si tregje paralele të ekonomisë, përkundrazi ato shihen si rezultat i shtypjes, tkurrjes së huadhënies në sistemin zyrtar. Ajo që vihet re në Shqipëri është se penetrimi i huadhënies, pra totali i huasë në raport me PBB-në ka mbetur në 40 për qind të PBB-së, ndër më të ulëtat në rajon, ndërkohë që huatë me probleme janë ndër më të lartat në rajon. Stiglitz shkruan ndër të tjera se dështimet kryesore të tregjeve financiare vijnë për shkak të kostos së lartë dhe mungesës së informacionit të plotë. Gjithsesi, kostot e transaksioneve shpjegojnë vetëm pjesërisht praninë dhe rëndësinë e ndërmjetësve financiarë dhe të financave të tërthorta në funksionimin e tregjeve financiare.

Një tjetër arsye është asimetria e informacionit, dmth në një transaksion financiar njëra palë ka më pak (ose më shumë) informacion sesa pala tjetër. Për shembull, në kuadrin e një kontrate huaje, huamarrësi ka më shumë informacion rreth rrezikut të projektit që po financohet sesa individi që e jep huanë. Asimetria e

informacionit krijon problem, si para firmosjes së kontratave, ashtu edhe pas. Në kushtet e rrezikut të lartë të perceptuar për dhënien e huasë, për shkak të ritmeve të ulëta të rritjes ekonomike dhe të nivelit të lartë të huave me probleme, bankat kanë ulur ritmin e dhënies së huave vitet e fundit, duke nxitur, ndoshta jashtë vullnetit të tyre, huadhënien jashtë sistemit bankar. Për të shmangur problemin e zgjedhjes së gabuar (angl. adverse selection,) pra problemin që krijohet nga asimetria e informacionit para transaksionit (firmosjes së kontratës), huadhënësit bazohen në “reputacionin e klientit në treg”, ku rrjeti i njohjeve familjare dhe shoqërore garanton besueshmërinë e huamarrësit. Ky proces zakonisht është i shpejtë dhe pa kosto të larta fillestare.

Në kushtet kur rritja ekonomike është nën potencial, kur detyrimet e pashlyera për punët publike llogariten ende në shumëmilione dollarë dhe kur kushtet e dhënies së huave janë shtrënguar ndjeshëm, a mundet që “huadhënësit grabitqarë” të kenë zëvendësuar në masë sektorin bankar? Gjithashtu shtrohet pyetja: a ekziston ky sistem jozyrtar, paralel me sistemin bankar, apo ai ndërthuret me këtë të fundit në një mënyrë apo tjetër? Bankat në Shqipëri janë padyshim në përpjekje të mundimshme për të gjetur një ekuilibër të vështirë midis ruajtjes së standardeve të huadhënies dhe mosshtrëngimit në ekstrem të kërkesave ndaj klientëve. Faktikisht, vërtetimet periodike të Bankës së Shqipërisë për kreditimin e biznesit tregojnë se politika shtrënguese e bankave gjatë dy tremujorëve të shkuar ka

ardhur në rritje. Më shqetësuese akoma për rritjen ekonomike afatgjatë është fakti se, sipas qëllimit të përdorimit të huasë, standardet u shtrënguan vetëm për huatë me qëllim investimet, ndërsa u lehtësuan për huatë me qëllim financimin e kapitalit qarkullues. Në këto kushte të shtrëngimit të procedurave të dhënies së huasë, shoqata të ndryshme të bizneseve në vend shpeshherë kanë ngritur si shqetësim lulëzimin e financimit informal, si një alternativë ndaj sistemit bankar në vend.

Ndaj dhe fokusi i bankave në vend vetëm në menaxhimin e aktiveve të tyre nuk mundet të injorojnë dhe anashkalojnë atë se çfarë ndodh me “huadhënësit grabitqarë”, që pavarësisht se operojnë në periferi të sistemit financiar, mundet të jenë të lidhur, ndoshta dhe tërthorazi por jo vetëm, edhe me sistemin bankar. Natyrisht, ky fenomen kërkon një vëmendje të shtuar të të gjithë aktorëve të sistemit financiar shqiptar dhe përtej tij, pasi efektet dhe pasojat e tij nuk janë thjesht kosto oportune apo me natyrë financiare, por thelbësisht me natyrë sociale dhe të sigurisë.

5.3.2. Asimetria Informacionit dhe rëndësia e Institucioneve Publike

Për të qenë konkurrues dhe për të lejuar shpërndarjen në kohë dhe kosto të informacionit do të mendohej që agjencitë publike duhej të ishin më pranë biznesit për t'i ardhur në ndihmë për të gjetur burime të reja të furnizimit. Në pyetësin e bërë në vitin 2005 për Shqipërinë vihet re se 52% e firmave të pyetura mendonin se agjencitë shtetërore nuk ndihmonin në dhënien e

informacionit për burime të furnizimit. Ndërkohë familjarët dhe miqtë mbeten një burim i rëndësishëm i informimit ku vetëm 75% mendojnë se ky është burim i rëndësishëm ose shumë i rëndësishëm i informimit.

Tabela 28 Sa problem është aksesimi financiar për zhvillimin e firmes suaj

	2005	2007	2009	2013
<i>Jo Penguese</i>	37%	30%	31%	57%
<i>Pengese e vogel</i>	21%	29%	26%	21%
<i>Pengese e moderuar</i>	25%	30%	27%	14%
<i>Pengese e madhe</i>	15%	13%	12%	7%

Por nga ana tjetër në ideologjinë neoliberale do të ishte me interes që bizneset të bashkoheni bashkë në organizata përfaqësuese. Por të dhënat tregojnë se 77% e bizneseve të pyetura mendonin në 2005 se këto organizata nuk ndihmojnë në lobim për të ndryshuar ligjet e biznesit me qeverinë. Po ashtu kur pyeten këto biznese nëse bënë përpjekje për t'u ndryshuar politikat e ndërmarra në 12 muajt e fundit vetëm 24% u përgjigjën pozitivisht ndërkohë që pjesa tjetër nuk kishin ndërmarrë asnjë hap për të bërë lobim për interesat e tyre.

Shqetësuese në pyetësorët adresuar bizneseve është dhe fakti që më shumë se 44% e kompanive pohonin se konkurrenin kundër bizneseve të tjera informale dhe se 36% prej tyre mendonin se kjo ndikonte negativisht në konkurrueshmërinë e firmës së tyre.

5.4. Rëndësia e Financimit

Në punimin e tij Helleiner (1994, f119) shpjegon se synimi kryesor i reformave neoliberales është ngadalësimi i niveleve të larta të inflacionit dhe përmirësimi i sistemit financiar në një shtet. Sipas vështrimit neoliberal investimi është stimuluesi kryesor i rritjes ekonomike, dhe pavarësisht emrit, është më afër modeleve neoklasike sesa modeleve liberale të përshkruara pas luftës së dytë botërore. Pas vitit 1980 ishte e qartë se shtete të cilat nuk kishin përqafuar reforma neoliberales binin herë pas here në destabilitet të fortë financiar. Ndaj është e rëndësishme të kuptojmë arsyet kryesore që çojnë në rritje të kreditimit në ekonomi.

Të gjitha modelet e lartpërmendura shpjegojnë se rritja ekonomike është në varësi të investimeve. Kështu sipas teorisë neoklasike si dhe modelit AK rritja ekonomike vjen si pasojë e investimit në kapital njerëzor dhe në kapital fizik. Sipas teorisë endogjene apo të varietetit të produktivitetit ajo që ka rëndësi është investimi në teknologji dhe forma e kërkimit. Por asnjë prej këtyre modeleve në fakt nuk analizon rolin e bankave ose të ndërmjetësve të tjerë financiar për të ndërmjetësuar në lehtësimin e këtyre vështirësive. Kjo deri diku është e kuptueshme duke qenë se këto modele merren me arsyetimin thelbësor të rritjes ekonomike dhe ndërmjetësit financiar janë deri diku lubrifikues të makinerisë. Modelet e thjeshtësuara na ndihmojnë për të kuptuar më qartë arsyet kryesore të

rritjes ekonomike. Gjithsesi fakti është që shumë kompani kanë vështirësi në gjetjen e fondeve të mjaftueshme për të investuar që më pas do të ndikonte në rritje ekonomike.

Në librin *Handbook of Economic Growth*, Ross Levine (2005, f. 868) përmbledh gjithë literaturën e deritanishme mbi lidhjen që ka ndërmjetësimi financiar dhe rritja ekonomike: shtetet që kanë banka që mirë funksionojnë rriten më shpejt, si dhe sistemet financiare që funksionojnë mirë lehtësojnë kufizimet financiare që pengojnë firmat në zhvillimin industrial.

Nga ana tjetër financimi nuk diskutohet fare në esetë e disa prej ekonomistëve të parë të zhvillimit. Robert Lucas (1988, faqe 6) shkruan se financimi është një faktor i theksuar më shumë se c'duhet mbi efektin e tij në rritjen ekonomike. Aty ku firmat udhëheqin, financat ndjekin Joan Robinson (1952, f. 86). Në këtë këndvështrim financimi nuk sjell rritje ekonomike, financat i përgjigjet kërkesave në ndryshim të sektorit real. Kurse Fituesi i Çmimit “Nobel” Merton Miller (Grossman & Miller, 1988) argumenton se impakti i financimit në rritjen ekonomike është shumë i dukshëm për të pasur nevojë për ndonjë debat serioz.

Bagehot , Schumpeter dhe *McKinnon* (2004) hedhin poshtë idenë se lidhja mes rritjes dhe financës mundet të injorohet pa limituar të kuptuarin tonë të rritjes ekonomike. Ndaj gjetja e një lidhje mes rritjes ekonomike dhe sektorit financiar do të lejojë politikbërësit për të influencuar në reformat në sektorin financiar.

5.4.1. Reformat Bankare dhe Zhvillimi i Sektorit Bankar në Europën Lindore

Duke qenë se reformat e ndërmarra kërkonin ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore duke hequr të gjitha subvencionet shtetërore mungesa e kapitalit bankar në fillimet e tranzicionit bënë që dhe recensionit të ishte më i thellë. Ristrukturimi i ndërmarrjeve bëri që kërkesa për krediti të ishte kyçe në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë. Kështu faktikisht shkruajnë dhe dy punonjës të FMN-së në një studim në vitin 1992. Sipas *Calvo dhe Corriceli (1992)* arsyeja kryesore përse recesioni në vendet e Lindjes ishte më i fortë seç parashikohej kishte të bënte me teorinë e mungesës së institucioneve të ekonomisë së tregut duke vendosur theksin kryesisht në mungesën e tregut të kreditimit si arsyeja thelbësore duke dhënë shembuj për shtete të tilla si Bullgaria, Çekosllovakia, Hungaria, Polonia dhe Rumania.

Ndaj reformat e ndërmarra në Europën Lindore kishin si synim rikthimin e shumë prej prej funksioneve bazike të sistemin financiar në vend çka nuk ndodhte në sistemin e ekonomik të mëparshëm. Duke huazuar nga Stiglitz (1992) ndërmjetësuesit financiar kanë pesë funksione kryesore:

1. Lehtësojnë transferimin e kapitalit nga ata që e kanë (kursimtarët) në ata që nuk e kanë (huamarrësit). Kjo është e mundur bazuar në teorinë se ka disa

agjentë ekonomike që janë të gatshëm të këmbëjnë konsumin e tanishëm me konsum në të ardhmen.

2. Menaxhimi i riskut. Duke qenë se të gjithë transaksionet financiare kërkojnë kohë ato përfshijnë dhe risk brenda. Sistemi financiar në këtë këndvështrim mundëson uljen e riskut për një investitor të vetëm duke diversifikuar investimin e tyre.

3. Institucionet financiare janë përgjegjëse për përzgjedhjen e projekteve për financim që janë efikas për një periudhë të dhënë. Shpesh herë huamarrësit nuk kanë njohurinë e duhur për të bërë llogaritjen e duhur të riskut që mbart projekti i tyre, dhe në shumë raste ofrojnë informacion të gabuar për të mashtruar bankën për të ulur normën e interesit.

4. Projektet e përzgjedhura janë efikase vetëm në ato raste kur monitorimi është i lehtë dhe kur ndërtohet një kontratë financiare profesionale.

5. Kontratat duhet të respektohen duke përfshirë këtu dhe procedurat e falimentimit në rast se është e nevojshme.

Kështu për të patur një treg financiar të zhvilluar nuk mjafton vetëm që palët e përfshira direkt të kenë ndërtuar një kontratë të mirë mes tyre, por duhet që dhe mjedisi ligjor dhe institucional të jetë i përshtatshëm. Një përmbledhje shumë koncize e debatit të rolit të shtetit si rregullator apo si garantues i mjedisit ligjor për sistemin financiar parqitet nga *Mickiewicz (2010, faqe 175-177)*. Ajo që

ofrohet shpesh herë në modelin perëndimor është vetë rregullimi i institucioneve financiare siç është për shembull bursa financiare. Por në Europën Lindore kjo qasje nuk do të ishte realiste pasi problemet e “qylaxhiut” ose free-rider mbeten prezentë dhe do të duheshin dekada për to që të ishin efikase. Ndaj roli i institucioneve qeveritare me të drejtën e tyre kushtëzuese dhe forcën për implementimin e rregullave mbeten të rëndësishme për parandalimin e mashtrimit.

Një rol thelbësor i shtetit mbetet implementimi i ligjit për të drejtat e pronësisë mbi astet dhe respektimin e kontratave. Në të njëjtën kohë shteti duhet të jetë i besueshëm në rolin e tij duke garantuar se ai nuk do të implementojë taksa të larta apo të shtetëzojë ndërmarrje në mënyrë që të lejojë rritjen e ndërmjetësimit financiar. Së dyti shteti mundet të rrisë efikasitetin e sistemit financiar me politika që inkurajojnë konkurrencën.

Nga ana tjetër praktikat e lejimit të oligopolit në sistemin bankar sjell më pas të ardhura më të ulëta për kursimtarët dhe kosto më të larta për huamarrësit. Roli i shteti gjithashtu mbetet i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik sikundër dhe probleme në sektorin financiar kanë impakt negativ në ekonominë reale. Stabilitet makroekonomik, kryesisht matet me normën e kontrolluar të inflacionit që sjell rritje të kreditimit, ulje të kostot së kredisë dhe rritje ekonomike. Siç dhe është diskutuar mbi rolin e shtetit gjatë krizës së fundit


bankare 2008-09 ai ka rol si kreditues final (lender of last resort). Por gjithsesi dhe ky rol i shtetit sjell pasoja për sistemin financiar pasi një ndërhyrje e shtetit për të shpëtuar sistemin financiar ndryshon sjelljen e tyre duke marrë përsipër më shumë projekte me risk të lartë dhe riskun moral (moral hazards) duke detyruar fonde publike të përdoren për të shpëtuar firma private.

Përpyjekjet e shtetit për të rritur rolin e tij rregullator në sistemin financiar do të ishin të kota pa një administratë cilësore. Pa këtë të fundit kuptohet që më shumë rol rregullues nuk do ta përmirësonte situatën. Gjithashtu shqetësimi është se në rast se shteti i lejon sistemin bankar që të ofrojë ekspertizën për të përmirësuar situatën atëherë sipas Mickiewicz interesat private do të mbizotëronin duke lejuar që ato forca që supozohen se duhen rregulluar në fakt janë ato që rregullojnë dhe duke lejuar më pas interesat politike të mbizotërojnë.

Kështu institucionet financiare mundet të detyrohen të japin kredi për ato firma që për zgjidhen për lidhjet politike dhe nuk bazohen në projektet reale të tyre ose subvencionon shpenzimet qeveritare nën koston oportune reale. Një pikë që mbështetet dhe nga (*Barth dhe Levine, 2006*) ku arrijnë në përfundimin se roli rregullator i shtetit mundet të maksimizojë mirëqenien e politikanëve dhe burokrateve dhe jo mirëqenien e publikut në tërësi. Për këtë arsye Mizkiewicz argumenton se në Europën Lindore cilësia e administratës shtetërore nuk është

teknokrate sa duhet dhe po ti jepet shtetiti i njëjti rol rregullues dhe monitorues si në vendet e zhvilluara atëherë kjo do të kishte efektin e kundërt në ekonomi.


Alternativa është ndërtimi i institucioneve monitoruese private që do të izolonin ndërmjetësimin politik dhe ligje të forta që respektojnë kontratat financiare. Të ekzaminosh marrëdhënien mes sistemit ligjor dhe zhvillimin e sistemit bankar është shumë e rëndësishme pavarësisht nëse ekziston apo një jo një lidhje me rritjen ekonomike afatgjate. Kriza financiare nxorri dhe njëherë në pah rëndësinë e kreditimit për ekonominë duke ekspozuar mangësitë e tregjeve financiare në vendet në zhvillim dhe Shqipëri në vecanti.



Grafik20: Rritja e Kreditimit si % e PBB-se

Pavarësisht se Shqipëria akoma nuk ka implementuar plotësisht idetë neoliberale në tregun e saj financiar, duhet thënë se pasojat e krizës financiare të vitit 2008 po ndihen gjatë dhe në ekonominë tonë. Për të ngadalësuar problemet e vëna re me kreditë e këqija ky kapitull ngre si hipotezë se kursi këmbimit është zgjedhur si një instrument i rëndësishëm për të garantuar stabilitet të tregjeve financiare, pavarësisht se Banka e Shqipërisë nuk e shpreh një gjë të tillë zyrtarisht. Ndaj rritja e menjëhershme e kredive të këqija, ndër më të lartat në rajon, reflekton dobësitë e mëdha të institucioneve të tjera mbështetëse të tregjeve financiare dhe jo të ndërmjetësve financiar (bankave) në vetvete.


Sikundër shihet dhe nga grafiku vlera e monedhës vendase LEK ndaj monedhës Evropiane EURO, është e qëndrueshme deri në tremujorin e tretë të vitit 2008. Pas këtij tremujori monedha vendase zhvlerësohet në mënyrë të vazhdueshme deri në tremujorin e katërt të vitit 2009. Pas kësaj periudhe vlera e monedhës vendase karshi Euros mbetet thuajse e pandryshuar. Ndërkohë që niveli i kredive të këqija dyfishohet nga 7% në 15% për të njëjtën periudhë.



Grafik 21: Zhvlerësimi i Lekut dhe Kreditë e këqija

Rezultatet e këtij grafiku ngrenë hipotezën që Banka Qëndrore në synimin e saj për të ruajtur stabilitetin makroekonomik të vendit dhe për të frenuar rritjen e kredive të këqija në vend ka ndjekur një politikë të kursit të këmbimit të ndryshëm nga pretendimi zyrtar se ai është kurs plotësisht i luhatshëm (fleksibël).

Deri në vitin 2008 diferenca në normën e interesit mes kredisë në lek dhe në EURO ishte mjaft e lartë për shkak të LIBORIT të ulët. Kjo inkurajon publikun të marr hua në monedhë EURO. Stabiliteti i monedhës vendase inkurajon qytetarët për të marrë hua në EURO.




Grafik 22: Diferenca Norma Mesatare e Interesit Euro Lek

2. Shqipëria nuk përjetoi asnjë shqetësim të ekonomisë reale apo të shkëmbimeve tregtare me vendet e BE-së gjatë asaj periudhe duke ngritur shqetësimin e zhvlerësimit të monedhës vendase gjatë kësaj periudhe.
3. Kriza financiare solli zhvlerësim të monedhës vendase me afërsisht 14% në më pak sesa një vit. Duke qenë se kreditimi në euro është i lartë atëherë kjo mundet të ketë ndikuar në nivelin e kredive të këqija dhe në stabilitetin e sistemit financiar në vend.
4. A po ndiqet një politikë e stabilitetit të monedhës vendase pas krizës dhe a po sinjalizon qytetarët serish negativisht për të marrë kredi në EURO dhe jo në LEK? Çfarë shqetësimesh mund të sjellë kjo në të ardhmen?

Studimet teorike në lidhje me ndikimin e stabilitetit të kursit të këmbimit në rritjen ekonomike është e përzier. Argumentet teorike në favor të normave fleksibël të këmbimit janë kryesisht të natyrës makro ekonomike, si norma e fleksibël e këmbimit të mundësojë rregullimin më të lehtë në përgjigje të goditjeve asimetrike të veçanta reale të vendit. Nga një perspektivë luhatshmëria e ulët e kursit të këmbimit mund të shoqërohet me kosto më të ulëta të transaksionit për tregtinë ndërkombëtare dhe të flukseve të kapitalit në këtë mënyrë kontribuojnë në rritjen më të lartë. Në këtë kuptim ky studim analizon nëse kursi i këmbimit në Shqipëri ka shfaqur volatilitet gjatë periudhës 2002-2013. Duke qenë se volumi tregtar me vendet e Eurozonës zë pothuajse 70% të tregtisë së Shqipërisë, atëherë kjo tregon një arsye më shumë për të mbajtur një kurs këmbimi sa më stabil. Por nga ana tjetër një ndër arsyet përse në një ekonomi ka nivel të lartë të kreditimit në monedhë të huaj është kosto e huamarrjes në monedhën vendase dhe në monedhën e huaj. Sipas të dhënave, mesatarisht nga Janari i vitit 2001 deri në Maj 2013, kostoja e marrjes hua në lek në krahasim me monedhën euro ka qenë mesatarisht 5.44% më e lartë. Siguria e perceptuar e kredimarrësve vendas për mungesën e volatilitetit të monedhës euro ka bërë që shumë prej tyre të marrin hua afatgjata për blerje pajisjesh apo pasuri të patundshme, më shumë në Euro sesa në monedhë vendase.

Rëndësia e studimit të impaktit në performancën makroekonomike të regjimit të kursit të këmbimit bëhet më e rëndësishme kur mendojmë se sa të ekspozuara janë vendet e Ballkanit Perëndimor ndaj krizës financiare në Eurozonë veçanërisht me Greqinë. Tregtia me Greqinë mbetet shumë e rëndësishme për Malin e Zi, Maqedoninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë, që zë rreth 12 % të eksporteve totale. Nga ana tjetër siç dhe theksuam më parë kreditimi në monedhë të huaj është gjithashtu i lartë; 50% të kredive totale në vende si Maqedonia apo Bullgaria dhe deri në 70% në vende të tjera si Shqipëria, Bosnja dhe Kroacia. Duke parë këto të dhëna kuptohet sa i rëndësishëm bëhet studimi i impaktit që ka regjimi i kursit të këmbimit në performancën makroekonomike.



Duke qenë se synimi i gjithë shteteve të lindjes ishte integrimi në BE atëherë asnjë prej këtyre shteteve nuk e pa të nevojshme që të ndikonte në de-euroizimin e sistemit financiar duke qenë se eventualisht do të mund të adoptonin euron dhe do të integroheshin në tregjet evropiane. Kjo pavarësisht faktit që institucioni i Bankës Qendrore është forcuar kudo në këto vende. Por pas krizës globale u pa qartë se euroizimi i tepërt ekspozonte këto ekonomi në rreziqe të mëdha dhe të pakontrollueshme nga autoritetet lokale. Zhvlerësimi i monedhës vendase solli kudo rrezik për sistemin bankar duke sjellë më pas rënie të kredithënies dhe recension.

Tsangarides (2010) mbetet i vetmi studim që mundohet të identifikojë impaktin që pati lloji i regjimit të kursit të këmbimit në ekonomitë e vendeve në zhvillim gjatë krizës financiare 2007-08. Sipas këtij studimi vendet që kishin kurs këmbimi fiks patën performancë më të dobët sesa ato që kishin kurs fleksibël, duke shtyrë më tej rëndësinë e studimeve në të ardhmen për llojin e kursit të këmbimit.

Në kërkimet empirike, regjimet e kursit të këmbimit klasifikohen shpesh herë në të fiksuara, të ndërmjetme si dhe fleksibël. Së fundmi ka dhe literaturë e cila mundohet ti japë përgjigje pyetjes nëse vendet me ekonomi në zhvillim mund të gjejnë një metodë të ndërmjetme e cila është e ndryshme nga regjimi de jure i përcaktuar nga Banka Qendrore apo jo.

Ky dallim gjithashtu mbështetet dhe nga studime të tjera si Calvo dhe Reinhart (Calvo, 2000) , Gosh (1997) dhe Levy-Yeyati dhe Sturzenegger (2005). Të tre këta studime tregojnë sesi ndërhyrjet në kursin e këmbimit mundet të çojnë në një kurs këmbimi i cili është i ndryshëm nga ai që pretendohet nga zyrtarët. Megjithatë duhet theksuar se edhe nëse de fakto mund të gjendet një ndryshim mes vlerave të kursit të këmbimit të vërejtura në studim dhe asaj se çfarë pretendohet nga autoritetet, ne nuk mund të pretendojmë se kjo politikë është sistemike nga ana e politikëbërësve.

Sipas studimit të Levy-Yeyati dhe Sturzenegger, shumica e punimeve mbi kursin e këmbimit i klasifikojnë regjimet e kursit të këmbimit mbështetur mbi klasifikimin de jure të FMN-së (kjo e fundit është e bazuar mbi të dhënat e qeverive), pavarësisht se ka një ndryshim mes asaj që pretendohet dhe asaj që vihet re në realitet (*Levy-Yeyati & Sturzenegger, 2005*).

Ficher (2001) nga ana tjetër në një analizë të politikave të kursit të këmbimit shprehet se shumë prej krizave që kanë ndodhur në tregjet ndërkombëtare si Meksika në 1994-ën, Tailanda, Indonezia dhe Koreja në 1997-tën, Rusia dhe Brazili në 1998-ën si dhe Argjentina dhe Turqia në vitin 2000, kanë patur një kurs këmbimi fiks. Ndërkohë nga ana tjetër shtete të cilat kishin kurs fleksibël të këmbimit evituan kriza të ngjashme me ato të shteteve me kurs fiks këmbimi. Për këtë arsye shpesh politikëbërësit kanë bërë rekomandime kundër mekanizmave që

do të çonin në kurs fiks të lehtë ose të përshtatshëm, për shtete të cilat janë të hapura për flukse ndërkombëtare të kapitalit. Në këtë kuptim shpesh herë rekomandimet duket se duhet të jenë ose për kurs fiks ose për një kurs fleksibël.

Sipas Fischer, por edhe sipas studiuesve të tjerë si *Calvo dhe Reinhart (2000)*, autoritetet kombëtare nuk mund të jenë indiferente ndaj fluktuacioneve të kursit të këmbimit në rast se ai do të ishte krejtësisht fleksibël. Në këtë rast politikat monetare, por edhe politika që do të ndërhyjnë direkt në kursin e këmbimit, mund ti përgjigjeshin presionit që mund të vinte nga tregu. Në këtë këndvështrim nuk është çudi që autoritetet të mund të ndjekin ose një kurs këmbimi të fiksuar ose një kurs këmbimi fleksibël, por të menaxhuar.


Siç u përmend dhe më sipër Calvo dhe Reinhart analizojnë se si sillen kursi i këmbimit, rezervat dhe norma e interesit, për të analizuar nëse shtetet që pretendojnë se kanë një regjim fleksibël me të vërtetë kanë një kurs të tillë. Sipas tyre shumë shtete që janë në tranzicion dhe që pretendojnë se kanë një kurs fleksibël në fakt nuk e kanë një të tillë. Këto sjellje ata i përkufizojnë me një term të vetin “frika për të patur kurs këmbimi fleksibël ⁷”.

⁷ Angl : *Fear of Floating*

5.5. Luhatjet e Kursit të Këmbimit

Sipas Bankës së Shqipërisë, kursi mesatar i këmbimit të monedhave të huaja kundrejt Lekut përfaqëson mesataren e thjeshtë të kurseve zyrtare ditore të këmbimit përkundrejt monedhës vendase Lek, përgjatë një muaji. Në grafik është paraqitur ky kurs mesatar mujor nga muaji Janar 2002 deri në muajin Gusht 2012, për dy monedhat kryesore Euron dhe Dollarin amerikan. Në pamje të parë vihet re se volatiliteti i kursit Lek-Dollar është më i lartë se volatiliteti Lek-Euro. Vlera më e ulët historike e kursit të këmbimit Euro-Lek ka qenë në vlerën 120.9 në Dhjetor të vitit 2007. Ndërkohë që kursi më i lartë i Euros karshi Lekut ka qenë 141.97 në Qershor të vitit 2011. Nga ana tjetër Dollari amerikan shfaq më pak stabilitet se kursi i këmbimit Euro-Lek. Për të njëjtën periudhë kursi i këmbimit Dollar-Lek ka një vlerë minimale prej 77.24 Lek në Korrik të vitit 2008 dhe një maksimum historik prej 144.91 në Maj të vitit 2002.

Për të kuptuar më mirë se cila monedhë paraqet volatilitetin (luhatshmërinë) më të lartë është matur ndryshimi në përqindje i monedhave. Vihet re nga grafiku 2 se kursi i këmbimit Dollar- Lek paraqet dhe volatilitetin më të madh. Siç dhe konfirmohet nga koeficienti i variancës i cili ka një vlerë prej 0.05 për kursin e këmbimit Euro-Lek dhe 0.15 për kursin e këmbimit Dollar-Lek. Pra koeficienti i variacionit është pothuajse tre herë më i lartë për kursin Dollar-Lek.



Grafik 22: Ndryshimi i kursit të këmbimit lek euro/usd

Koeficienti i variacionit, i cili tregon raportin mes devijimit standard dhe mesatares së të dhënave, tregon se kursi i këmbimit të Dollarit amerikan me Euron ka variacion më të lartë. Ky koeficient është i rëndësishëm pasi lejon krahasimin mes dy monedhave pavarësisht se ato kanë mesatare të ndryshme nga njëra tjetra. Testi tjetër që duhet parë për të vërtetuar nëse seritë kohore të kursit të këmbimit shfaqin variacion të ndryshëm nga njëri tjetri, ne do të përdorim testin Dickey Fuller. Ky test shërben për të treguar nëse të dhënat janë stacionare apo jo, ose e thënë ndryshe shërben për të kuptuar nëse kanë mesatare dhe variancë konstante.

<i>Statisitka</i>	<i>Euro ALL</i>	<i>Dollar ALL</i>
<i>Mesatare</i>	130.68	103.98
<i>Varianca</i>	50.16	240.54
<i>Devijim Standar</i>	7.08	15.51
<i>Koeficienti i Variacionit</i>	0.05	0.15

Një model i thjeshtë $AR(1)$ është:

$$y_t = \rho y_{t-1} + u_t$$

Ku y_t është ndryshorja me interes, t është indeksi i kohës, ρ është koeficienti dhe u_t është gabimi. Një “unit root” është present nëse $\rho = 1$ dhe në këtë rast modeli nuk do të ishte stacionar, pra të dhënat e shkuara kanë një efekt në vlerën e monedhës sot. Në rast të kundërt kur të dhënat janë stacionare atëherë të dhënat kthehen në mënyrë frekvente drejt një mesatareje.

Regresioni mundet të jepet në këtë formë

$$\nabla y_t = (\rho - 1) y_{t-1} + u_t = \delta y_{t-1} + u_t$$

Ku ∇ është diferenca e parë pra ne testojmë nëse $\delta = 0$ (ku $\delta = \rho - 1$).

Në rast se vlera e z është më e madhe sesa vlera e z kritike atëherë ne e pranojmë faktin që Hipoteza 0 është e vërtetë, pra të dhënat nuk janë stacionare. Mënyra e dytë e vlerësimit është vlera e McKinnon e p . në rast se më e madhe se vlera kritike atëherë ne e pranojmë H_0 .

H_0 : të dhënat kanë një “unit root” dhe nuk janë stacionare

H_1 : të dhënat nuk kanë Unit root dhe janë stacionare.

Të Dhënat

Të dhënat analizojnë luhatjet ditore të monedhës vendase me tre monedhat e rëndësishme ndërkombëtare: EURO, USD dhe GDP. Të dhënat fillojnë nga data 1 Janar 2004 deri më 18 Janar 2015. Shtetet që do të merren në shqyrtim janë disa prej shteteve në tranzicion të cilat kanë kurs këmbimi fleksibël. Kjo do të na ndihmojë të shohim nëse ka shtete të cilat mundet të ndjekin një politikë të fshehtë të mbajtjes së kursit të këmbimit nën kontroll dhe jo ta lërë atë të jetë krejtësisht fleksibël. Rezultatet e regresioneve dhe të testit Dickey Fuller më pas krahasohen me klasifikimin zyrtar të bërë nga FMN përse i përket monedhave vendase.

Tabela 33 Augmented Dickey-Fuller test për Euro

Numeri obs = 4005

test statistikë	Kritike në 1%	Kritike në 5%	Kritike në 10%
-11.535	-3.43	-2.86	-2.57
Z(t)			
vlera-p per Z(t) = 0.000			

Tabela 34 Augmented Dickey-Fuller test për Dollarin Amerikan

Numeri obs = 4005

test statistikë	Kritike në 1%	Kritike në 5%
-1.714	-3.43	-2.86
Z(t)		
vlera-p per Z(t) = 0.4241		

Ky model mundohet të analizojë sjelljen e Lekut ndaj dy monedhave kryesore të huaja me të cilat operon sot ekonomia shqiptare, euro dhe Dollari amerikan. Shqipëria është një vend i vogël e i hapur dhe ka zgjedhur një kurs zyrtar të këmbimit fleksibël të monedhës vendase. Kjo e fundit pranohet nga teoria ekonomike se do të mund të sjellë përfitime për ekonominë vendase duke lejuar një politike monetare të pavarur, një ekonomi më fleksibël për të amortizuar goditjet negative që mund të vijnë nga jashtë, lejon forcat e ekonomisë së tregut të vendosin për çmimin e monedhës vendase si dhe nuk promovon tregti të jashtme me kurs këmbimi të nënvlerësuar në mënyrë që të rrisë eksportet vendase. Megjithatë, nga ana tjetër, një ekonomi e vogël si ajo e Shqipërisë mund të ekspozohet ndaj presionit të çmimeve të mallrave të importuara duke sjellë inflacion në ekonominë vendase. Për këtë arsye duke qenë se shumica e tregtisë së Shqipërisë kryhet me vendet e Eurozonës ky studim ngre si hipotezë të tijin se; kursi i këmbimit mes Lekut dhe euros duhet të tregojë fluktuacion më të ulët sesa ç ‘tregon kursi i këmbimit të Lekut me Dollarin amerikan. Për këtë arsye studimi do të analizojë sjelljen e Lekut ndaj euros dhe Dollarit.

Një vend me ekonomi të vogël dhe të hapur si Shqipëria preket lehtësisht nga volatiliteti i kursit të këmbimit Euro/Lek. Sipas raportit të *ACIT 2011* më shumë se 70% e shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë kryhen me vende të zonës euro. Për këtë arsye çdo luhajtje e këtij kursi këmbimi do të kishte impakt direkt në inflacion

të importuar apo dhe konkurueshmerinë e prodhueseve vendas duke ndikuar në mirëqenien e ekonomisë.

Tabela 35 Rezultate: Test Stacionariteti Dickey Fuller për monedhat

	EUR	USD	Vlerësimi FMN
Shqipëria	Stacionare	Jostacionare	Fleksibël
Serbia	Jo Stacionare	Jostacionare	Fleksibël e kontrolluar
Rumani	Stacionare	Jostacionare	Kontrolluar
Poloni	Jo Stacionare	Jostacionare	Fleksibël
Kroaci	Stacionare*	Jostacionare	Fleksibël Kontrolluar
Maqedoni	Stacionare	Jostacionare	Kontrolluar

Në lidhje me integrimin financiar Shqipëria është akoma larg, por në një perspektivë (të largët) do të shtrohet çështja e adoptimit të Euros. Vënde të caktuara të Bashkimit Evropian (Suedia, UK, Finlanda) nuk e kanë adoptuar Euron. Është me interes të madh të analizohet hollësisht regjimi më i përshtatshëm i kursit të këmbimit ALL/Euro nga pikëpamja e stabilitetit makroekonomik të Shqipërisë. Nëse nga analiza do të rezultonte si më stabil një regjim fiks atëherë kjo do të mbështeste adoptimin e Euros në të ardhmen, në të kundërt opsiioni i Suedisë, UK dhe Finlandës do të ishte më i favorshëm.

Duke qënë se Shqipëria ka zgjedhur një regjim fleksibel të kursit të këmbimit pyetja që shtrohet është nëse Banka Qendrore e Shqipërisë ka mundësi për të

influencuar ne nivelin e këtij kursi këmbimi. Kjo bëhet dhe më e rëndësishme nëse kemi parasysh dhe nivelin e dollarizimit – euroizimit të ekonomisë sonë. Sipas FMN-së niveli i dollarizimit në ekonominë Shqiptare është i moderuar por që gjithsesi ky nivel mbetet shqetësues për Bankën Qëndrore për të siguruar stabilitet të sistemit financiar.

5.5.1. Krizë Financiare në një vend të euroizuar


Kështu duhet të kemi parasysh se Banka Qendrore mundet që të stabilizojë lehtësisht sistemin bankar në ato raste kur depozitat janë të denominuara në monedhë vendase. Por e vetmja rrugë që mund të përdor Banka Qëndrore për ato depozita në monedhë të huaj është rezervat në monedhë të huaj. Për këtë arsye një panik bankar në monedhë të huaj është tejet shqetësues për një ekonomi të vogël e të dollarizuar si Shqipëria e cila mundet të ketë efekt në kursin e këmbimit. Rëndësia e Bankës Qëndrore si huadhënës i fundit (lender of last resort) është formuluar nga Bagehot gjatë krizave financiare të shekullit 19-të në Amerikë dhe Angli.

Rëndësia e mënjanimi të krizës financiare dhe minimizimit të impaktit negativ që ajo ka në ekonomi është vënë në dukje nga *Caprio and Klingebiel (1996)* të cilët tregojnë se jetëgjatësia e një krize bankare zgjat mesatarisht 4.5 vjet dhe me një kosto afërsisht 13.6% të PPB. Për këtë arsye bankat qendrore shihen si huadhënës i fundit të cilët rrisin mirëqenien e ekonomisë duke mënjанuar një krize bankare.

Por shpesh here thuhet se de jure dollarizimi i larte i ekonomisë e bën politiken monetare te paafte për te ndihmuar sistemin financiar ne rast vështirësie. Rasti i Argjentinës, i cili ne vitin 2001 kishte 71% te depozitave ne monedhe te huaj, sjell në vëmendje impaktin negativ që ka dollarizimi ne rast paniku bankar dhe pamundësinë e Bankës Qendrore për të stabilizuar tregun financiar.

Studime në të ardhmen mund të bëhen mbi impaktin që mund të ketë patur një panik bankar në kursin e këmbimit. Kjo bëhet pasi Shqipëria ishte shumë pranë një paniku bankar në vjeshte të vitit 2008 kur qytetarët në masë u drejtuan drejt bankave të nivelit të dytë për të tërhequr depozitat e tyre duke vendosur në vështirësi këto institucione financiare. Sipas raportit vjetor te mbikëqyrjes se bankës se Shqipërisë 2008, sistemi bankar deri në muajin shtator të vitit 2008 paraqiste një gjendje të kënaqshme likuiditeti. Ndërkohë që ne tremujorin e fundit te vitit 2008 depozitat pësuan një rënie të konsiderueshme me 49.1 miliardë lekë (7.08 për qind),

Ky fenomen ndikoi në përkeqësimin e situatës së likuiditetit, duke u konkretizuar në rënien e aktiveve likuide të sistemit, thellimin e hendekut të likuiditetit, rritjen e raportit kredi-depozita si edhe kufizimin e mundësisë së sistemit për të mbuluar në të ardhmen një tërheqje masive depozitash.



Në studimin e *Chitu (2012)* dollarizimi i lartë i ekonomive të vende të Europës Lindore con në ashpërsim më të madh të efekteve të krizës në kushtet kur kemi marrë parasysh efekte si : rritja e kredisë para krizës , deficitet të tregtisë dhe financiare , rregullimet e tregut , si dhe GDP-së për frymë. Sipas këtij studimi rritja reale e PBB-së ka rënë mesatarisht me rreth 0.84 pikë përqindje më shumë në ekonomitë ku kredia e dhënë në monedhë të huaj ishte 10 pikë përqindje më i lartë se vendet e tjera .


5.6. Roli i shtetit në praktikën neoliberale

Është thënë shpesh herë se kriza financiare e vitit 2008 solli dhe njëherë në vëmendje dështimet e ideve neoliberale dhe efektet gërryese të liberalizimit financiar. Ndaj argumentimi është se neoliberalizmi duhet të zëvendësohet me politika të kujdesshme rregullatore dhe një ndërhyrje më të madhe të shtetit. Duhet theksuar se Shqipëria nuk u prek nga kriza financiare e vitit 2008 por në një mënyrë ose një tjetër Shqipëria mundej të prekej direkt nga paniku bankar. Me rëndësi është impakti dhe thelbi i minimizimit të riskut në tregje: asimetria e informacionit.

Viti 2008 ishte test edhe për reticencën e politikave neoliberale dhe në shumë vende u pa a rëndësishme rikthimi të ndërhyrja në treg të institucioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore. Por a ishte kjo ndërhyrje kaq e dukshme dhe ku u shfaq kjo ndërhyrje në rastin e Shqipërisë?

Të dhënat tregojnë për një panik në sistemin Bankar Shqiptar gjatë vjeshtës së vitit 2008 (nga 1269 milion euro depozita me afat në shtator 2008 në 1198 milion euro në tetor 2008) . Kjo erdhi kryesisht si pasojë e falimentimit të disa prej bankave më të mëdha amerikane. Banka Qëndrore reagoi për të stabilizuar sjelljen e agjentëve ekonomikë duke rritur nivelin e sigurimit të depozitave si dhe duke ulur normën e interesit. Në kuadrin e sigurimit të likuiditetit u krijuan linja

kredie speciale për bankat si dhe u krijua mundësia për ofrim likuiditeti me afat mujor.



Grafik24: Depozitat me afat në mln EUR sistemi bankar Shqiptar

5.6.1.Tërheqja e depozitave

Nuk ka asnjë teori apo model ekonomie që të japë me saktësi rolin apo ndërhyrjet që duhet të ndërmarrë qeveria për të ndryshuar në mënyrë pozitive dinamikat e ekonomisë. Për këtë arsye interpretimi dhe gjykimi janë të rëndësishëm në kohë krizash. Duke ditur ekspozimin minimal të ekonomisë Shqiptare ndaj aseteve

toksike teoria, do të rekomandonte hapa të matur dhe minimal prej Bankës Qendrore dhe të qeverisë për të ndërhyrë në treg.

Por efektet në ekonominë reale u shpërndanë shumë shpejt dhe viti 2009 nxori në pah se asnjë ekonomi nuk ishte immune ndaj krizës globale. Në fund të 2009-ës vende si Lituania, Estonia, Serbia dhe Ukraina kishin probleme të theksuara makroekonomike me rritje negative ekonomike prej -18.4%, -13.2%, -4% dhe -14% të PBB respektivisht. Shumë ekonomistë kanë interpretuar zhvillimet makroekonomike në vendet e Europës Lindore si më të renda se reçesioni i viteve të post-komunizmit. Vendet e rajonit të Ballkanit gjithashtu patën vështirësi ekonomike ku mesatarja e këtyre vendeve ishte -6.2%⁸ për vitin 2009. Shqipëria nga ana tjetër duket se ka qënë ndër vendet e vetme me rritje ekonomike pozitive. Duke iu referuar statistikave zyrtare, por edhe institucioneve ndërkombëtare, ekonomia Shqiptare u rrit në vitin 2009 me 3%. Për këtë arsye FMN deklaroi se “gjatë furtunës së madhe ekonomike Shqipëria ka dalë paq” ku “politika të mira ekonomike si dhe integrimi i limituar në tregjet ndërkombëtare kanë qënë arsyet kryesore të zbutjes së krizës globale”.

Në Shqipëri kjo krizë erdhi disi me vonesë për vetë specifikat që ka ekonomia shqiptare. Ndaj është e vështirë të bëjmë një analizë të saktë rreth impaktit të

⁸ Vendet e përmendura përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Bullgarinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Rumaninë, dhe Serbinë. Të dhënat janë marrë nga Raporti i Tranzicionit 2009, BERZH.

krizës në ekonominë Shqiptare. Vlen të përmendet se disa të dhëna makroekonomike si rritja e PBB-së, kursi i këmbimit, tregtia me jashtë, depozitat dhe niveli i kreditimit të ekonomisë apo dhe niveli i remitancave tregojnë se jo gjithçka ishte pozitive gjatë vitit 2009. Këto të dhëna tregojnë se kriza ekonomike globale ndikoi në shumë indikatorë makroekonomike dhe është e rëndësishme të interpretohen masat e marra nga Banka Qëndrore në veçanti. Për këtë arsye kjo analizë fokusohet se si ekonomia Shqiptare reagoi gjatë krizës dhe sa efikase ka qënë Banka Qëndrore në parandalimin e krizës së panikut dhe në ringritjen e kreditimit të ekonomisë.

Çfarë ndodhi me ekonominë dhe tërheqjen e depozitave dhe rënia e kreditimit? Kryetari i Rezervës Federale Allan Greenspan njihej si një ekonomist që shqiptonte mjaft mirë zhvillimet dhe ndjenjat e tregut të sofistikuar Amerikan. Një ndër shprehjet e tij mjaft të spikatura ishte dhe “*irrational exuberance*” ose entuziazëmi jo racional. Kjo i përkonte zhvillimeve të tregut financiar gjatë investimeve në periudhën e fundviteve 90-të. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për sjelljen e tregut financiar gjatë vitit 2008, ku mjafton një ngjarje jo pozitive për të vënë në panik shumë prej aktorëve financiar.

E njëjta sjellje paniku duket sikur ndodhi dhe me agjentët ekonomikë shqiptar ku gjatë vitit 2008 pesha e depozitave të publikut në totalin e aktiveve të sektorit bankar, shënoi rënie për herë të parë pas disa viteve, si rezultat i tërheqjes së


depozitave nga publiku në tremujorin e fundit të vitit. Në këtë periudhë vlerësohet se janë tërhequr rreth 49.1 miliardë lekë ose rreth 7 për qind e vlerës së tyre në tremujorin e tretë (Banka e Shqipërisë, 2008). Vlerësohet se arsyeja kryesore e tërheqjes së depozitave në bankat Shqiptare ka qenë efektin psikologjik që shkaktoi ashpërsimi i krizës. Pasojat e këtij reagimi ishin rritja e nevojave për likuiditet si edhe rënia e ritmeve të kreditimit në sektorin bankar. Tërheqja e depozitave çoi në një kërkesë imediate për likuiditet nga ana e bankave. Rëndësia e depozitave në sistemin financiar Shqiptar reflektohet nga Raporti i Stabilitetit Financiar 2008 të Bankës së Shqipërisë ku depozitat e klientëve zënë 77% ose 645.1 miliardë lekë të totalit të aktiveve të bankave në Shqipëri. Pjesën më të madhe të aktiveve të sektorit bankar, në fund të vitit 2008, e zë portofoli i kredive që përbën 47.6 për qind të totalit të aktiveve. Konkretisht, për të përballuar rënien e depozitave në tremujorin e fundit të vitit 2008, bankat tregtare pakësuan portofolin e mjeteve të tyre likuide, rritën huamarrjet nga grupet bankare zotëruese dhe atë nga Banka e Shqipërisë.

5.6.2. Modeli Diamond-Dybvig

Diferenca në likuiditetin e detyrimeve ndaj asetëve ka çuar në kriza bankare ku për shkak të panikut njerëzit tërheqin në masë dhe në të njëjtën kohë depozitat e tyre. Diamond dhe Dybvig kanë zhvilluar një model që mundohet të shpjegojë pse bankat zgjedhin që depozitat të jenë më likuide se asetet e tyre për të kuptuar pse

bankat ekspozohen nga paniku. Ky model është përdorur gjerësisht për të kuptuar krizën bankare dhe llojet e tjera të krizave financiare. Investitorët përballen me rreziqe që i vërejnë privatisht të cilat çojnë në një kërkesë për likuiditet. Sipas Diamond kontratat tradicionale të depozitave të cilat ofrojnë likuiditet çojnë në ekuilibrim të ndryshëm, ndër të cilat është dhe tërheqje në masë e depozitave. Kjo padyshim shkakton dëme të vërteta ekonomike. Kontratat që mund të parandalojnë tërheqjen e depozitave në masë janë studiuar, dhe analiza tregon se ekzistojnë rrethana kur Qeveria me sigurimin e depozitave mund të prodhojë kontrata superiore që parandalojnë panikun (Diamond & Dybvig., 1983).

Kontratat e thjeshta të depozitave janë në gjendje të sigurojnë likuiditet, por lënë bankat e ekspozuara ndaj panikut bankar. Kjo dobësi ndodh për shkak se ka ekuilibra të shumta të cilat kanë nivele të ndryshme të besimit. Në rast se ndodh kjo e fundit “self-fulfilling proficy” preken dhe agjentë që do të dëshironin të mbanin depozitat në bankë.



Grafik 25: Sistemi Bankar Shqiptar: Mjaftueshmëria e Kapitalit %

5.6.3.Rreziku Moral

Duke iu referuar modelit të lartpërmendur një studim i krizave bankare që nga fillimi i viteve 1980 në mes të viteve 1990 ka gjetur se prania e një skeme e sigurimit të depozitave ka tendencë për të rritur probabilitetin e sjelljeve me risk të lartë nga ana e bankave (Schich, 2008). Sigurimi i Depozitave mund të rrisë rrezikun e sjelljeve të pakujdesshëm nga bankat individuale. Nëse bankat e dinë se depozitat janë të siguruara, ato janë më të predispozuara për të marrë rrezikun e tepruar duke ekspozuar dhe rrezikun moral, ku qeveria garanton depozitat pavarësisht veprimeve të bankave. Për këtë arsye agjentet nuk do të kenë asnjë

nxitje për të kërkuar një bankë të kujdesshëm dhe do të kërkonin banka me normë më të lartë të kthimit. Prandaj, sigurimin e depozitave ka për të shkuar së bashku me rregullimin dhe mbikëqyrjen për të parandaluar rrezikun e tepruar.

Gjithsesi bankat Shqiptare nuk mund të karakterizohen si banka të cilat janë duke ndjekur politika me risk të lartë Aktivet bankare gjatë vitit 2008 përbeheshin nga portofoli i kredive që përbënin 47.6 për qind të totalit të aktiveve dhe veprimet me thesarin, ky zë arriti në 251.4 miliardë lekë ose në 30.1 për qind të totalit të aktiveve. Për këtë arsye siguri i depozitave nuk mund të ketë efektin e rrezikut moral në ekonominë Shqiptare, përkundrazi ajo mund të rrisë besimin e publikut në banka duke e bërë sistemin financiar më të qëndrueshëm. Një rrjet sigurie mund të kufizojnë efektin që problemet në një bankë mund të ketë në bankat e tjera të shëndetshme duke zvogëluar kështu mundësinë e infektimit apo një reaksion zinxhir brenda sistemit bankar si një e tërë.


Eksperiencia e fundit e krizës ekonomike globale, ku shumë vende ndërmorrën masa unilaterale për të garantuar sigurinë e pjesshme ose të plotë të depozitave tregon rëndësinë e veçantë të sigurimit të depozitave gjatë krizave financiare. Në mënyrë të veçantë, vende si Austria, Belgjika apo Holanda patën rritje të depozitave të garantuara deri në 100,000 €, ndërsa vende të tjera si Franca, Danimarka, Gjermania dhe Irlanda garantuan siguri të plotë për depozitat bankare. Duke parë masat e mara nga shumë ekonomi të zhvilluara për të rritur nivelin e

sigurimit të depozitave besoj se rreziku i panikut publik ndaj institucioneve financiare ishte tepër i përhapur. Në këtë këndvështrim paniku i agjentëve ekonomike në Shqipëri duhej përballur dhe trajtuar me masa të ngjashme si në vendet e tjera.

Për këtë arsye vendimi i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për të rritur sigurimin e depozitave deri në 2.5 milion lek ishte hapi më i rëndësishëm për të qetësuar dhe bindur depozituesit në Shqipëri se sistemi bankar Shqiptar është i sigurt. Rëndësia e rritjes së garantimit të depozitave merr një rendësi të veçantë sidomos në Shqipëri ku kriza e skemave piramidale nuk është shumë e largët dhe mund të çonte në një precipitim të rëndë të panikut dhe tërheqjes së depozitave. Ndërhyrja dha kontributin e saj ku duke iu referuar periudhës së vitit 2009 në totalin e depozitave në sistemin bankar Shqiptar vërehet një rritje e depozitave të individëve me rreth 12.5 për qind. Për sa i përket depozitave që janë pjesë e skemës së sigurimit, sanksionuar edhe prej shumës ato vlerësohen në masën e 83 për qind të totalit të parave që janë investuar në sistemin e bankave të nivelit të dytë në vend. Ky është një tregues në rritje nga viti në vit duke pasqyruar besim ndaj sistemit bankar vendas.

Ky trend pozitiv vazhdoi dhe gjatë muajve të parë të 2010 ku është venë re një rritje e konsiderueshme e depozitave. Depozitat e familjeve dhe bizneseve shqiptare në sistemin bankar u rritën me 135 milionë euro gjatë muajit janar, duke

shënuar rritjen më të lartë mujore që nga gushti i vitit të kaluar, gjë që e rriti totalin e depozitave përtej maksimumit historik të shënuar para krizës së vitit 2008. Sipas statistikave të publikuara nga Shoqata e Bankave, totali i depozitave në sistem arriti në 713 miliardë lekë, (5.16 miliardë euro). Fakti që dy të tretat e depozitave të reja u furnizuan nga klientët individë, ndërsa një e treta nga kompanitë e biznesit tregon për rikthim të besimit të plotë të individëve ndaj sistemit bankar Shqiptar.



Ky kapitull arrin në përfundimin se ka hapsirë për investigim të mëtejshëm të politikave të ndjekura nga Banka Qëndrore përse i përket ndërhyrjes në kursin e këmbimit. Ajo që vihet re në këtë studim është se ndryshe nga vendet e tjera të cilat kanë një politikë zyrtare fleksibël të kursit të këmbimit në Shqipëri vihet re

se kursi i këmbimit Lek Euro mbetet stacionar ndër vite pavarësisht luhatjeve të mëdha dhe ndryshimeve të faktorëve tregtarë apo të ndryshimeve të bilancit të pagesave. Duke qënë se shumë biznese dhe familje janë të ekspozuara ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit atëherë duket sikur është në interes të politikave zyrtare që të ndiqet një politikë e ndryshme nga politika zyrtare e kursit të këmbimit që në literaturë njihet si frika nga kursi fleksibël ose “fear of floating”. Nga ana tjetër në këtë kapitull analizuam zhvillimet në sektorin financiar në Shqipëri dhe përse ndërhyrja e Bankës Qëndrore është e rëndësishme në ato raste kur ka panik financiar dhe si krahasohen ndërhyrjet në Shqipëri në krahasim me shtetet e tjera. Në të ardhmen ky studim mundet të pasurohet në interpretim më të detajuar të rolit të sektorit financiar në rritjen ekonomike dhe në promovimin e inovacionit në prodhim në ekonominë Shqipëtare.

KAPITULLI 6

KONLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Hyrje

Divergjenca e vënë re në ekonomitë e Europës Lindore mundet të shpjegohet nga niveli i reformave ekonomike të ndërmarra ndër vite nga këto shtete. Në bazë të rezultateve të përftuara nga ky studim arrijmë në mbështetje të teorisë se institucionet e tregut të lirë ndihmojnë në performancë më të mirë të ekonomisë. Diskutimi për rolin e ideologjisë neoliberale në ekonomi rikthehet herë pas here në opinion publik dhe në studime sa herë që vende të ndryshme përballen me kriza ekonomike. Ndaj ky studim në kapitullin e dytë bëri një analizë të hollësishme të teorisë neoliberale dhe mënyrës së shpërndarjes së kësaj ideologjie në vendet në tranzicion të Europës Lindore. Ky kapitull përmbledh diskutimet dhe rezultatet ekonometrike të këtij studimi dhe nga ana tjetër shpjegon rëndësinë e studimeve të tjera që duhen kryer në këtë fushë në qarqe akademike Shqiptare. Ajo që vihet re në diskursin ndërkombëtar por edhe atë vendas është përdorimi me ngarkesë negative të këtij termi. Kështu, neoliberalizmi megjithëse një alternativë e politikave ekonomike të Kejnsianzimit që në fillim të viteve 1950 sërish nuk pati asnjë aplikim në vendet e zhvilluara deri në vitet 1980. Ajo mbetet ende dhe sot një rrymë ideologjike që përdoret më tepër e ngarkuar negativisht në diskursin e politikave ekonomike dhe pa një përkufizim të qartë dhe

gjithëpërfshirës. Ajo që vihet re është se rreth 45% e artikujve shkencor e përdorin termin neoliberal negativisht dhe vetëm 3% e tyre e përdorin këtë term pozitivisht.

Në këtë studim ne iu referuam termit neoliberal si: të gjithë politikave reformatore në ekonomi që liberalizojnë ekonominë, eliminojnë kontrollin e çmimeve, deregullojnë tregjet e financiare dhe ulin barrierat tregtare; duke ulur rolin e shtetit në ekonomi, sidomos nëpërmjet privatizimit të aseteve shtetërore, duke ofruar shkurtim të shpenzimeve publike dhe stabilizim makroekonomik, duke përfshirë kontrollin të fortë të ofertës monetare, eliminimin e deficitit buxhetor dhe uljen e subvencioneve shtetërore. Bazuar në këtë përkufizim është e vështirë të kuptosh imponimin dhe kushtëzimin e *FMN-së*, *Bankë Botërore* apo dhe *BERZH* për reforma liberale në këmbim të kreditimit gjatë viteve 1990 pa kuptuar neoliberalizmin. Idetë neoliberale u adaptuan si kundërpërgjigje ndaj krizës së viteve 1970-të dhe sot ajo është vendosur në pikëpyetje si pasojë e krizës financiare të vitit 2008. Ndaj teksa statistikisht ne mundëm të vërtetojmë se rritja ekonomike varet përveç asaj që parashikon modeli neoklasik nga faktorë të tillë si niveli i kursimit, i teknologjisë etj, edhe nga institucionet. Por nga ana tjetër diskutimi është i rëndësishëm pasi për të patur reforma institucionale të sukseshme ne duhet gjithashtu të arrijmë të krijojmë konsensus të plotë për përfitimet e tyre në shoqëri. Ajo që vihet re nga ky studim është se eksperiencia

gjatë tranzicionit ka qënë e ndryshme për shtete të ndryshme ku vihen re si rastet e suksesit deri te dështimet ekonomike. Por faktorë të tillë si pabarazia ekonomike apo infrastruktura sociale ndikojnë në efikasitetin e reformave. Ky diskutim në fakt është rikthyer disa herë dhe në vendet e zhvilluara dhe gjatë krizës së fundit financiare. Së fundmi në Skoci shpeshherë diskutohej se ishte mirë të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar gjatë debatit për pavarësinë sepse ata “nuk donin të ishin pjesë e politikave neoliberale dhe sot politikanë të parlamentit Britanik janë shprehur se neoliberalizmi është i vdekur” (Hinsliff, 2015). Ndaj duket sikur neoliberalizimi lindi nga kriza dhe mundet të shuhet po nga kriza pavarësisht përfitimeve ekonomike të politikave neoliberale.

6.2. Konkluzione mbi hipotezën dhe pyetjen kërkimore

Pyetja e parë kërkimore na çoi në interpretimin e të dhënave për 27 shtete të Europës Lindore gjatë viteve të tranzicionit dhe reformave të tyre institucionale. Në këtë proces ky studim arrin në përfundimin se vendet e Europës Lindore të cilat kanë ndërmarrë reforma institucionale që kanë inkurajuar më shumë konkurrueshmëri në ekonomi, liberalizëm më të madh në shkëmbim tregtar, reforma financiare kanë përjetuar gjithashtu dhe rritje më të madhe të ekonomive të tyre. Shpesh herë debati është përqendruar nëse shpejtësia e reformave ka patur apo jo efekt në rritjen ekonomike të këtyre shteteve. Popov (2000) shkruan se si

terapia e shokut si gradualizmi nuk pati ndonjë efekt në rritjen ekonomike ndaj i gjithë debati për shpejtësinë e reformave është i panevojshëm.

Përsa i përket pyetjes së dytë kërkimore dhe hipotezës së ashensorit social ky studim arrin në përfundimin se mbështetja në tërësi ka rënë në vitin 2010 krahasuar me vitin 2006. Por nga ana tjetër është vënë re se privatizimi në tërë vendet e Europës Lindore ka një efekt negativ në mbështetjen për reforma duke theksuar perceptimin e qytetarëve të Europës Lindore se kjo politikë ka qenë e gabuar duke ndikuar më shumë dhe se papunësia në mbështetje negative për reforma. Por ndërkohë që kriza ekonomike preku tërë shtetet e Europës Lindore duke patur efekt negativ në rritje ekonomike dhe duke rritur papunësisë në këto vende atëherë studimi i lartpërmendur tregon se dhe mbështetje për reforma do të bjerë. Në këto kushte duke përdorur të dhënat e pyetësorëve të *BERZH (2006,2010)* duket qartë që me fillimin e krizës ekonomike mbështetja për ekonominë e tregut është në rënie, jo vetëm në Europën Lindore por edhe në Shqipëri. Më pak se gjysma mbështetin në vitin 2010 ekonominë e tregut mbi çdo lloj forme alternative të organizimit të ekonomisë. Ndërkohë ka një rritje të ndjeshme të përkrahjes së rolit më të madh të shtetit, pasi ekonomia e kontrolluar shihet si një alternativë më e pëlqyeshme sesa në vitin 2006.

Nga ana tjetër ky studim vlerëson se probabiliteti për të përzgjedhur opsionin më shumë ndërhyrje e shtetit për të ulur varfërinë në ekonomi, do të ulet në rast se

qytetarët mendojnë se e ardhmja e fëmijëve të tyre është pozitive apo mundësia për të ecur në jetë do të rritet në të ardhmen, çka justifikohet nga ajo që teoria e njeh si mundësia e ashensorit social.

Pyetja e tretë kërkimore hedh dritë në rolin e Bankës Qëndrore për të inkurajuar politika monetare të kujdeshme që marrin parasysh efektet negative të krizës financiare dhe të ekspansionit të kredithënies nga institucionet financiare. Ajo që vihet re në vendet në zhvillim është niveli i lartë i euroizimit dhe është parë si një faktor i rrezikshëm që con në destabilitet financiar në rast të krizave financiare. Në këto kushte duke qënë se në Shqipëri kredia në monedhë të huaj ka variuar nga 30%-70% të totalit dhe në kushtet kur më shumë se 70% e tregtisë totale bëhet me vende të Eurozonës atëherë duket sikur Banka e Shqipërisë ka interes të ndjekë politika monetare që kanë si synim një kurs këmbimi sa më të stabilizuar. Kjo hipotezë është krahasuar me vende të tjera të Europës Lindore dhe vihet re Shqipëria ndjek ndoshta një politikë të kursit të këmbimit që literatura e njeh si “fear of floating”. Ndërkohë duhet theksuar se niveli i kreditimit të ekonomisë në Shqipëri është 43% e PBB ndër më të ultat në Ballkan. Ajo që vihet re është se hapsira për rritje të mëtejshme janë prezente dhe ashtu sikundër dhe studime të tjera kanë vërtetuar përmirësimi i institucioneve si gjyqësori, të drejtat e pronësisë, ndërlidhja me tregjet rajonale etj. ndihmojnë në rritje të kredithënies dhe më pas në rritje ekonomike.

6.3. Implikime për teorinë dhe kufizime

Studimi hedh dritë mbi ndërlidhjen që kanë fushat e ekonomisë me fushta të tjera të studimeve si shkenca politike. Kështu megjithëse rritja ekonomike është e dëshirueshme dhe parimisht duhet parë nga ekonomistët si i vetmi indikator i rëndësishëm për të inkurajuar në reforma institucionale vihet re se shumë shoqëri bëjnë rezistencë ndaj këtyre reformave. Në këtë studim ne vëmë re se ndërtimi i institucioneve që mundet të promovojnë rritje ekonomike nuk kryhet njësoj dhe në të njëjtin intensitet në të gjitha shtetet dhe që më pas ndikon në rritje ekonomike dhe në mirëqënie. Të kuptuarit e institucioneve politike ndihmon në të kuptuarin e reformave që ndërmerren dhe pasojat që kanë në shpërndarje të pasurisë. Ajo që vihet re është se vendet të cilat janë politikisht të lira dhe demokratike shpesh herë gjenerojnë dhe mënyrën më efikase të shpërndarjes së burimeve ekonomike dhe në ndërtimin e institucioneve të duhura. Pra argumenti kryesor është se vendet të cilat janë më të demokratizuara janë gjithashtu më të gatshme të pranojnë reformat ekonomike dhe për këtë arsye këto reforma të jenë të suksesshme afatgjatë. Por kjo duhet të jetë e vërtetë në ato raste kur qytetarët u besojnë institucioneve qeverisëse. Një shembull është Evropa Perëndimore ku e drejta e votës u shoqërua me programe të paprecedenta të rishpërndarjes së pasurisë nga ana e elitës për të shmangur më tej dhe përplasjet apo revolucionet popullore (Acemoglu dhe Robinson 2000).

Siç u përmend më sipër institucionet ekonomike kanë rëndësi për rritjen ekonomike sepse ato krijojnë stimujt e nevojshëm të aktorëve ekonomikë për të investuar në kapitalin fizik dhe njerëzor dhe teknologji. Institucionet ekonomike jo vetëm përcaktojnë potencialin e rritjes ekonomike por ato gjithashtu përcaktojnë shpërndarjen e burimeve në shoqëri, dhe këtu qëndron një pjesë e problemit. Institucione të ndryshme ekonomike përveçse se sjellin ndryshime në efikasitetin e prodhimit ato gjithashtu çojnë në shpërndarje të ndryshme të fitimeve individëve dhe grupeve sociale.

Ndërkohë siç pamë nga ky studim institucionet ekonomike të implementuara në Europën Lindore dhe në Shqipëri janë rezultat i filozofisë neoliberales të reduktimit të rolit të shtetit në ekonomi dhe të krijimit të kushteve të lojës të ngjashme me Europën Perëndimore. Por nga ana tjetër jo të gjitha shtetet kanë përfunduar me të njëjtat lloje institucionesh dhe për më tepër në të njëjtat nivele. Kjo mund të vijë për shkak të historisë apo dhe të periudhës së integritimit në BE. Por ajo që vihet re është se eksperiencia e ndërtimit të këtyre institucioneve ka qenë e ndryshme në shtete të ndryshme ndaj dhe niveli i mbështetjes për këto reforma rezulton të jetë e ndryshme në shtete të ndryshme. Sic dhe u theksua në këtë studim këto konflikte të interesit mes efikasitetit ekonomik dhe të grupeve të ndryshme që do të preken nga institucionet e reja çon në grupe të reja politike që në rast se fuqizohen mjaftueshëm çojnë në ndërtim të institucioneve të reja dhe jo

të qëndrueshme. Për këtë arsye është e rëndësishme që politikbërësit të ndajnë me publikun dhe me tërë grupet e interesit të tërë informacionin mbi reformat institucionale dhe të ketë një konsensus të gjerë shoqëror mbi rëndësinë e tyre. Siç dhe u theksua mbështetja e publikut mbi privatizimet është e rëndësishme sepse ajo garanton efikasitetin e privatizimit në periudhën afatgjatë. Vetëm kërcënimi për rishikim të licencave të privatizimeve dobëson incentivat e sektorit privat për të investuar në fabrika apo industri që kanë qenë në pronësi të shtetit. Investitorët zakonisht u duhet që të bëjnë investime para prake të cilat janë të pakupërueshme më vonë. Në rast se politikat populiste kërcënojnë investimin e tyre ata janë të tërhequr për të investuar në industrinë ku operojnë. Për më tepër në vende të tilla me shtet ligjor të ulët si Rusia apo Ukraina, klasa politike mundet të rishikojë të drejtat e privatizimit për t'ia dhënë atë shtetit ose mbështetësve të tyre duke dobësuar të drejtat e pronësisë (e.g., *Hellman 2002 or Sonin 2003*).

Së fundmi duhet thënë se Shqipëria ka akoma nivele të ulëta të “penetrimit të kreditimit” në ekonomi. Të dhënat tregojnë se raporti i kredive totale me prodhimin e brendshëm bruto është 42% dhe është ndër më të ulëtat në rajon. Kjo tregon se Shqipëria akoma ka të pashfrytëzuara plotësisht mundësinë për të rritur nivelin e kreditimit në ekonomi që më pas të mund të reflektohet në rritje ekonomike. Të dhënat e mësipërme treguan se megjithëse zyrtarisht Shqipëria ka një kurs fleksibël të monedhës vendase ajo shfaq shenja të theksuara të një

monedhe fikse. Kjo e krahasuar dhe me shtete të tjera që kanë kurs fleksibël të këmbimit si Polonia. Nga ana tjetër duhet parë se Shqipëria nuk mundet të ketë rritje të mëtijshme të kreditimit pa ndryshuar shumë prej infrastrukturës institucionale që do të ndihmonte sektorin bankar për të ulur rrezikun e operimit në tregun vendas.

Por studime tregojnë se dollarizimi i lartë i ekonomive të vende të Europës Lindore çon në ashpërsim më të madh të efekteve të krizës në kushtet kur kemi marrë parasysh efekte si : rritja e kredisë para krizës , deficitet të tregtisë dhe financiare , rregullimet e tregut , si dhe GDP-së për frymë. Sipas këtij studimi rritja reale e PBB-së ka rënë mesatarisht me rreth 0.84 pikë përqindje më shumë në ekonomitë ku kredia e dhënë në monedhë të huaj ishte 10 pikë përqindje më i lartë se vendet e tjera.

Rëndësia e studimit të impaktit në performancën makroekonomike të regjimit të kursit të këmbimit bëhet më e rëndësishme kur mendojmë se sa të ekspozuara janë vendet e Ballkanit Perëndimor ndaj krizës financiare në Eurozonë veçanërisht me Greqinë. Tregtia me Greqinë mbetet shumë e rëndësishme për Malin e Zi, Maqedoninë, Bullgarinë dhe Shqipërinë, që zë rreth 12 % të eksporteve totale. Nga ana tjetër siç dhe theksuam më parë kreditimi në monedhë të huaj është gjithashtu i lartë; 50% të kredive totale në vende si Maqedonia apo Bullgaria dhe deri në 70% në vende të tjera si Shqipëria, Bosnja dhe Kroacia.

Duke parë këto të dhëna kuptohet sa i rëndësishëm bëhet studimi i impaktit që ka regjimi i kursit të këmbimit në performancën makroekonomike.

SHTOJCA

Tabela 4: Të dhëna të Lirisë Ekonomike Shqipëri 2005-2013

Viti	Vlerë simi	Të drejtat e Pronës	Liria nga Korrupsion i	Liria Fiskale	Shpenzi mi Qeveritar	Liria e Biznesit	Liria e Punët orëve	Liria Monetare	Liria e Tregtis ë	Liria e Inves timit	Liria Financi are
2013	65.2	30	31	92.6	75.1	81	49	78.4	79.8	65	70
2012	65.1	35	33	91.4	69.5	78.2	51	78.6	79.8	65	70
2011	64	35	32	92.1	68.7	67.1	50.4	79.9	79.8	65	70
2010	66	35	34	92.6	74.2	68	52.1	78.7	85.8	70	70
2009	63.7	30	29	92.8	75.6	67	47.2	79.6	75.8	70	70
2008	62.4	30	26	90.3	76	55.6	49.5	80.4	75.8	70	70
2007	61.4	30	24	87.3	75.1	64.1	49.7	80.3	73.2	60	70
2006	60.3	30	25	81.2	75.6	54.3	50.2	84.5	62.4	70	70
2005	57.8	30	25	83.3	71	55	49	85	60.2	70	50

Pyetësor Bank Botërore

Tabela 29 Sa problem është destabiliteti politik
ne zhvillimin e biznesit tuaj

	2007	2009	2013
<i>Jo Penguese</i>	18%	14%	55%
<i>Pengese e vogel</i>	13%	31%	16%
<i>Pengese e moderuar</i>	27%	25%	15%
<i>Pengese e madhe</i>	40%	14%	12%

Tabela 30 A mendoni se konkurrenca informale pengon
firmën tuaj?

<i>Jo Penguese</i>	14%	19%	20%	34%
<i>Pengese e vogel</i>	15%	11%	15%	17%
<i>Pengese e moderuar</i>	24%	21%	23%	22%
<i>Pengese e madhe</i>	48%	47%	40%	20%

Pyetësi: Modeli II

Ndryshorja e varur: mbështetja e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi për të ulur pabarazinë.

Në 27.000 pyetësor të mbledhura nga Europën Lindore në vitet 2006 dhe 2010 qytetarët janë përgjigjur kësaj pyetje:

1. Mos përfshirje
2. Përfshirje e moderuar
3. Përfshirje e madhe.

Nga ana tjetër ndryshoret e pavarura janë:

a) Fëmijët e mi do të kenë një të ardhme më të mirë sesa gjenerata ime

- 1- Plotësisht kundra
- 2- Kundra
- 3- As pro as kundra
- 4- Dakort
- 5- Plotësisht dakort
- 6- Na
- 7- Nuk e di

b) Eksperienca gjatë tranzicionit- familja ime jeton më mirë tani sesa më 1989

- 1- Plotësisht kundra
- 2- Kundra
- 3- As pro as kundra
- 4- Dakort
- 5- Plotësisht dakort

- 6- Na
- 7- Nuk e di

c) Besimi te qytetarët e tjerë

- 1. Mosbesim i plotë
- 2. Pak mosbesim
- 3. As besim as mosbesim
- 4. Pak besim
- 5. Besim i plotë
- 6. Vështirë ta them

d) Gjendja shëndetësore e të pyeturit

- 1. shumë mirë
- 2. Mirë
- 3. Mesatare
- 4. Keq
- 5. Shumë keq
- e) Mosha e të pyeturit

f) Punësimi në 12 muajt e fundit

- 1. Po
- 2. Jo

g) Besimi në Partitë Politike

- 1. Mosbesim i plotë
- 2. Pak mosbesim
- 3. As besim as mosbesim
- 4. Pak besim

5. Besim i plotë
6. Vështirë ta them



Indikatori Lirisë



Çfarë mat ky indikator janë:



1. Madhësia qeverisë
 - Shpenzimet qeveritare
 - Transfertat dhe subvencionet
 - Taksat
2. Sistemi ligjor dhe të drejtat e pronësisë
 - Pavarësia e gjyqësorit
 - Mbrojta e pronës private
 - Integriteti i sistemit ligjor
 - Respektimi i kontratës
 - Kostot e biznesit nga krimi
 - Besimi në polici
 - Kufizime në shitjen e pasurisë së patundshme
3. Monedha vendase
 - Rritja monetare
 - Devijimi standard i inflacionit
 - Inflacioni
4. Liria për tregti ndërkombëtare
 - Tarifa
 - Rregullator pengues të tregtisë
 - Tregu i zi i monedhës vendase
 - Kontrolli i kapitalit dhe njerëzve
5. Rregullatorët

- Rregullimi i tregut financiar
- Rregullimi i tregut të punës
- Rregullimi i bizneseve

Grafik1 .Kursi i Këmbimit monedha Shqiptare, Serbe, Kroate dhe Maqedonase







REFERENCA

- Acemoglu, D. a. (2000). Why Did The West Extend The Franchise? Democracy, Inequality, And Growth In Historical Perspective,. " *The Quarterly Journal of Economics*, vol. 115(4),, pages 1167-1199,.
- Acemoglu, D. a. (2012). *Why Nations Fail: The Origins of Power, Prosperity and Poverty*. New York: Crown.
- Acemoglu, D. S. (2005). Institutions as a Fundamental Cause of Development. *Handbook of Economic Growth*.
- Aghion. (2005). 3. Aghion, P., Bacchetta, P., Ranciere, R. and Rogoff, K. (2005) Productivity Growth and the Exchange Rate Regime: The Role of Financial Development. . *NBER Working Paper Series*, , p.1-27.
- Arrow, K. J. (1962). "The Economic Implications of Learning by Doing." Rev. *Review of Economic Studies*.
- Balcerowicz, L. (2001) *Post-Communist Transition: Some Lessons*. The Institute of Economic Affairs.
- Barbone. (1996). EU Accession and Economic Growth, The Challenge for Central and Eastern European Countries,. *World Bank*.
- Barlett, W. (2012, January 20). Impact of Global Crisis on SEE. UK. Marr nga: http://www.daad.rs/imperia/md/content/informationszentren/belgrad/impact_global-crisis_on_see-lsee-paper-4.pdf
- Birch, K. (2010). *The Rise and Fall of Neoliberalism: The Collapse of an Economic Order?* . Zed Books.

- Boas, T. C., & Gans-Morse, J. (2009). Neoliberalism: From New Liberal Philosophy to Anti-Liberal Slogan. *University of California*, 40-67.
- Bockmanm, J., & Eyal, G. (2002). Eastern Europe as a Laboratory of Economic Knowledge: The Transnational Roots of Neoliberalism,. *American Journal of Sociology* .
- Brohman, J. (1995). Universalism, Eurocentrism, and Ideological Bias in Development Studies: From Modernisation to Neoliberalism. *Third World Q.*, 122–140.
- Brown, G. (2009). Speech at the 2009 Labour Party Annual Conference.
- Calvo, G. R. (2000). Fear of Floating. *Quarterly Journal of Economics* , 379–408.
- Campos, N. a. (2002). Growth in Transition: What We Know, What We Don't, and What We Should. *Journal of Economic Literature*, 793-836.
- Carruthers, D. (2011). Environmental Politics in Chile: Legacies of Dictatorship and Democracy. *Third World Q.*
- Cass, D. (1965). Optimum growth in an aggregative model of capital accumulation. *Review of Economic Studies*.
- Conquest, R. (2000). Reflections on a Ravaged Century,.
- DeMelo. (2001). Circumstances and choice: The role of initial conditions and policies in transition Economies. *World Bank Economic Review*, 15-31.

- Denisova, I. (2007). Who Wants to Revise Privatization and Why? Evidence from 28 Post-Communist Countries. *Center for Economic and Financial Research*.
- Dictionary, P. O. (2012). Oxford English Dictionary. Oxford, UK. Retrieved from <http://www.oed.com/view/Entry/245592?redirectedFrom=neoliberal#footnoteWrapper>
- Djankov, S., & Murrell, P. (2002). Enterprise Restructuring in Transition: A Quantitative Survey. *Journal of Economic Literature*, 739–792.
- Drazen, A. (2000). *Political Economy in Macroeconomics*. . Princeton: Princeton Press.
- Durlauf, N., Johnson, A.P., & Temple, R. (2005). Growth Econometrics. In P. a. In Aghion, *Handbook of Economic Growth* (pp. pp. 385-472). Amsterdam, : North-Holland:.
- Gray, J. (1995). *Liberalism*. . Buckingham:: Open University Press.
- Grosjean. (2011). “Long term institutional persistence: Ottoman rule and financial development in the regions of Europe. *Journal of Comparative Economics*, , 1-16.
- Harvey, D. (2005.). *A Brief History of Neoliberalism*. . New York: Oxford University Press.
- Havrylyshyn, O. (2003). Institutions Matter in Transition, But so Do Policies. *Comparative Economic Studies*.

- Hay, C. (2004). Re-stating politics, re-politicising the state: neo-liberalism, economic imperatives and the rise of the competition state. . *Political Studies Quarterly* , f 38-50.
- Hayo, B. (2004). Public support for creating a market economy in Eastern Europe. *Jurnal of Comperative Economics*.
- John Uilliamson. (2004). A Short History of the Washington Consensus. “*From the Washington Consensus towards a new Global Governance*,”. Barcelona, September 24–25, .
- King, L. (2002). Postcommunist Divergence: A Comparative Analysis of the Transition to Capitalism in Poland and Russia. *Studies in Comparative International Development*.
- Kotz, D. M. (2001). *Globalization and Neoliberalism*. Retrieved from University of Massachusetts: http://people.umass.edu/dmkotz/Glob_and_NL_02.pdf
- Kurtz, M. (1999). Chile’s Neoliberal Revolution: Incremental Decisions and Structural Transformation. *Journal of Latin American Studies*., f 399–427.
- Larner, W. (2000). Neo-liberalism: Policy, Ideology, Governmentality. *Studies in Political Economy*.
- Lawson, C. a. (2004). “Economic transition in central and eastern Europe and the former Soviet Union: Which policies worked”?, . *University of Bath*.
- Levy-Yeyati, & Sturzenegger. (2005). To Float or to Fix: Evidence on the Impact of Exchange Rate Regimes on Growth. *Universidad Torcuato Di Tella*.

- Lora, E. a. (2003). The Future of Structural Reform. *Journal of Democracy*, pp.123-137.
- Loungani, P. a. (1997). “Central bank independence, inflation and growth in transition economies”, . *Journal of Money, Credit and Banking*., Vol. 29, No. 3, pp. 81-99.
- Lucas, R. (1988). ON THE MECHANICS OF ECONOMIC DEVELOPMENT. *Journal of Monetary Economics*, f 3-42.
- Maddison, A. (2008). “World Population, GDP and Per Capita GDP, 1-2003AD”,. *University of Groeningen: Groningen Growth and Development Centre*., f 1-4.
- Mark Blyth. (2002). *Great Transformations: Economic Ideas and Institutional Change in the 20th Century*. New York: Cambridge University Press.
- McChesney, R. W. (1999, April 1). Noam Chomsky and the Struggle Against Neoliberalism. Retrieved from <http://www.chomsky.info/onchomsky/19990401.htm>
- McKinnon, R., & Schnab, G. (2004).) A Return to Soft Dollar Pegging in East Asia? Mitigating Conflicted Virtue. . *International Finance*., 169–201.
- Milanovic, B. (1998). *Income, Inequality, and Poverty during the Transition from Planned to Market Economy*.
- Mirowski, P. (2009). *The Road from Mont Pèlerin*.
- Murell, P. (2006). *Institutions and Transition*., London: Palgrave Macmillan Ltd.

- North, D. (1993). Institutions, Ideology, and Economic Performance. *Cato Journal*.
- North, D. C., & Robert Thomas. (1973). The Rise of the Western World: A New Economic. *Cambridge University*.
- Orenstein, M. A. (2009). What Happened in East Euroepan (Political) Economy? *East European Politics and Socities*.
- Parente, S. P. (1999). Monopoly rights as barriers to riches. *American Economic Review* , f 89-102.
- Pesaran, M. H., Shin, Y., & Smith., R. P. (1991). Pooled mean group estimation of dynamic heterogeneous panels. *Journal of the American Statistical Association*, f. 621-634.
- Polterovich, V. &. (2007). Democratization, Quality of Institutions and Economic Growth. *MPRA Paper*.
- Popov, V. (2007). Shock Therapy versus Gradualism Reconsidered: Lessons from Transition Economies after 15 Years of Reforms. *Comparative Economic Studies*, , Vol 49, pp 1–31.
- Radulescu, R. B. (2002). The Relationship Between Policies and Growth In Transition Countries. , *Economics of Transition*,, pp.719-745.
- Ravi K. Roy, A. T. (2007). *Neoliberalism: National and Regional Experiments with Global Ideas*. Routledge.
- Robert E. Hall, C. I. (1999). Why Do Some Countries Produce So Much More Output per Worker than Others? *NBER Working Paper No. 6564*.

- Rodrik, D. (2006). Goodbye Washington Consensus, Hello Washington Confusion? A Review of the World Bank's Economic Growth in the 1990s: Learning from a Decade of Reform. *Journal of Economic Literature*.
- Rodrik, D. (1996). Understanding economic policy reform. . *Journal of Economic Literature* , f 9-41.
- Romer. (1990). Endogenous Technological Change. *Journal of Political Economy*, f. 71-102.
- Romer, P. (1986). Increasing Returns and Long-Run Growth. *The Journal of Political Economy*, Vol. 94,, f. 1002-1037.
- Rutland, P. (2012). Neoliberalism and the Russian and the Russian transition. *Review of International Political Economy*.
- Ryan, A. (1993). *Liberalism*. Blackwell.
- Schich, S. (2008). *Financial Turbulence: Some Lessons Regarding Deposit Insurance*. OECD.
- Simmons, B. A., Dobbin, F., & Garrett., G. (2006). *The International Diffusion of Liberalism*. The IO Foundation.
- Solow, R. (1956). A Contribution to the Theory of Economic Growth. *The Quarterly Journal of Economics*, 70, f.65-94.
- Staehr, K. (2003). Reforms and Economic Growth in Transition Economies: Complementarity, Sequencing and Speed . *The European Journal of Comparative Economics* , 177-202.

- Stuckler, D., King, L., & McKee, M. (2009). “Mass Privatisation and the Post-Communist Mortality Crisis: A Cross-National Analysis. *The Lancet* 373, f. 399–407.
- The Economist. (2009). Mass Murder and Privatisation.
- Thorsen, D. E. (2009). What is Neoliberalism? *Working paper University of Oslo*.
- Universtiry, O. (n.d.). Oxford English Dictionary . Retrieved from Oxford English Dictionary.
- Vorobyov, A. Z. (2000). “Russia: Globalization, Structural Shifts and Inequality.”. *CEPA Working Paper Series I*.
- World Bank. (2004). *Economies in Transition*. Washington: World Bank.
- World Bank. (2011). *Principles for Effective Insolvency and Creditor/Debtor Regimes*. World Bank.